



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
“Inxhinieri Kompjuterike”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “EPOKA”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Alketa Grepcka

2. Dr. Frida Gjermani

Qershor/ 2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master i Shkencave i Nivelit të Dytë në “Inxhinieri Kompjuterike”
ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Epoka”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Epoka”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 908, datë 26.08.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MAS nr. 211, dt. 24.10.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 52, datë 28.09.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vjet
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021-2022: 6 PAE/2 PAK; 2022-2023: 5 PAE/3PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022: 23 studentë 2022-2023: 39 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Epoka” është një institucion privat i arsimit të lartë, i licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.908 datë 26.08.2009. Universiteti “Epoka” i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 52, datë 28.09.2017, me kohëzgjatje 6 vite akademike.

Universiteti “Epoka” ka 3 njësi kryesore: Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Fakultetin e Shkencave të Ekonomisë dhe Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. Statuti i universitetit “Epoka”, në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” është miratuar me Vendim Senati Akademik nr.02 datë 14.12.2016.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” është hapur me Urdhër nr.908 datë 26.08.2009 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë universitare Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike”. Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, njësi përbërëse e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë .

Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe është organizuar në bazë të sistemin Europian të transferimit të krediteve në 120 kredite ECTS. Qëllimi i këtij programi studimi është të përgatisë studentët për t'u bërë lider në fushën e programimit dhe adresimit të nevojave globale që kërkojnë profesionistë të vërtetë për zgjidhjen e problemeve inxhinierike dhe softuerike, të shkencave kompjuterike. Programi i studimit ofrohet në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren Themelore dhe Rregulloren për Programet e Ciklit të Dytë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur në Qershor 2023. Ky Raport siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti “Epoka” për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Universiteti “Epoka”, po ashtu, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, vuri në dispozicion të vlerësuesve një numër eviencash mbështetëse.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr.531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për “Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”, Udhëzimin e MASR Nr. 22, datë 3.9.2020, Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë” si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

GVJ gjatë vlerësimit të jashtëm u mbështet nga koordinatori teknik i ASCAL, Msc. Aviola Bardhi. Takimet në institucion, u zhvilluan sipas programit të miratuar nga ASCAL dhe konsistuan në zhvillimin e diskutimeve, me Dekanin e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë dhe Përgjegjësën e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike, Grupin e Vlerësimit të brendshëm, stafin akademik, studentët, përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë/Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Takim me përfaqësues të Zyrës së Koordinimit të Studentëve dhe Komisionit për Marrëdhëniet me Studentët, përfaqësues të Zyrës së Hulumtimit dhe Projekteve, si dhe përfaqësues të sekretarisë mësimore. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë.

Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj.

Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.

Më datë 07.05.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr 44/10 Prot., datë 07.05.2024 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 15.05.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr 131/19 Prot., datë 14.05.2024, ardhur në protokollin e ASCAL më datë 15.05.2024.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft- raportin, sqaron si vijon:

GVJ shqyrtoi me vëmendje dokumentacionin e paraqitur nga Institucioni. Komenti i dhënë nga institucioni i referohet dy dokumentave bazë përkatësisht Rregullores Themelore dhe Rregullores se programeve për ciklin e dytë të përmendur edhe nga ana e GVJ në kriterin 1, standarti III.2 [Aneks 1.1 dhe aneks 3]. Konkretisht GVJ konstaton në Rregulloren Themelore nenet 45-52 si vijon më poshtë:

Neni 45: Pikët/gradat në vlerësim;

Neni 46- Kalimi, ngelja dhe studentët ekselente;

Neni 47: Përmirësimet në mësatoren e përgjithshme;

Neni 48: Pikët për kalim;

Neni 49 – Sezoni I provimit;

Neni 50: Programi dhe vendi për provim, shtyrja e provimeve;

Neni 51: Forma e provimit;

Neni 52: Ankimimi kundrejt rezultatit të provimeve.

GVJ konstaton reflektimin e neneve të përmendur më sipër edhe në Rregulloren e programeve të ciklit të dytë. GVJ rithekson mungesën e përcaktimit të masës së vlerësimit në lidhje me ndjekjen e lëndës dhe pjesëmarrjen aktive, plotësimin e detyrimeve (orëve laboratorike, detyrat/projektet e kursit), vlerësimit në lidhje me testimet gjatë semestrit/ vitit, dhe vlerësimi përfundimtar. GVJ ka theksuar këtë mungesë edhe në kriterin 3 të standartit III.2.

Në këtë kriter bazuar nga tabela përmbledhëse e paraqitur nga institucioni konstatohet:

- *Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive: 0%*
- *Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit): 30%*
- *Testimet gjatë vitit: 20%*
- *Provimi përfundimtar: 50%*

[Tabelat Përmbledhëse_MSc CEN_shqip]

Referuar kritereve të vlerësimit të dhëna në programet lëndore (syllabuset) për këtë program studimi konstatojmë:

Homework	Quiz	Presantim	Projekt kursi	Provim pjesshëm	Provim final
5%	5%	15%	20% 30% 50% 60%	20% 25%	40% 50% 90%

GVJ vëren forma të ndryshme të vlerësimit ku në disa raste provimi final zë një peshë 90% dhe në raste të tjera 40% ndërsa në deklarinimin e dhënë nga institucioni provimi final ka një peshë 50%.

Si rrjedhojë, mungesa e reflektimit të masës për secilin element të vlerësimit në rregulloren e programit të studimit krijon një mospërputhshmëri dhe për këtë arsye GVJ rekomandon paraqitjen e vlerësimit të elementëve në rregulloren e programit të ciklit të dytë. Vlerësimi nuk ndryshon.

Komenti për standardin IV.1:

GVJ pranon që institucioni ndjek një politikë në lidhje me ngarkesën e stafit akademik të shprehur edhe në dokumentin :*Annex 42 Directive On The Teaching Load.*

GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konstaton një mbingarkesë të stafit akademik. GVJ beson se dy vendet vakante të hapur nga njësi bazë sic theksohet edhe në komentimin e institucionit do të sjellin për vitin akademik 20204-2025 një lehtësim të punës së stafit akademik dhe një rritje të cilësisë së mësimdhënies në këtë program studimi. Vlerësimi nuk ndryshon.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

Akreditimi i programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” i realizuar për herë të parë me Urdhër Nr. 52 datë 28.09.2018 të Bordit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, për një periudhë 6 vjeçare është shoqëruar me rekomandime.

Rekomandimet e dhëna:

1. Institucioni duhet të përfshijë në kurrikulën e programit të studimit tema të rëndësishme në fushën e inxhinierisë kompjuterike, për të ofruar një program sa më cilësor.
2. Institucioni duhet të parashikojë rritjen e financimit dhe gjenerimin e fondeve shtesë në funksion të kërkimit shkencor.

GVJ bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, nga takimet e zhvilluara në institucion në lidhje me rekomandimet e mësipërme konstaton si vijon më poshtë:

Rekomandimi 1: Programi Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” është përmirësuar dhe riorganizuar në masën 20%. Në përmbajtjen e tij janë bërë riorganizime në disiplina që kanë buruar nga kërkesat e dhëna nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Programi i studimit ka pësuar përmirësime në përmbajtjen e programeve lëndore, në rigrupimin e lëndëve me zgjedhje duke rritur spektrin e tyre.

Programi i studimit është përmirësuar në vijim të rekomandimeve të dhëna në procesin e fundit të akreditimit. Konkretisht në program i është dhënë një rëndësi praktikës profesionale si një komponent i rëndësishëm në aftësim më shumë në drejtim të praktikës të studentëve. Praktika profesionale zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dyte dhe ka një peshë 12 ECTS.

GVJ është i mendimit se përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve mundësojnë, njohuri, aftësi dhe kompetenca të cilat garantojnë formimin e nevojshëm për punësim të studentëve. Përmbajtja e programit mësimor mundëson studentët të thellojnë njohuritë në fushën e inxhinierisë kompjuterike dhe programimit. Plani mësimor për vitin 2022-2023 përmban si vijon më poshtë:

Tipi i veprimtarisë	Lëndët/Modulet
Aktivitete në disiplina të përgjithshme (A)	Metoda e Kërkimit
Veprimtari në karakterizimin e disiplinave të programit të studimit (B)	<ol style="list-style-type: none">1. Sistemi i avancuar i menaxhimit të bazës së të dhënave;2. Minimi i të dhënave;3. Koncepte të avancuara në rrjetet kompjuterike;4. Arkitekturë e avancuar kompjuterike;5. Përpunimi dixhital i imazhit;6. Vizioni kompjuterik;7. Matematikë e avancuar për shkencë kompjuterike8. Hyrje në rrjetin neural;9. Mësimi i makinerisë;

Aktivitetet në disiplina të ngjashme ose/dhe integruese që lidhen me disiplinat karakterizuese (C)	1. Grupi i lëndëve me zgjedhje 2. Grupi i lëndëve me zgjedhje
Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D)	Praktika profesionale
Tezë Masteri (E)	Teza

Plani mësimor është ristrukturuar dhe siç evidentohet edhe në tabelën mësipër është dhënë një prioritet kategorizimin të lëndëve të detyrueshme në disipinën “B” (nga 11 lëndë për vitin akademik 2020-2022 në 9 lëndë për vitin akademik 2022-2023) dhe rritjes së grupit të lëndëve me zgjedhje duke i dhënë mundësi studentit të profilizohet [Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation; Annex 2.1 Syllabuses Part 1, 2 dhe 3].

Programi mësimor ka pësuar ndryshime edhe në lidhje me lëndët me zgjedhje duke rritur spektrin e marrjes së njohurive në fushën e inxhinierisë kompjuterike. Konkretisht për vitin akademik 2022-2023 janë shtuar lëndët me zgjedhje si vijon më poshtë:

1. Metodot e avancuara numerike;
2. Menaxhimi i projekteve softuerike;
3. Dizajni i sistemit operativ;
4. Hyrje në inxhinierinë e rrjetit;
5. Biznели online dhe tregtia online;
6. Hyrje në kriptografi;
7. Tema të veçanta në inxhinieri softuerike;
8. Sistemet e shpërndara;
9. Programimi i aplikacioneve celulare;
10. Tema të veçanta në inteligjencë artificiale;
11. Menaxhimi i sistemeve të informacionit;
12. Projektimi i sistemeve të ngulitura
13. Përpunimi i sistemit multimedial;
14. Animacion multimedial dhe kompjuterik;
15. Auditimi i sigurisë dhe testimi i penetrimit;
16. Hartuesit;
17. Metodot dhe algoritmet e optimizimit;
18. Shkenca e të dhënave;
19. Kriptografia e aplikuar;
20. Sistemet e avancuara të kontrollit;

dhe janë rigrupuar lëndët detyruese në përputhje edhe me zhvillimet e fundit ligjore. Në takimet me stafin akademik shembuj të shumtë u sollën në lidhje me punën që ata kanë zhvilluar për futjen e lëndëve të reja tashmë shumë të kërkuara (psh drejt kuptimit dhe teknikave në inteligjencën artificiale etj) [Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation; Tabelat Përmbledhëse_MSc_CEN_shqip].

Për sa mësipër GVJ duke vlerësuar ndryshimet e zhvilluara konkludon se ky rekomandim është plotësuar.

Rekomandimi 2: Institucioni ka bërë investime në bazën laboratorike përmes pjesëmarrjen në disa projekte kërkimore shkencore ku vlen të përmenden 4 projekte të financuara nga jashtë (PanBiora, K-FORCE, DIMTV, VTECH) dhe 2 projekte të brendshme kërkimi. Bazuar në të dhënat financiare për periudhën 2018-2023 janë shpenzuar 7,331.63Euro nga të ardhurat nga regjistrimet e studentëve në lidhje me investime në përmirësimin e bazës laboratorike [vizitë në institucion, Tabelat Përmbledhëse_MSc CEN_shqip]. Investimet dhe mbështetja financiare ka konsistuar edhe në drejtim të pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca dhe botime shkencore (12 pjesëmarrës në konferenca shkencore jashtë, 2 cmime nderkombetare në fushën e kërkimit shkencor) [Tabelat Përmbledhëse_MSc CEN_shqip].

Për sa mësipër GVJ duke vlerësuar ndryshimet e zhvilluara konkludon se ky rekomandim është plotësuar.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>IAL “Epoka” ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” është në përputhje me misionin dhe Strategjinë Institucionale të universitetit. Universiteti “Epoka” zhvillon aktivitetin e saj bazuar në një vizion të qartë: “...të jetë një universitet lider në vendin tonë në fushën e arsimit, kërkimit dhe zhvillimit si dhe në shërbimin ndaj shoqërisë” [Annex 5 Epoka university strategy]. Bazuar edhe në Statut vlen të përmenden disa parime bazë mbi të cilën Institucioni “Epoka” ushtron veprimtarinë e tij duke dhënë një impact pozitiv në vend:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Beson në universalitetin e arsimit dhe kërkimit; • I bindet parimeve dhe rregullave juridike universale; • Është i respektueshëm dhe tolerant ndaj feve, gjuhëve, gjinive, kombësive, ngjyrave dhe dallimeve në opinione të ndryshme; • Ndërvepron në mënyrë të vazhdueshme me komunitetin për t’u bërë një pionier dhe një model i të mësuarit dhe kërkimit në nivel lokal dhe ndërkombëtar; <p>[Annex 1 Statute of Epoka University; Annex 5 Epoka university strategy]. Në thelb të misionit të programit të studimit qëndron edukimi i studentëve duke i dhënë vlera shtesë në formimin e tyre. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ofron programe studimi në tre nivele edukimi arsimor: Bachelor, Master (MSc dhe MP) dhe nivel Doktorature duke qenë gjithmonë në përputhshmëri me parimet bazë të shprehur në Statut dhe në rregulloret e institucionit [Annex 5.1 Department strategic plan, mission of the study program; Annex 5 Epoka university strategy; Annex 1 Statute of Epoka University].</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Misioni i Universitetit “Epoka” është i ndërtuar dhe i shprehur qartë në nenin 3 të Statutit të këtij Institucioni [Annex 1 Statute of Epoka University]. Universiteti “Epoka” në të gjitha aktivitetet e tij ka si mision të jetë institucion arsimor dhe kërkimor novator dhe me ndikim, duke i shërbyer vlerave themelore njerëzore përmes prodhimit, zhvillimit dhe përhapjes së njohurive në nivel ndërkombëtar, si dhe duke kontribuar në përmirësimin e cilësinë e jetës së shoqërisë bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale.</p>

	<p>Universiteti “Epoka” zhvillon veprimtarinë e tij bazuar në një strategji të qartë zhvillimi. Kuadri i Strategjisë përshkruan qëllimet dhe jep një rrugë të qartë të synimit të institucionit ku në qendër të saj është plotësimi i tre misioneve të universitetit: mësimdhënia, kërkimi dhe shërbimi tek komuniteti. GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” është i organizuar bazuar në një mision të qartë. Misioni i Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike është të edukojë studentë që të fitojnë njohuri në shkencat themelore dhe inxhinierike në mënyrë që të jenë të aftë të zhvillojnë zgjidhje të problemeve në inxhinierinë kompjuterike dhe të forcojnë aftësitë e tyre në këtë fushë dhe kërkim [Annex 5.1 Department strategic plan, mission of the study program].</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike është hartuar dhe zbatohet në përputhje me strategjinë e institucionit. Universiteti “Epoka” në vite drejton veprimtarinë e saj bazuar në një strategji të qartë zhvillimi. GVJ konstaton se institucioni zhvillon një analizë të qartë në lidhje me hartimin e strategjisë duke e konsideruar atë si një udhërrëfyes të aktivitetin të tij dhe monitoron realizimin e saj. GVJ gjen evidence të analizës së përmbushjes së qëllimeve bazë të vendosur në strategjinë 2013-2017 dhe hartimin e Strategjisë së Re 2018-2023 e cila reflekton reformat e reja të ndërmarra në kuadër të zhvillimit të institucioneve të arsimit të lartë në vend, rritjen dhe zgjerimin e universitetit në numër të studentëve, në drejtim të hapjes së programeve të reja dhe në forcimin e cilësisë së procesit mësimor. Sfidat aktuale në tregun e punës institucioni përmes strategjisë së tij synon ti përballë duke arritur ekselencën në mësimdhënië, kërkim, performancën e studentit dhe në menaxhim [Annex 5 Epoka university strategy].</p> <p>GVJ konstaton se Strategjia Institucionale e Zhvillimit mbështet zhvillimin e fakulteve dhe njësisive bazë. Siç theksohet edhe në këtë dokument kjo strategji zërthehet në prioritetet më specifike për çdo fakultet dhe department duke i dhënë një kontekst të plotë përspektives institucionale të zhvillimit. Në kuadër të strategjisë 2018-2022 të universitetit, strategjia e fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë vendos disa prioritetet bazë:</p> <p>Prioriteti 1: Të sigurojë një mjedis me cilësi të lartë për mësimdhënien dhe mësimnxënien;</p> <p>Prioriteti 2: Vendosja e një trupi studentor me cilësi të lartë dhe të larmishëm duke i ofruar atij një edukim dhe diplomim cilësor;</p> <p>Prioriteti 3: Sigurimi i mjedisit me cilësi të lartë për kërkimin dhe zhvillimin e projekteve;</p> <p>GVJ përmes shqyrtimit të dokumentacionit konstaton edhe zërthimin e prioritetëve bazë në nivel fakulteti tashmë në nivel njësi bazë.</p> <p>Prioriteti 1: Të sigurojë një mjedis me cilësi të lartë për mësimdhënien dhe mësimnxënien;</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • Qëllimi 1.1: Përmirësimi i didaktikës dhe aftësive të mësimit të stafit akademik; • Qëllimi 1.2: Për të siguruar qëndrimin e stafit, institucioni synon në (i) krijimin e një mjedisi modern dhe miqësor që do të kontribuojë në një bashkëpunim më të shëndetshëm, (ii) të vazhdojë mbështetjen financiare për pedagogët që marrin pjesë në konferenca; • Qëllimi 1.3: Të ofrojë programe mentorimi për stafin kërkues të ri duke mbështetur punën e tyre shkencore; <p>Prioriteti 2: Vendosja e një trupi studentor me cilësi të lartë dhe të larmishëm duke i ofruar atij një edukim dhe diplomim cilësor;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qëllimi 2.1: Rritja e përqindjes së studentëve në Bachelor që janë përfshirë në aktivitetet kërkimore; • Qëllimi 2.2: Rritja e mobilitetit të studentëve Master në programe exchange me universitete të tjera partnere; 								
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prioritetet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” është hartuar dhe përmirësohet duke reflektuar ndryshimet në kuadrin ligjor për institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Ai reflekton edhe prioritetet që shprehen në Strategjinë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (SKST 2020), Strategjinë e Inovacionit dhe Teknologjisë me Biznesin (BITS), Strategjinë për Teknologjinë e Informacionit (TIK) dhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim [takime në institucion, RVB]								
Konkluzione	<i>Institucioni ka një strategji zhvillimi e cila përcakton qartë synimet, objektivat dhe plan veprimet për çdo fushë prioritare. Strategjia insticionale është zbrëthyer në qëllime më specifike në njësitë kryesore dhe bazë në përputhje me veçantitë e programeve të studimit që ofrohen. Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike është hartuar në akordancë me kërkesat e vendit dhe Strategjinë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (SKST 2020).</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike	Universiteti “Epoka” përmes dokumentacionit të paraqitur dhe nga vizita e kryera në institucion dëshmon që zotëron kapacitete dhe burime të duhura për të mundur zhvillimin e programit mësimor Mastër i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike”. Ky program zhvillohet në Fakultetin e

<p>specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Arkitekturës dhe Inxhinierisë (FAI) i cili përbëhet nga tre njësi bazë si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike (DIK) – ku zhvillohet edhe program i studimit i marrë në shqyrtim; 2. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit (DIN); 3. Departamenti i Arkitekturës (DA); <p>FAI angazhon një staf akademik me përvojë dhe eksperiencë. Të dhënat statistikore të paraqitur nga institucioni në lidhje me numrin e stafit akademik të angazhuar në njësinë bazë ku zhvillohet programi i studimit shprehin një qëndrueshmëri. Për periudhën 2022-2023 dëshmohet angazhimi i një stafi akademik PAE dhe PAK me eksperiencë dhe me grada shkencore të duhura për programin mësimor konkretishtsi vijon ne tabelen me poshte:</p> <table border="1" data-bbox="596 763 1425 1144"> <thead> <tr> <th colspan="3">Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë</th> </tr> <tr> <th></th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike</td> <td>17 (2 Prof. Dr; 1 Prof. Assoc. Dr; 5 Dr; 9 Msc ;)</td> <td>13 (2 Prof. Assoc. Dr; 5 Dr; 6 Msc ;)</td> </tr> <tr> <td>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit</td> <td>6 (1 Prof. Dr; 1 Prof. Assoc. Dr; 3 Dr; 1 MSc)</td> <td>2 (2 MSc)</td> </tr> <tr> <td>Departamenti i Arkitekturës</td> <td>13 (1 Prof. Dr; 8 Dr; 4 MSc)</td> <td>5 (5 MSc)</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>36</td> <td>20</td> </tr> </tbody> </table> <p>Institucioni ofron një infrastrukturë të duhur për zhvillimin e programit mësimor me një bazë të gjerë laboratorike. Më shumë informacion në lidhje me infrastrukturën është dhënë në fushën 4 të këtij raporti [Annex 29 Capacity Verification Report 2022-2023];</p>	Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë				PAE	PAK	Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike	17 (2 Prof. Dr; 1 Prof. Assoc. Dr; 5 Dr; 9 Msc ;)	13 (2 Prof. Assoc. Dr; 5 Dr; 6 Msc ;)	Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit	6 (1 Prof. Dr; 1 Prof. Assoc. Dr; 3 Dr; 1 MSc)	2 (2 MSc)	Departamenti i Arkitekturës	13 (1 Prof. Dr; 8 Dr; 4 MSc)	5 (5 MSc)	Total	36	20										
Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë																													
	PAE	PAK																											
Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike	17 (2 Prof. Dr; 1 Prof. Assoc. Dr; 5 Dr; 9 Msc ;)	13 (2 Prof. Assoc. Dr; 5 Dr; 6 Msc ;)																											
Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit	6 (1 Prof. Dr; 1 Prof. Assoc. Dr; 3 Dr; 1 MSc)	2 (2 MSc)																											
Departamenti i Arkitekturës	13 (1 Prof. Dr; 8 Dr; 4 MSc)	5 (5 MSc)																											
Total	36	20																											
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Mastër i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” ofrohet në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë, në Departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike. Fusha e studimit të njësisë kryesore është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të programit të studimit. Bazuar edhe në evidencat e paraqitura FAI dhe DIK ofron një larmi programesh që variojnë nga niveli Bachelor deri në nivel Doktorature.</p> <table border="1" data-bbox="596 1525 1425 1805"> <thead> <tr> <th>FAI</th> <th>Nr. i prog. BSc.</th> <th>Nr. i prog MSc.</th> <th>Nr. i prog. MP</th> <th>Nr. i prog. MSc (integruar)</th> <th>Nr i prog. Dr.</th> <th>Tota l</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>DI N</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>DA</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>DI K</td> <td>3</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>7</td> </tr> </tbody> </table>	FAI	Nr. i prog. BSc.	Nr. i prog MSc.	Nr. i prog. MP	Nr. i prog. MSc (integruar)	Nr i prog. Dr.	Tota l	DI N	1	1	2	-	1	5	DA	-	1	-	1	1	3	DI K	3	2	1	-	1	7
FAI	Nr. i prog. BSc.	Nr. i prog MSc.	Nr. i prog. MP	Nr. i prog. MSc (integruar)	Nr i prog. Dr.	Tota l																							
DI N	1	1	2	-	1	5																							
DA	-	1	-	1	1	3																							
DI K	3	2	1	-	1	7																							

	Tot al	4	4	3	1	3	15
	<p><i>[Tabelat Përmbledhëse_MSc CEN_shqip]</i></p> <p>Fusha didaktike e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë dhe fusha e programit të studimit është inxhinieria dhe bazuar në fushën e kërkimit të njësisë bazë është inxhinieri kompjuterike. GVJ evidenton se Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë zhvillohet dhe kryen funksionin e tij bazuar në parimet dhe standartet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Institucionin zhvillon punë në drejtim të kodifikimit të gjithë programeve që ofron në të tre nivelet. Programi Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” është i kodifikuar me kodin 72MS061A.</p>						
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” është hartuar nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë. GVJ evidenton se ky program është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore dhe bazë <i>[Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation]</i>.</p> <p>Inxhinieria kompjuterike është fusha kryesore e studimit. Aktiviteti kërkimor dhe shkencor i realizuar në këtë program studimit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të FAI dhe të Institucionit <i>[Annex 5 Epoka university strategy; Annex 5.1 Department strategic plan, mission of the study program]</i>;</p>						
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Jo e aplikueshme</p>						
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Institucioni ka ngritur Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe të Diplomuarve dhe mban kontakte të vazhdueshme me ta <i>[vizitë në institucion]</i>. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike dhe stafi akademik në këtë program studimi janë të gatshëm të ofrojnë në çdo kohë asistencë dhe ndihmë ndaj studentëve. GVJ gjen evidencë të përfshirjes së studentëve në projekte kërkimore dhe janë pjesë e punës në lidhje me artikuj shkencorë <i>[Tabelat Përmbledhëse_MSc CEN_shqip; Annex 20.5 DoS Annual Report 2021-2022]</i>.</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit është i hartuar në përputhje me fushën akademike dhe didaktike të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike dhe Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë. Programi i studimit është i kodifikuar me kodin 72MS061A. Institucioni zotëron kapacitetet e duhura për të zhvilluar në përputhje me standartet procesin mësimor në këtë program studimi. Institucioni përmes Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe të Diplomuarve</i></p>						

	mban kontakte me studentët e diplomuar dhe ofron mundësi të pjesëmarrjes në eventet që organizohen në institucion.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Universiteti “Epoka” ushtron aktivitetin e saj bazuar në dokumenta bazë ligjore: Statut dhe Rregullore Institucionale [Annex 1 Statute of Epoka University; Annex 1.1 Basic Regulation]. Pjesa e I-rë dhe II-të në Statut përshkruajnë funksionet dhe përgjegjësitë e organeve dhe autoriteteve drejtuese ndërsa Pjesa III-të përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e personelit [Annex 1 Statute of Epoka University]. Në Statut jepet qartë edhe veprimtaria e organeve kolegjiale, administrative dhe personelit (akademik dhe ndihmës të tij) ku rregullimi normativ i marrëdhënieve midis organeve, autoriteteve, stafit akademik dhe studentëve, ndërveprimi institucional i tyre, të drejtat dhe përgjegjësitë jepen qartë në këtë dokument. Disa detyra dhe role jepen edhe në nenin 6- 9 të Rregullore Themelore të Institucionit [Annex 1.1 Basic Regulation].</p> <p>Universiteti “Epoka” ka të përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë për strukturat të cilat drejtpërdrejt vënë në funksion, monitorojnë dhe garantojnë cilësinë në procesin mësimor. Pjesa III-të në Statut dhe neni 6-9 në Rregulloren Themelore të institucionit përshkruajnë qartë detyrat për personelin akademik duke specifikuar rolet dhe përgjegjësitë e tyre [Annex 1 Statute of Epoka University]</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Institucioni synon në strategjinë e tij të zhvillimit të rrisë bashkëpunimin me universitete partnere brenda dhe jashtë vendit [Annex 5 Epoka university strategy]. Institucioni ka hartuar edhe Planin Strategjik mbi Ndërkombëtarizimin [Annex 10.1 Strategic Plan on Internationalization];</p> <p>Konkretisht konstatojmë si vijon më poshtë të dhëna në lidhje me bashkëpunimet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 13 partnership me universitetet të huaja në Evropë (Bullgari, Greqi, 2 në Francë, Gjermani, 2 në Poloni, Spanje, Itali, Kroaci, 2 në Rumani) [Annex 22.1 List of partnership agreements]. 19 Marrëveshje Bashkëpunimi të lidhur me universitete (4 Itali, 3 Gjermani, 2 Rumani, Bullgari, Turqi, Dubai, 4 USA, Irak, Poloni, Greqi) [Annex 40 Memorandums of Understanding ëith partner Universitë; Annex 22.2 Samples of signed active agreements];

	<p>3. Bashkëpunime në kuadër të programit Horizon 2020 dhe Horizon Europe në fushën e mjekësisë;</p> <p>Ndër marrëveshjet e bashkëpunimit vlen të theksojmë marrëveshjet e lidhura me University of Montpellier, University of Lodz, State Higher Vocational School of Tarnoë, Bjelovar University of Applied Sciences, IES, Politecnico de Vigo, University of Debrecen, Hoscule Fulda-University of Applied Sciences, University of Peloponnese, të cilat kanë ekspertizë akademike në fushat e inxhinierisë dhe ICT dhe mbulojnë në mënyrë direkte këte program studimi.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni ka nënshkruar një sërë marrëveshje me kompanitë e biznesit me fokus zhvillimin e praktikave profesionale. <i>[Annex 22.1 List of partnership agreements; Annex 40 Memorandums of Understanding ëith partner Universities; Annex 22.2 Samples of signed active agreements.]</i>. GJV konstaton se këto marrëveshje jo vetëm lehtësojnë kryerjen e praktikave profesionale të studentëve, por shërbejnë edhe për të përforcuar bashkëpunimin me stafin akademik në drejtim të fushës së ekspertizës dhe kërkimit shkencor. <i>[takim me stafin akademik]</i>.</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>GJV u informua se gjithë të dhënat në lidhje me programin e studimit dhe aktivitetet përkatëse, përpunohen prej zyrave përkatëse dhe publikohen në raportet vjetore të Fakulteteve si dhe në Raportin Vjetor që institucioni përgatit për MAS. Një rol të veçantë në këtë drejtim luan Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike duke përgatitur raporte me përmbledhje të dhënash lidhur me arritjet akademike dhe kryesisht kërkimin shkencor lidhur me programin e studimit, duke përcaktuar edhe objektiva për të ardhmen si dhe elementë që duhen përmirësuar.</p> <p>Në raportin analitik të hartuar nga Departamenti i dedikohet hapësirë edhe vizitave e trajnimeve në seksionin 3. Training and Study Visit në faqet 64-71, ku ka marrë pjesë stafi akademik dhe studentët sipërfitues nga marrëveshjet e bashkëpunimit si edhe projektet ndërkombëtare ku Institucioni është pjesëmarrës.</p> <p><i>[Annex 27 Institutional Annual Report_2021_2022; Annex 26 Annual Report 2019-2020 CEN]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Universiteti "Epoka" ka hartuar dy dokumenta themelore përkatësisht Statuti dhe Rregullore Themelore që përcaktojnë qartë rolet dhe përgjegjësitë e stafit personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrative. Universiteti "Epoka" synon në strategjinë e saj të</p>

	<i>zhvillimit të rrisë ndërkombëtarizimin. Plan veprimi në këtë drejtim synon rritjen e nënshkrimit të marrëveshjeve të mirëkuptimit me shumë universitete partnere brenda dhe jashtë vëndit. Në kuadër të rritjes së aftësisimit të studentëve në drejtim të praktikës një sërë marreveshje janë nënshruar me kompani të biznesit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi i ciklit të dytë Mastër i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” është i ndërtuar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Programi i studimit i referohet nivelit 7 në Kornizën e Kualifikimeve Shqiptare [Annex 3 Regulation on second cycle study programs, neni 5]</p> <p>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë i cili ndjek një kurrikul të veçantë ku janë përcaktuar qartë lëndët, orët mësimore, orët laboratorike, praktika profesionale dhe projektin e diplomës. Organizimi i Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike”, si dhe lëndët e ofruara janë në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të dytë të studimeve. Programi përgatit studentët me njohuritë dhe aftësi në përputhje me kriteret e vendosura. Studimet janë të organizuara në lëndë e module dhe vlerësohen në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programet janë të organizuara në zbatim të të gjitha udhëzimeve të MAS [Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation; Annex 2.1 Syllabuses Part 1; Annex 2.1 Syllabuses Part 2; Annex 2.1 Syllabuses Part 3].</p> <p>Kurrikula e programit të studimit përcakton:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Programi i studimit është krijuar sipas standarteve dhe metodave në përputhje me sistemin evropian të Arsimit të Lartë; • Lëndët e programit të studimit jepen me kredite (ECTS); • Programi i studimit në shqyrtim ka një kohëzgjatje 2 vite dhe në total ka 120 kredite. Ngarkesa vjetore është 60 kredite me një numër total të lëndëve dhe moduleve 12, tema e diplomës dhe praktika profesionale. • Gjuha e mësimdhënies është gjuha angleze; • Numri i krediteve për semestër është 30 (ECTS); • Studenti që ndjek këtë program studimi duhet të marrë së paku 120 ECTS;

	<ul style="list-style-type: none"> • Teza e diplomimit ka 18 ECTS dhe praktika mësimore ka 12 ECTS; <p><i>[Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Mastër i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” i korrespondon Nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve duke fituar njohuritë, afësitë dhe kompetencat për tu punësuar në përfundim të studimeve në fushën e inxhinierisë kompjuterike. GVJ konstaton bazuar në evidencat e paraqitura nga institucioni se programi i studimit përmes organizimit të tij ofron aftësinë për të testuar dhe ndërtuar, për të aplikuar projekte në fushën e inxhinierisë kompjuterike, për të punuar në mënyrë të panvarur dhe në ekip, për të ngritur sipërmarrje dhe zhvilluar aplikacione në fushën e inxhinierisë kompjuterike.</p> <p>Nisur nga aftësitë e fituara, studentët në përfundim të ciklit të studimeve përgatiten të jetë i aftë dhe të përdorë gjerësisht aftësi të tilla si:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të kuptuarit e proceseve; Parimet në dizajnin inxhinierik; Të jetë i aftë të analizojë situata dhe të ofrojë alternativën më të mirë; Të kuptuarit dhe ndërlidhjen me softuerin; <p>Aftësitë e fituara janë reflektim i mënyrës së organizimit të procesit mësimor, të hartimit të kurrikulës, të përmbajtjes së lëndëve, të zhvillimit të praktikës lëndore dhe profesionale dhe sintetizimi i saj në përgatitjen e temës së diplomës.</p> <p><i>[Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation; Annex 2.1 Syllabuses Part 1; Annex 2.1 Syllabuses Part 2; Annex 2.1 Syllabuses Part 3].</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën për zhvillimin e praktikës profesionale. Praktika profesionale është shtuar përmes rekomandimeve në procesin e akreditimit të programit të studimit dhe tashmë në planin mësimor rezulton me 12 ECTS dhe zhvillohet në semetrin e dytë të vitit të dytë. Ngarkesa e saj është paraqitur edhe në planin mësimor. Praktika profesionale e vlerësuar me 12 ECTS ka një ngarkesë 240 orë në auditor dhe 60 orë jashtë tij <i>[Tabelat Përmbledhëse_MSc_CEN_shqip; Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation]</i>.</p> <p>Praktika profesionale zhvillohet në një kompani përmes marrëveshjeve të lidhura institucionale. Studenti i nënshtrohet një seri procedurash për zhvillimin, monitorimin dhe vlerësimin e tij në këtë program.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor.</p>	<p>Jo e aplikueshme</p>

<p>Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Jo e aplikueshme</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Universiteti “Epoka” ndjek një politikë të qartë në lidhje me kriteret e pranimit të studentëve, procedurat e pranimit dhe të regjistrimit të tyre. GVJ konstaton evidencë të qarta të vendosjes së kriterëve të pranimit të cilat miratohen çdo vit dhe burojnë nga njësia bazë [Annex 17 Admission Criteria for undergraduate and Graduate programs for 2023-2024].</p> <p>Universiteti “Epoka” është një institucion i Arsimit të Lartë i cili përmbush kërkesat e Procesit të Bolonjës ndërsa gjuha në programet e studimit është gjuha angleze. Aktualisht 29% e stafit akademik me kohë të plotë dhe 4% e studentëve janë ndërkombëtarë. Bazuar për sa më sipër, GVJ konstaton si kriter të veçantë pranimi në lidhje me gjuhën e huaj.</p> <p>Në lidhje me kriteret e pranimit konstatojmë si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pranohen në programin e studimit studentët të cilët zotërojnë një diplomë të nivelit Bachelor ose në disiplina të ngjashme ekuivalente dhe të aprovuara nga një komision shkencor i posaçëm i ngritur në njësinë bazë; 2. Një minimum CGPA 2.50 nga 4.00 për studentët të cilët kanë përfunduar studimet në Universitetin “Epoka” ose 7.00 nga 10.00 për studentët të cilët janë diplomuar në IAL të tjera brenda vendit 3. Pranohen edhe studentë me një CGPA 2.00 – 2.49 për studentët të cilët kanë përfunduar studimet në Universitetin “Epoka” ose 6.00-6.99 për studentët të cilët janë diplomuar në IAL të tjera brenda vendit më kushtin e kalimit të një provimi/ekzaminimi të kryer nga komisioni shkencor i posaçëm i ngritur në njësinë bazë [Annex 17 Admission Criteria for undergraduate and Graduate programs for 2023-2024].

	<p>Institucioni propozon çdo vit edhe kuotat për programet e studimit. GVJ konstaton ndjekjen e një procedure korrekte në lidhje me diskutimin dhe miratimin e kuotave për programin e studimit [Annex 51 Admission Quotas for 2022-2023 Academic year]. Universiteti “Epoka” ndjek një politikë të qartë në lidhje me garantimin e barazisë së të drejtave të çdo studenti që ndjek studimet në këtë institucion. GVJ konstaton hartimin e politikave në lidhje me studentët me aftësi të kufizuar dhe sistemin e bursave [Annex 20.2 Directive on students ëith disability; Annex 43 Directive On Scholarships].</p>			
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të nevojshme në nivel</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” është i ngjashëm në masën 70% me programet që kanë të njëjtën fushë studimi dhe emertesë brenda vendit. [Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation; Annex 2.1 Syllabuses Part 1; Annex 2.1 Syllabuses Part 2; Annex 2.1 Syllabuses Part 3]</p>			
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike është i kodifikuar me kodin 72MS061A.</p>			
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Jo e aplikueshme</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton një përmbushje e plotë e kriterëve në këtë standart. Programi i studimit i korrespondon Nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi i studimit ka objektiva të qartë në drejtim të përgatitjes së studentit. Kriteret e pranimit vendosen në cdo vit dhe kriteri I gjuhes së huaj prevalon në të. Institucioni zhvillon punë në drejtim të kodifikimit të gjithë programeve që ofron në të tre nivelet. Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike është i kodifikuar me kodin 72MS061A.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																									
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi i studimit Mastër i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë. Organizimi, struktura dhe funksionimi i Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë janë përcaktuar qartë në Statut dhe në Rregulloren Themelore [Annex 1 Statute of Epoka University; Annex 1.1 Basic Regulation]. Dispozitat për organizimin e programit të studimit shprehen qartë në rregulloret përkatësisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullore për ciklin e dytë të studimeve; 2. Rregullore për transferimin e studimeve; 3. Rregullore e organizimit të provimeve dhe diplomimit; <p>ku detyrat dhe përgjegjësitë e njesisë bazë janë të shprehur qartë. [Annex 3 Regulation on second cycle study programs; Annex 10.2 regulation-on-student-exchange; Annex 13 Regulation on graduate studies and examinations].</p> <p>Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë përbëhet nga tre departamente përkatësisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Arkitekturës; 2. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit; 3. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike; <p>Bazuar edhe në kuadrin ligjor në fuqi GVJ konstaton se njësia kryesore përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 25 të Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me stafin akademik të angazhuar më kohë të plotë në departamente.</p> <p>GVJ bazuar edhe në evidencat e paraqitur nga institucioni, takimet e zhvilluar me stafin akademik konstaton se Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike angazhon për programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” një staf më përvojë në fushën e mësimdhënies dhe me eksperiencë të gjerë në fushën e inxhinierisë kompjuterike. GVJ konstaton angazhimin e stafit akademik të huaj të cilët sjellin edhe përvojën nga universitete të huaja duke rritur cilësinë në mësimdhënie [takim me stafin akademik].</p> <p>Konkretisht kjo njësi bazë ka të punësuar:</p> <table border="1" data-bbox="624 1554 1385 1848"> <thead> <tr> <th colspan="5">IAL “EPOKA”/ Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë</th> </tr> <tr> <th colspan="5">2018-2019</th> </tr> <tr> <th>Njësia Bazë</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th colspan="2">Total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike</td> <td>13</td> <td>6</td> <td colspan="2">19</td> </tr> <tr> <th colspan="5">IAL “EPOKA”/ Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë</th> </tr> </tbody> </table>	IAL “EPOKA”/ Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë					2018-2019					Njësia Bazë	PAE	PAK	Total		Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike	13	6	19		IAL “EPOKA”/ Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë				
IAL “EPOKA”/ Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë																										
2018-2019																										
Njësia Bazë	PAE	PAK	Total																							
Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike	13	6	19																							
IAL “EPOKA”/ Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë																										

2019-2020			
Njësia Bazë	PAE	PAK	Total
Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike	15	7	22
IAL "EPOKA"/ Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë			
2020-2021			
Njësia Bazë	PAE	PAK	Total
Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike	16	4	20
IAL "EPOKA"/ Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë			
2021-2022			
Njësia Bazë	PAE	PAK	Total
Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike	18	3	21
IAL "EPOKA"/ Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë			
2022-2023			
Njësia Bazë	PAE	PAK	Total
Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike	17	3	20

Për vitin akademik 2022-2023 në këtë njësi bazë janë angazhuar sic shprehet edhe në tabelë 17 staf akademik me kohë të plotë (2 Prof. Dr; 1 Prof. Asoc. Dr; 5 Dr; 9 MSc) dhe PAK janë angazhuar në total 3 (3 Dr). Bazuar në të dhënat e shprehur në tabelën e mësipërme konstatohet një rritje të përbërjes së njësive baze në lidhje me stafin akademik si në grada shkencore ashtu edhe në numër duke e bërë këtë njësi bazë një structure që mbart peshën kryesore në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë [Tabelat Përmbledhëse_MSc_CEN_shqip].

Universiteti "Epoka" ka marrë akreditimin institucional periodik (Vendim i Bordit të Akreditimit të Republikës së Shqipërisë nr.54 datë 16.12.2021).

Programi i studimit është program i akredituar dhe tashmë është në process të vlerësimit për herë të tretë të tij (vendimi BA nr.286 datë 06.07.2012 dhe Vendimi nr. 52 datë 28.09.2018).

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në	Njësia bazë angazhon një personel ndihmës akademik për procesin mësimor në programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike". Konkretisht bazuar në vizitat e kryer në institucion evidentuam njësinë e IT-së dhe stafin ndihmës akademik (shumica të
---	--

fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	diplomuar në këtë program studimi në universitetin “Epoka”) të angazhuar në lidhje me mirëmbajtjen e sallave laboratorike, në ndihmesën ndaj stafit akademik dhe dhënies e asistencës studentëve [vizita në institucion].		
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Njësia bazë ndjek një politikë të qartë në lidhje me zhvillimin e praktikës profesionale. Një udhëzues i posacëm është hartuar në këtë drejtim dhe zbatohet nga stafi akademik dhe studentët. [Annex 19 Guideline on the Conduct of the Professional Practice]. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se programi i studimit nuk ka një anëtar të stafit akademik të njësisë bazë të angazhuar si koordinator i programit të studimit, i cili të mbulojë drejtpërdrejt ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit. Rolin e koordinorit në zhvillimin e praktikës profesionale e luan përgjegjësi i Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike. Duke marrë parasysh edhe detyrat e tjera që përgjegjësi duhet të kryejë, GVJ rekomandon caktimin e një anëtari tjetër nga njësia bazë në këtë rol. Sa i përket praktikës profesionale, studentëve i caktohet një mentor, anëtar i stafit akademik, i cili ndjek vijueshmërinë e tyre gjatë zhvillimit të praktikës dhe këshillon studentët gjatë përgatitjes së relacionit.		
Konkluzione	GVJ evidenton se programi i studimit ka një plan mësimor të qartë. Programi i studimit është program i akredituar dhe tashmë është në proces të vlerësimit për herë të treta të tij (vendimi BA nr.286 datë 06.07.2012 dhe Vendimi nr. 52 datë 28.09.2018). Programi i studimit angazhon një staf akademik me përvojë dhe eksperience. Rregullorja e Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë përcakton edhe Koordinatorin për zhvillimin e praktikës profesionale.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën	GVJ konstatoi se programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” paraqitet i detajuar në elementët e tij që përfshijnë: <ul style="list-style-type: none"> - Planin mësimor; - Rregulloren e programit të studimeve të ciklit të dytë; - Programet (syllabuset) e lëndëve; - Modelin e diplomës. - Rregulloren për transferimin e studimeve; - Udhëzues për zhvillimin e praktikës profesionale;

dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<ul style="list-style-type: none"> - Rregulloren për organizimin e provimeve dhe diplomimit; - Udhëzues të ndryshëm në lidhje me procesin mësimor, ngarkesat etj. <p>[Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation; Annex 2.1 Syllabuses Part 1; Annex 2.1 Syllabuses Part 2; Annex 2.1 Syllabuses Part 3; Annex 42 Directive On The Teaching Load; Annex 14 Diploma format and Diploma supplement; Annex 19 Guideline on the Conduct of the Professional Practice; Annex 17.2 Directive on Student Transfer].</p> <p>Ky informacion i shoqëruar me kuotat dhe kriteret e përvitshme të pranimit përbëjnë informacionin bazë të programit të studimit, i cili disponohet nga institucioni dhe që vihet në dispozicion të studentëve [https://www.epoka.edu.al/].</p>																														
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike”, si dhe lëndët e ofruara në të janë në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të dytë të studimeve, siç janë të përcaktuara në VKM nr. 41, 24.01.2018. Programi është i ndërtuar mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, dhe krijon mundësi në thellimin e njohurive në përputhje me kriteret e vendosura. Referuar programit të studimit ndarja sipas kategorive per vitin 2022-2023 në të cilat përfshihen lëndët dhe modulet është si më poshtë:</p> <p>Kategoria A: 7.5 ECTS Kategoria B: 67.5 ECTS Kategoria C: 15 ECTS Kategoria D: 12 ECTS Kategoria E: 18 ECTS</p> <table border="1" data-bbox="539 1077 1284 1305"> <thead> <tr> <th>Kategorite</th> <th>ECTS</th> <th>%</th> <th>Standarti</th> <th>Vleresimi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Kategoria "A"</td> <td>7.5</td> <td>6.25%</td> <td>5-10%</td> <td>e pëmbushur</td> </tr> <tr> <td>Kategoria "B"</td> <td>67.5</td> <td>56.25%</td> <td>50-60%</td> <td>e pëmbushur</td> </tr> <tr> <td>Kategoria "C"</td> <td>15</td> <td>12.50%</td> <td>12-20%</td> <td>e pëmbushur</td> </tr> <tr> <td>Kategoria "D"</td> <td>12</td> <td>10%</td> <td>10%</td> <td>e pëmbushur</td> </tr> <tr> <td>Kategoria "E"</td> <td>18</td> <td>15%</td> <td>10-15%</td> <td>e pëmbushur</td> </tr> </tbody> </table> <p>Plani mësimor ka pësuar ndryshime të cilat kanë rrjedhur edhe si pasoje e vendimeve të reja në lidhje me organizimin e lëndëve. Tabela më poshtë jep një dinamikë të saj për periudhën 2018-2023.</p>	Kategorite	ECTS	%	Standarti	Vleresimi	Kategoria "A"	7.5	6.25%	5-10%	e pëmbushur	Kategoria "B"	67.5	56.25%	50-60%	e pëmbushur	Kategoria "C"	15	12.50%	12-20%	e pëmbushur	Kategoria "D"	12	10%	10%	e pëmbushur	Kategoria "E"	18	15%	10-15%	e pëmbushur
Kategorite	ECTS	%	Standarti	Vleresimi																											
Kategoria "A"	7.5	6.25%	5-10%	e pëmbushur																											
Kategoria "B"	67.5	56.25%	50-60%	e pëmbushur																											
Kategoria "C"	15	12.50%	12-20%	e pëmbushur																											
Kategoria "D"	12	10%	10%	e pëmbushur																											
Kategoria "E"	18	15%	10-15%	e pëmbushur																											

Kategorite	Viti 2018-2019		Viti 2020-2021; 2021-2022		Viti 2022-2023	
	Nr. i Lendeve	Kredite/ECTS per secilen lende	Nr. i Lendeve	Kredite/ECTS per secilen lende	Nr. i Lendeve	Kredite/ECTS per secilen lende
Kategoria "A"	3	4/7.5	1	4/7.5	1	4/7.5
Kategoria "B"	11	4/7.5	11	4/7.5	9	4/7.5
Kategoria "C"	-	-	-	-	2 grupe lende me zgjedhje	4/7.5
Kategoria "D"	1	4/7.5	Punim Diplome	0/15	Praktika	0/12
Kategoria "E"	-	-	Teza	0/30	Teza	0/18
Kategoria "F"	Punim Diplome dhe Teza	5.5/15 dhe 0/30				
Total		120		120		120

Studimet janë organizuar në lëndë e module dhe vlerësohen në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programet janë të organizuara në përputhje me të gjitha udhëzimet e MAS. Gjuha e programit mësimor është gjuha angleze. Numri i lëndëve është 14, duke shtuar edhe praktikën mësimore dhe mbrojtjen e diplomës, janë 16. Lëndët janë të ndara sipas semestrave dhe krediteve për të balancuar peshën e orëve në auditor. Programi zgjat 2 vite me 4 semestra, dy në të parin, dy në vitin e dytë. Çdo vit akademik 60 ECTS.

Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike" përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.

Plani mësimor si elementi bazë i programit të studimit përmban:

- Ndarjen e lëndëve sipas aktiviteteve formuese;
- Ndarjen e lëndëve sipas viteve dhe semestrave;
- Dhënien për secilën lëndë të ngarkesës në kredite, numrit total të orëve, numrit të orëve në auditor dhe jashtë auditorit;
- Ndarjen e ngarkesës në auditor për secilën lëndë në elementët përbërës si leksione, seminare dhe detyra/projekte kursi.
- Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor;

GVJ nga shqyrtimi i përmbajtjes së programit mësimor konstaton:

- Mesimi zhvillohet në 15 javë kalendarike;
- Ngarkesa mësimore totale është 3000 orë;
- Ngarkesa në auditor është 1500 orë;
- Ngarkesa jashtë auditorit është 1500 orë;

[Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation; Annex 2.1 Syllabuses Part 1; Annex 2.1 Syllabuses Part 2; Annex

	2.1 Syllabuses Part 3; Annex 42 Directive On The Teaching Load; Tabelat Përmbledhëse_MSc_CEN_shqip]																																																											
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	<p>Të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të krediteve jepen në Rregulloren Themelore, në Udhëzimet për transferimin e studimeve. Këto informacione mund të aksesohen edhe nëpërmjet faqes ëeb të institucionit</p> <p>Në lidhje me kriteret e pranimit konstatohet si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pranohen në programin e studimit studentët të cilët zotërojnë një diplomë të nivelit Bachelor ose në disiplina të ngjashme ekuivalente dhe të aprovuara nga një komision shkencor i posaçëm i ngritur në njësinë bazë; 2. Një minimum CGPA 2.50 nga 4.00 për studentët të cilët kanë përfunduar studimet në Universitetin “Epoka” ose 7.00 nga 10.00 për studentët të cilët janë diplomuar në IAL të tjera brenda vendit 3. Pranohen edhe student me një CGPA 2.00 – 2.49 për studentët të cilët kanë përfunduar studimet në Universitetin “Epoka” ose 6.00-6.99 për studentët të cilët janë diplomuar në IAL të tjera brenda vendit me kushtin e kalimit të një provimi/ekzaminimi të kryer nga komisioni shkencor i posaçëm i ngritur në njësinë bazë <p>[Annex 17 Admission Criteria for undergraduate and Graduate programs for 2023-2024].</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Kuotat</th> <th>Studentë brenda Shqiperisë</th> <th>Troje shqiptare</th> <th>Të huaj</th> <th>Transferime</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td> <td>50</td> <td>40</td> <td>3</td> <td>2</td> <td>5</td> </tr> </tbody> </table> <p>[Annex 51 Admission Quotas for 2022-2023 Academic year]</p> <p>Për transferimin e studimeve Institucioni ka hartuar edhe një udhëzim të veçantë. Në vizitën e kryer në sekretarinë mësimore konstatohet të dhënat si vijon më poshtë në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar dhe transferimet e kryera në periudhën e marrë në shqyrtim [Annex 17.2 Directive on Student Transfer].</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Sipas viteve akademike</th> <th>Të regjistruar për herë të parë</th> <th>Student të transferuar</th> <th>Studentë të larguar</th> <th>Ndërprerë studimet</th> <th>Total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td> <td>40</td> <td>1(Viti II)</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>41</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>25</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>25</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>11</td> <td>2 (Viti II)</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>13</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>20</td> <td>2 (Viti II)</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>22</td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> <td>16</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>16</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td>117</td> </tr> </tbody> </table>						Viti akademik	Kuotat	Studentë brenda Shqiperisë	Troje shqiptare	Të huaj	Transferime	2022-2023	50	40	3	2	5	Sipas viteve akademike	Të regjistruar për herë të parë	Student të transferuar	Studentë të larguar	Ndërprerë studimet	Total	2022-2023	40	1(Viti II)	-	-	41	2021-2022	25	-	-	-	25	2020-2021	11	2 (Viti II)	-	-	13	2019-2020	20	2 (Viti II)	-	-	22	2018-2019	16	-	-	-	16	Total					117
Viti akademik	Kuotat	Studentë brenda Shqiperisë	Troje shqiptare	Të huaj	Transferime																																																							
2022-2023	50	40	3	2	5																																																							
Sipas viteve akademike	Të regjistruar për herë të parë	Student të transferuar	Studentë të larguar	Ndërprerë studimet	Total																																																							
2022-2023	40	1(Viti II)	-	-	41																																																							
2021-2022	25	-	-	-	25																																																							
2020-2021	11	2 (Viti II)	-	-	13																																																							
2019-2020	20	2 (Viti II)	-	-	22																																																							
2018-2019	16	-	-	-	16																																																							
Total					117																																																							

	GVJ është i mendimit se praktikat e prezantuara për transferim studimesh dëshmojnë për procedura të qarta dhe transparente të zbatuara nga institucioni [Ev. Vizita në Sekretarinë Mësimore].
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Elementë më të detajuar për lektorin apo lektorët që do të zhvillojnë lëndën, semestrin kur zhvillohet, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti, elementët e mësimdhënies, detyrimet për frekuentimin, literaturën, mënyrën e shlyerjes së lëndës dhe peshën e elementëve të ndryshëm në vlerësimin final jepen në syllabuset e lëndëve [Annex 2.1 Syllabuses Part 1; Annex 2.1 Syllabuses Part 2; Annex 2.1 Syllabuses Part 3]. GVJ është i mendimit se syllabuset e lëndëve respektojnë të njëjtin standard, përmbajnë gjithë elementët e nevojshëm përcaktuar në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Programi i studimit ka pësuar përmirësime të vazhdueshme të cilat nuk tejkalojnë masën 20% [Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation; Annex 2.1 Syllabuses Part 1; Annex 2.1 Syllabuses Part 2; Annex 2.1 Syllabuses Part 3]. Përmirësimet kanë konsistuar në: <ol style="list-style-type: none"> 1. Përmbajtjen e programeve lëndore; 2. Grupimin e lëndëve më zgjedhje dhe rritjen e numrit të tyre duke rritur profilizimin e studentit në fusha të veçanta; 3. Rigrupimin e lëndëve në disiplina në përputhje me vendimet e dhëna nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve; Përmirësimet në programin e studimit janë reflektim i kërkesave të tregut të punës, zhvillimet e shpejta në fushën e inxhinierisë kompjuterike dhe përvojat e fituara nga stafi akademik përmes pjesëmarrjes së tij në konferenca dhe përmes programeve exchange. Përmirësimet burojnë nga departamenti i inxhinierisë kompjuterike, miratohen në Dekanat, në Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave dhe miratohen në Senatit Akademik Procedura e plotë hartohet në gjuhën angleze dhe arkivohet në institucion [vizitë në institucion].
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> • Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë dhe Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike disponon të gjithë informacionet e nevojshme për organizimin dhe vënien në funksionim të programit të studimit të ciklit të dytë “Inxhinieri Kompjuterike”. • Organizimi i programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike”, si dhe lëndët e ofruara në të janë në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të dytë të studimeve, siç janë të përcaktuara në VKM nr. 41, 24.01.2018. Programi është i ndërtuar mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, dhe krijon mundësi në thellimin e njohurive në përputhje me kriteret e vendosura.

	<ul style="list-style-type: none"> Lëndët janë të ndara sipas semestrave dhe krediteve për të balancuar peshën e orëve në auditor. Programi i studimit zgjat dy vite me katër semestra. Çdo vit akademik 60 ECTS. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. Programi mësimor nuk ka pësuar ndryshime që tejkalojnë masën mbi 20%. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe takimet në institucion, GVJ është i mendimit se përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve mundësojnë, njohuri, aftësi dhe kompetenca të cilat garantojnë formimin e nevojshëm për punësim të studentëve. Përmbajtja e programit mësimor mundëson studentët të thellojnë njohuritë në fushën e inxhinierisë kompjuterike dhe programimit. Ngarkesa mësimore ka një shpërndarje të drejtë të orëve laboratorike, seminareve, detyra/projekte kursi. Në planin mësimor evidentojmë inkorporim të orëve laboratorike brenda seminareve duke sjellë një konkretizim në laborator të tematikës së zhvilluar në leksion. Infrastruktura në institucion dhe organizimi i lëndëve duke i dhënë peshën e duhur edhe aftësimin në praktikë të tyre është një tregues i cilësisë së programit mësimor [takime në institucion; Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation]. Plani mësimor dhe përmbajtja e lëndëve mundëson studentët të thellojnë njohuritë në fushën e inxhinierisë kompjuterike. Plani mësimor për vitin 2022-2023 përmban si vijon më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Tipi i veprimtarisë</th> <th>Lëndët/Modulet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Aktivite në disiplina të përgjithshme (A)</td> <td>Metoda e Kërkimit</td> </tr> <tr> <td>Veprimtari në karakterizimin e disiplinave të programit të studimit (B)</td> <td>10. Sistemi i avancuar i menaxhimit të bazës së të dhënave; 11. Minimi i të dhënave; 12. Koncepte të avancuara në rrjetet kompjuterike; 13. Arkitekturë e avancuar kompjuterike;</td> </tr> </tbody> </table>	Tipi i veprimtarisë	Lëndët/Modulet	Aktivite në disiplina të përgjithshme (A)	Metoda e Kërkimit	Veprimtari në karakterizimin e disiplinave të programit të studimit (B)	10. Sistemi i avancuar i menaxhimit të bazës së të dhënave; 11. Minimi i të dhënave; 12. Koncepte të avancuara në rrjetet kompjuterike; 13. Arkitekturë e avancuar kompjuterike;
Tipi i veprimtarisë	Lëndët/Modulet						
Aktivite në disiplina të përgjithshme (A)	Metoda e Kërkimit						
Veprimtari në karakterizimin e disiplinave të programit të studimit (B)	10. Sistemi i avancuar i menaxhimit të bazës së të dhënave; 11. Minimi i të dhënave; 12. Koncepte të avancuara në rrjetet kompjuterike; 13. Arkitekturë e avancuar kompjuterike;						

		14. Përpunimi dixhital i imazhit; 15. Vizioni kompjuterik; 16. Matematikë e avancuar për shkencë kompjuterike 17. Hyrje në rrjetin neural; 18. Mësimi i makinerisë;
Aktivitetet në disiplina të ngjashme ose/dhe integruese që lidhen me disiplinat karakterizuese (C)		3. Grupi i lëndëve me zgjedhje 4. Grupi i lëndëve me zgjedhje
Veprimtari në disiplinat me zgjedhje (D)		Praktika profesionale
Tezë Masteri (E)		Teza
	<p>Plani mësimor është ristrukturuar dhe siç evidentohet edhe në tabelën mësipër i është dhënë një prioritet kategorizimit të lëndëve të detyrueshme në disipinën “B” (nga 11 lëndë për vitin akademik 2020-2022 në 9 lëndë për vitin akademik 2022-2023) dhe rritjes së grupit të lëndëve me zgjedhje duke i dhënë mundësi studentit të profilizohet [Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation].</p> <p>Programi i studimit është përmirësuar në vijim të rekomandimeve të dhëna në procesin e fundit të akreditimit. Konkretisht në program i është dhënë një rëndësi praktikës profesionale si një komponent i rëndësishëm në aftësim më shumë në drejtim të praktikës të studentëve. Praktika profesionale zhvillohet në semestritin e dytë të vitit të dytë dhe ka një peshë 12 ECTS. Në lidhje me zhvillimin e praktikës Institucioni ka hartuar edhe një udhëzues të vecantë. Institucioni ka nënshkruar shumë marrëveshje me kompani biznesi në drejtim të zhvillimit të praktikës profesionale. Koordinator i programit është përgjegjës edhe për organizimin, monitorimin e zhvillimit të praktikës profesionale. Takimi me studentët tregoi një vlerësim nga ana e tyre për praktiken profesionale.</p>	
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Programi mësimor i ciklit të dytë “Inxhinieri Kompjuterike” ka një strukturë të qartë dhe të mirëorganizuar të lëndëve [Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation]. Ky program përmban 12 lëndë (secila me 7.5ECTS), praktikën profesionale dhe temën e diplomës. Organizimi i lëndëve bëhet në 5 disiplina në përputhje me kornizën ligjore në fuqi (përmendur edhe në kriteret më lart). Programi mësimor është hartuar me objektiva të qarta dhe pritshmëri për studentin në fund të diplomimit të tij të cilat GVJ i gjen të shprehur në rregulloren themelore dhe në strategjitë për zhvillim të institucionit [Annex 5 Epoka university strategy; Annex 5.1 Department strategic plan, mission of the study program]. Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” ofron një shpërndarje të drejtë të lëndëve në semestra. GVJ konstaton një balancim	

të drejtë të lëndëve me karakter detyrues dhe lëndët me zgjedhje. Programi mësimor zhvillohet në tre semestra ndërsa në semestrin e katërt fokus i jepet praktikës profesionale dhe temës së diplomës duke i dhënë një ngarkesë pune jashtë auditorit përkatësisht 510 orë (450 orë për praktikën profesionale dhe 60 orë për tezën e masterit). Bazuar në evidencat e paraqitur nga institucioni për planin mësimor të programit të studimit konkludojmë shpërndarjen si vijon më poshtë të moduleve sipas disiplinave të përcaktuara edhe në VKM nr 41/ 2018.

Semestri	Numri i lëndëve për cdo disiplinë në planin mësimor				
	"A"	"B"	"C"	"D"	"E"
Semestri I	1	2	1	-	-
Semestri II	-	4	-	-	-
Semestri III	-	3	1	-	-
Semestri IV	-	-	-	Praktika profesionale	Teza e Masterit
Total	1	9	2	Praktika profesionale	Teza e Masterit

Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.

GVJ është i mendimit se në përgjithësi struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit Master i Shkencave dhe e përafërt me programe të ngjashme si brenda ashtu edhe jashtë vendit [Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation].

GVJ konstaton se plani mësimor nuk përmban orët laboratorike si ngarkesë ndonëse në programet lëndore janë dhënë edhe peshat përkatëse të tyre. *Për sa më sipër GVJ rekomandon përfshirjen e ngarkesës së orëve laboratorike edhe në planin mësimor ndonëse në takimet e zhvilluar stafi akademik dëshmoi për inkomporim të tyre në orët praktike.*

	Shpërndarja e ngarkesës në javë			Shpërndarja e ngarkesës në javë			Shpërndarja e ngarkesës në semestër		
	Leksione (ore)	Praktike (ore)	Total	Leksione (ore)	Praktike (ore)	Ore jashtë auditorit	Leksione (ore)	Praktike (ore)	Ore jashtë auditorit
Semestri I	3	2	5	48	32	107	192	128	430
Semestri II	3	2	5	48	32	107	192	128	430
Semestri III	3	2	5	48	32	107	192	128	430
Praktika profesionale Semestri IV	-	15	-	-	-	-	-	240	60
Teza e Masterit Semestri IV	-	-	-	-	-	-	-	-	450

Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik

Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë arritjen e objektivave formues të përcaktuara në këtë program studimi. Gjithashtu vlerësimi me kredite ECTS lejon transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit

<p>mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>të studimit [Annex 27 Institutional Annual Report 2021_2022; Tabelat Përmbledhëse_MSc CEN_shqip].</p> <table border="1" data-bbox="560 315 1423 685"> <thead> <tr> <th>Programi i studimit</th> <th>Numri total i studentëve të diplomuar</th> <th>Numri total i studentëve të punësuar në përputhje me diplomën</th> <th>Numri total i studentëve të punësuar jo në përputhje me diplomën</th> <th>% në punësim</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Master I Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike"</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> <td>7</td> <td>6</td> <td>1</td> <td>85.7%</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>21</td> <td>14</td> <td>2</td> <td>66.7%</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>9</td> <td>8</td> <td>1</td> <td>85.7%</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>23</td> <td>8</td> <td>1</td> <td>34.8%</td> </tr> </tbody> </table>	Programi i studimit	Numri total i studentëve të diplomuar	Numri total i studentëve të punësuar në përputhje me diplomën	Numri total i studentëve të punësuar jo në përputhje me diplomën	% në punësim	Master I Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike"					2018-2019	7	6	1	85.7%	2019-2020	21	14	2	66.7%	2020-2021	9	8	1	85.7%	2021-2022	23	8	1	34.8%
Programi i studimit	Numri total i studentëve të diplomuar	Numri total i studentëve të punësuar në përputhje me diplomën	Numri total i studentëve të punësuar jo në përputhje me diplomën	% në punësim																											
Master I Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike"																															
2018-2019	7	6	1	85.7%																											
2019-2020	21	14	2	66.7%																											
2020-2021	9	8	1	85.7%																											
2021-2022	23	8	1	34.8%																											
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ konstaton se për vitin 2022-2023 janë berë ndryshime në disiplina dhe në lëndët me zgjedhje pjesë përbërëse e programit mësimor [tabela përmbledhëse, [Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation; Annex 2.1 Syllabuses Part 1; Annex 2.1 Syllabuses Part 2; Annex 2.1 Syllabuses Part 3;].</p> <p>GVJ u njoh me programet lëndore (syllabuset) e paraqitur nga institucioni. Diskutime në lidhje me to u zhvilluan edhe gjatë takimeve me stafin akademik dhe përfaqësues të institucionit. Për programin e studimit të ciklit të dytë "Inxhinieri Kompjuterike" institucioni ka paraqitur të gjithë syllabuset me detajimet përkatëse të tyre. Në përgjithësi institucioni i përmbahet formatit të kërkuar nga institucionet përkatëse të arsimit. Syllabuset përmbajnë elementët e nevojshëm që japin një përshkrim të përmbajtjes së lëndës dhe veprimtarisë që do të zhvillohet me studentin. Konkretisht kontatojmë elementët bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Emërtimi i lëndës; Përshkrimi i lëndës Objektivat e lëndës; Konceptët bazë të lëndës Tematika e lëndës; Literatura (e detyrueshme dhe suplementare); Punë laborator; Përdorimi kompjuterik; Rezultatet e të mësuarit nga lënda; Komptencat kompjuterike të fituara; Metodat e vlerësimit të lëndës (shprehur në sasi dhe në përqindje); Ngarkesa e studentit në këtë lëndë; Ngarkesa totale dhe llogaritja në ECTS; Shënime nga lektori për këtë lëndë; <p>Literatura që i ofrohet studentit është bashkëkohore dhe në gjuhën angleze. Mësimdhënia në gjuhën angleze ka dhënë lehtësi tek studentët në lidhje me përdorimin e literaturës së fundit pa qenë e nevojshme përkthimi i saj në gjuhën shqipe. Aksesi në bibliotekën virtuale krijon lehtësi dhe avantazhe për studentët në lidhje me literaturën e huaj [Annex 2.1 Curricula of study program</p>																														

	<p>for each academic year since last accreditation; Annex 2.1 Syllabuses Part 1; Annex 2.1 Syllabuses Part 2; Annex 2.1 Syllabuses Part 3; takim me stafin akademik, takim me studentët].</p> <p>GVJ konstaton nga plani mësimor se orët laboratorike janë të inkorporuar në orët e praktikës/seminare. GVJ nuk gjeti evidence të tematikave në lidhje me orët e praktikës dhe tematika e orëve laboratorike dhe GVJ rekomandon përfshirjen e tyre në përmbajtjen e syllabuseve.</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike”, i vlerësuar në përmbajtje nga GVJ, garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për një program studimi të ciklit të dytë. Nga takimet me studentët rezultoi se realizimi faktik i programit të studimit është brenda pritshmërive të tyre. Studentet shprehën kënaqësi në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, organizimin e tij dhe veçanërisht dhanë mendim pozitiv për praktikën profesionale dhe mundësitë që ata kanë në lidhje me punësimin e tyre pas diplomimit.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ofron program të ciklit të parë “Inxhinieri Kompjuterike” dhe në vijim ofron edhe program Master i Shkencave në këtë drejtim. Në takimin me studentët u konstatua dëshira e tyre për vazhdimin e studimeve të thelluara në këtë drejtim. Bashkëpunimet e vazhdueshme me sipërmarrje private dhe institucione shtetërore ka ofruar mundësi jo vetëm në zhvillimin e praktikave profesionale por edhe në punësimin e studentëve.</p>
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” është një program i cili kombinon pjesën teorike me atë praktike. Programi zhvillohet gradualisht me nga 5 lëndë-module në secilin semestër, në total 10 në secilin vit akademik.</i> • <i>Shpërndarja e krediteve është e njëjtë për të gjithë lëndët.</i> • <i>Programi mësimor ka një strukturë të qartë dhe të mirëorganizuar të lëndëve.</i> • <i>Programi mësimor është hartuar me objektiva të qarta dhe pritshmëri për studentin në fund të diplomimit të tij. Programi i Studimit, lëndët-modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit.</i> • <i>Vlerësimi me kredite ECTS dhe kredite amerikane lejon transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit. Universiteti “Epoka” përcakton qartë në rregullore kriteret dhe procedurat në transferimin e studimeve.</i> <p>Bazuar në analizën e kryer GVJ për këtë standart ofron rekomandimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • GVJ rekomandon përfshirjen e ngarkesës së orëve laboratorike edhe në planin mësimor.

	<ul style="list-style-type: none"> GVJ rekomandon përfshirjen e tematikës së orëve laboratorike dhe seminareve në programet lëndore. 		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Universiteti “Epoka” zbaton një politikë të qartë në lidhje me përmirësimet në programin e studimeve. Konkretisht është në zbatim “Politika për mësimdhënien, mësimnxënien dhe cilësia në to” e cila gjen vend edhe në programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” [Annex 11 Policies for Learning, teaching and quality teaching]. Programi i studimit ka pësuar në vite ndryshime përmes zbatimit të “Politikës për një përmirësim të vazhdueshëm në programet e studimit” [Annex 11.1 Policy on Continuous Improvement of Study Program]. Universiteti në mënyrë të vazhdueshme vlerëson dhe përmirëson cilësinë në programet e studimit për të arritur një nivel të lartë efieçence për studentët dhe stafin akademik. GVJ konstaton se rishikimi i programeve të studimit administrohet nga disa struktura si vijon më poshtë;</p> <ol style="list-style-type: none"> Njësia bazë – Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike; Njësia kryesore-Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë; Komisioni për Zhvillimin e Kurrikulës e cila ndodhet në varësinë e Komisionit Permanent për Sigurimin e Cilësisë; Senati Akademik; <p>Propozimet burojnë nga njësia bazë e cila në qendër të kërkesës për ndryshime në programin e studimit bazohet në mendimin dhe në propozimet e aktoreve të tjerë kryesore në program e studimit siç janë kompanitë ku studentët kryejnë edhe praktikatat profesionale, kompani me të cilat bashkëpunojnë në kuadër të projekteve kërkimore shkencore, modeleve më të mira të biznesit dhe në mendimin e studentëve të diplomuar [Annex 4 Company satisfaction survey]. Për përthithjen e propozimeve GVJ gjeti evidencë të sondazheve të kryera me alumni dhe me kompanitë e biznesit [Annex 4.1 Decision of the rectorate on the Alumni Survey; Annex 4 Company satisfaction survey].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet</p>	<p>Studentët përfshihen në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit. Kjo realizohet nëpërmjet marrjes së mendimit të tyre që realizohet nëpërmjet anketimeve të kryera [Annex 20.4 Student Satisfaction Survey]. Plani mësimor ka pësuar ndryshime të vazhdueshme</p>

<p>vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>që kanë ardhur si pasojë e kuadrit ligjor dhe nevojave që njësi bazë ka evedentuar bazuar në kërkesat e punëdhënësve dhe studentëve [Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation]. Studentët janë pjesë e dhënies së mendimit të tyre në lidhje me përmbajtjen e programit mësimor përmes anketimeve që institucioni zhvillon në fund të çdo semestri [Annex 20.4 Student Satisfaction Survey;]. Universiteti “Epoka” ka të ngritur edhe Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe të Diplomuarve e cila kryen sondazhe të vazhdueshme me studentët e diplomuar. Forma të anketimeve në google u përmendën në takimet e zhvilluara në institucion dhe shembuj u elaboruan në këtë drejtim [takime në institucion; Annex 4.2 Alumni survey questionnaire 2021-2022].</p> <p>Programi mësimor ka pësuar ndryshime edhe në lidhje me lëndët me zgjedhje duke rritur spektrin e marrjes së njohurive në fushën e inxhinierisë kompjuterike. Konkretisht për vitin akademik 2022-2023 janë shtuar lëndët me zgjedhje si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 21. Metodatat e avancuara numerike; 22. Menaxhimi i projekteve softuerike; 23. Dizajni i sistemit operativ; 24. Hyrje në inxhinierinë e rrjetit; 25. Bizneshi online dhe tregtia online; 26. Hyrje në kriptografi; 27. Tema të veçanta në inxhinieri softuerike; 28. Sistemet e shpërndara; 29. Programimi i aplikacioneve celulare; 30. Tema të veçanta në inteligjencë artificiale; 31. Menaxhimi i sistemeve të informacionit; 32. Projektimi i sistemeve të ngulitura 33. Përpunimi i sistemit multimedial; 34. Animacion multimedial dhe kompjuterik; 35. Auditimi i sigurisë dhe testimi i penetrimit; 36. Hartuesit; 37. Metodatat dhe algoritmet e optimizimit; 38. Shkenca e të dhënave; 39. Kriptografia e aplikuar; 40. Sistemet e avancuara të kontrollit; <p>dhe janë rigrupuar lëndët detyruese në përputhje edhe me zhvillimet e fundit ligjore. Në takimet me stafin akademik shembuj të shumta u sollën në lidhje me punën që ata kanë zhvilluar për futjen e lëndëve të reja tashmë shumë të kërkuara (psh drejt kuptimit dhe teknikave në inteligjencën artificiale etj) [Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation; Tabelat Përmbledhëse_MSc_CEN_shqip].</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike bashkëpunon me grupet e interesit për të garantuar cilësinë e programit të studimit. Konkretisht GVJ përmes evidencave konstaton:</p>

përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<ol style="list-style-type: none"> Partnership me universitetet të huaja në Evropë [Annex 22.1 List of partnership agreements]. Marrëveshje Bashkëpunimi të lidhur me universitete [Annex 40 Memorandums of Understanding ëith partner Universitë; Annex 22.2 Samples of signed active agreements]; Bashkëpunime në kuadër të programit Horizon 2020 dhe Horizon Europe në fushën e mjekësisë; <p>GVJ konstaton se njësia bazë merr feedback nga kompanitë, bizneset apo institucionet me të cilat ka marrëveshje nëpërmjet anketave që u kërkon të plotësohen. GVJ rekomandon që në këtë anketë të integrohen pyetje në lidhje me kurrikulën dhe njohurive të studentëve, për të pasur në këtë mënyrë një indikator të drejtpërdrejtë për këtë program studimi përpos edhe zhvillimit të konsultimeve direkte. [Annex 4: Company satisfaction survey]</p>								
Konkluzione	Programi i studimit Master i Shkencave ka pësuar përmirësime të vazhdueshme. Në drejtim të saj njësia bazë përthith mendimin e studentëve përmes anketimeve të kryera në mënyrë periodike, mendimin e grupeve të interesit dhe si pasojë e bashkëpunimeve që institucioni ka nënshkruar me universitete partneret dhe kompani biznesi.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Në strategjinë e zhvillimit të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike tek angazhimet përcaktohet [Annex 5.1 Department strategic plan, mission of the study program]: <ol style="list-style-type: none"> Fushat prioritare me tematika të caktuara; Qëllimet specifike për secilën fushë të cilat konsistojnë në rritjen e numrit të studentëve në programin e studimit, përmirësimin e mjedisit të mësimdhënies dhe infrastrukturës, mjeteteve didaktikeve, rritjen e aftësive kërkimore shkencore të stafit akademik, rritjen e pjesëmarrjes në projekte kërkimore shkencore dhe përfshirjen e studentëve në master në aktivitete; Plan veprimi dhe rezultatet e matshme për secilën fushë prioritare; <p>GVJ është i mendimit se këta elementë gjejnë pasqyrimin më të mirë të objektivave të programit të studimit me prioritetet e dhëna në strategjinë e zhvillimit të institucionit [Annex 5 Epoka university strategy].</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e	Nga takimet në institucion dhe shqyrtimi i DVV, GVJ u informua se Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike që është përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike"

<p>mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>koordinon gjithë veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore të personelit akademik dhe në bashkëpunim edhe me departamente të tjerë të institucionit bashkërendon organizimin e konferencave, publikimin e artikujve në revistën e institucionit si dhe revista të tjera, organizime të eventeve shkencore, takime me të ftuar nga fusha e industrisë dhe sipërmarrjes, duke respektuar liritë akademike dhe forcuar marrëdhënien me institucionet partnere. Dëshmi për këtë janë aktivitetet dhe botimet e shumta të Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë në të cilat ka kontribuar ose ka drejtuar Departamenti i Inxhinierise Kompjuterike [Annex 21.5 List of Publications 2018-2022].</p>										
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Nxitja dhe motivimi i studentëve të programit i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” për t’u angazhuar në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore gjen realizimin në punimet e diplomave të cilat kontribuojnë për inicimin e studentëve në kërkimin shkencor duke u bërë pjesë e punës kërkimore të personelit akademik. GVJ është i mendimit se rezultatet kërkimore të botuara dëshmojnë për një angazhim të konsiderueshëm të studentëve me mbështetjen e pedagogëve.</p> <table border="1" data-bbox="606 851 1420 1377"> <thead> <tr> <th>Aktiviteti Shkencor</th> <th>Numri i studentëve të aktivizuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Për punime individuale të pedagogëve</td> <td>80</td> </tr> <tr> <td>Për projekte shkencore në nivel departamenti</td> <td>40</td> </tr> <tr> <td>Për projekte shkencore në nivel fakulteti</td> <td>40</td> </tr> <tr> <td>Për punime shkencore në bashkëpunim me të tjerë</td> <td>30 Asistentët e Projektit të angazhuar në projektin PANBiora; 10 studentë të angazhuar në zbatimin e projektit VTECH; 10 studentë të angazhuar në zbatimin e projektit DIMTV;</td> </tr> </tbody> </table> <p>[Tabelat Përmbledhëse MSc CEN shqip];</p>	Aktiviteti Shkencor	Numri i studentëve të aktivizuar	Për punime individuale të pedagogëve	80	Për projekte shkencore në nivel departamenti	40	Për projekte shkencore në nivel fakulteti	40	Për punime shkencore në bashkëpunim me të tjerë	30 Asistentët e Projektit të angazhuar në projektin PANBiora; 10 studentë të angazhuar në zbatimin e projektit VTECH; 10 studentë të angazhuar në zbatimin e projektit DIMTV;
Aktiviteti Shkencor	Numri i studentëve të aktivizuar										
Për punime individuale të pedagogëve	80										
Për projekte shkencore në nivel departamenti	40										
Për projekte shkencore në nivel fakulteti	40										
Për punime shkencore në bashkëpunim me të tjerë	30 Asistentët e Projektit të angazhuar në projektin PANBiora; 10 studentë të angazhuar në zbatimin e projektit VTECH; 10 studentë të angazhuar në zbatimin e projektit DIMTV;										
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Për realizimin e aktiviteteve studimore njësia bazë mbështetet në të ardhurat e fituara nga grantet për kërkimin shkencor dhe mbështetjen financiare të universitetit.</p> <table border="1" data-bbox="606 1523 1420 1668"> <thead> <tr> <th>Te ardhura nga:</th> <th>2018-2019</th> <th>2019-2020</th> <th>2020-2021</th> <th>2021-2022</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Grantet mbi kërkimin shkencor dhe kontratat</td> <td>10,826.6 Euro</td> <td>16,245.78 Euro</td> <td>7,390.78 Euro</td> <td>1,618.45 Euro</td> </tr> </tbody> </table> <p>Universiteti “Epoka” ka hartuar edhe udhëzuesin “Mbi Promovimin e Publikimeve Shkencore” si një direktivë për të përcaktuar metodat dhe parimet mbi inkurajimin e stafit akademik për të realizuar publikime në revista shkencore dhe për të marrë pjesë në konferenca të nivelit të lartë [Annex 21.2 Directive On the Promotion of Scientific Publications].</p>	Te ardhura nga:	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022	Grantet mbi kërkimin shkencor dhe kontratat	10,826.6 Euro	16,245.78 Euro	7,390.78 Euro	1,618.45 Euro
Te ardhura nga:	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022							
Grantet mbi kërkimin shkencor dhe kontratat	10,826.6 Euro	16,245.78 Euro	7,390.78 Euro	1,618.45 Euro							

	<p>Në këtë drejtim ngrihet edhe Komisioni për Mbështetjen e Aktiviteteve Shkencore dhe Nxitjen ne Publikime i cili përbëhet nga shefi i njësisë bazë dhe dy anëtarë. Ky komision zgjidhet nga Rektori dhe ka një afat 1 – vjeçar. Çdo vit Rektorati vendos në lidhje me shumën për publikimet shkencore. Pas vleresimit të bërë nga Komisioni për mbështetjen e Aktiviteteve Shkencore dhe Nxitjen ne Publikime dhe miratimi nga Rektorati, shpërblimi jepet përmes shumëzimit të koeficionit të mbështetjes me pikët e dhëna në tabelën nr. 5 dokumenti “Annex 21.2”. Në rast se ka më shumë autorë shpërblimi ndahet sipas disa mënyrave në varësi edhe të bashkëpunimit midis autorëve;</p> <ol style="list-style-type: none"> Për dy autorë: autori i parë merr 60% ndërsa autori i dytë 40% të shpërblimit; Për tre autorë: autori i parë merr 50%, autori i dytë 30% dhe autori i tretë 20%; Për më shumë se tre autorë: autori i parë merr 40%, autori i dytë 30%, autori i tretë 20% dhe 10% ndahet midis autorëve të tjerë; <p>GVJ evidenton se Zyra e Kërkimeve dhe Projekteve në bashkëpunim me Zyren e Financës janë aktive në monitorimin e kërkimit shkencor dhe ofrimin e mbështetjes financiare. Vlera e financimit nga buxheti i Universitetit propozohet nga Rektorati dhe miratohet nga Bordi i Administrimit. Në takimet e zhvilluar nga institucioni stafi akademik solli shembuj të përfitimit të financimit në drejtim të pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe shpërblimet mbi artikujt e botuar. Universiteti mbështet kërkimin shkencor edhe në projekte. Udhëzimi për dorëzimin e propozimeve për kërkimin shkencor shërben për çdo anëtar të stafit akademik që shpreh interesin të marrë pjesë në thirrjet e zhvilluar nga universiteti në këtë drejtim.</p> <p><i>[Annex 21.3 Common Guidelines for Scientific Research Proposal Submission; Annex 21.1 Regulation On Scientific Research; Annex 21.2 Directive On the Promotion of Scientific Publications].</i></p>								
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se njësia bazë ka të vendosur objektivat prioritare. Njësia bazë koordinon punën në drejtim të rritjes së kërkimit shkencor. Institucioni bazuar edhe në fushat prioritare të shprehur në strategjinë e zhvillimit mbështet financiarisht arritjet e stafit akademik në drejtim të pjesëmarrjes së tij në konferenca dhe botime shkencore. Stafit akademik angazhon edhe studentët në punimet shkencore.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="603 1550 807 1630">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="807 1550 991 1630">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="991 1550 1206 1630">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1206 1550 1436 1630">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="603 1630 807 1664"></td> <td data-bbox="807 1630 991 1664"></td> <td data-bbox="991 1630 1206 1664"></td> <td data-bbox="1206 1630 1436 1664">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.

Universiteti “Epoka” i kushton një vëmendje të veçantë kërkimit shkencor. Plani strategjik i Zhvillimit në nivel institucional dhe strategjia e kërkimit shkencor në nivel departamenti janë tregues të punës që realizohet në këtë drejtim [Annex 5 Epoka university strategy; Annex 5.1 Department strategic plan, mission of the study program]. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike bashkëpunon ngushtë me Zyrën e Kërkimeve dhe Projekteve në lidhje me aplikimet për projekte shkencore. Thirrjet bëhen të njohur tek stafi akademik dhe publikohen në faqen zyrtare <https://projects.epoka.edu.al/home.html>. Siç është theksuar edhe në kriterin 3 të standartit II.5, GVJ konstaton bashkëpunime të shumtë me partnerë të huaj në kuadër të forcimit të mësimdhënies, mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve dhe kërkimit shkencor. Universiteti “Epoka” është pjesë e rrjetit Crowdhelix që cituar edhe në RVB është një platformë e Hapur Inovacioni dhe Rrjetëzimi që mundëson lidhje me shumë universitete partnere në kuadër të bashkëpunimit në projekte kërkimore shkencore.

Projekte/Konferenca shkencore	Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë
Numri i projekteve kërkimore të fituara në shkallë departamenti/fakulteti	<ul style="list-style-type: none"> • 4 projekte të financuara nga jashtë (PANBiora, K-FORCE, DIMTV, VTECH); • 7 Cost Action; • 2 Projekte të brendshme kërkimi;
Numri i projekteve të zbatuara në shkallë departamenti/fakulteti	<ul style="list-style-type: none"> • 4 projekte të financuara nga jashtë (PANBiora, K-FORCE, DIMTV, VTECH); • 3 Cost Action;
Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga departamenti/fakulteti dhe ILA për programin e studimit	3 <ul style="list-style-type: none"> • Presantimi i Kineton Albania për Zhvillimin e Sotfuerit në Industrinë e Automobilave; • Konferencë e GECD e organizuar nga Universiteti “Epoka” • Forumi Kombëtar për Inteligjencën Artificiale e organizuar nga Akademik e Shkencave e Shqiperisë;
Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet shkencore	10
Numri i çmimeve kombëtare të fituara në nivel IAL	3

	<i>[Tabelat Përmbledhëse_MSc_CEN_shqip; [Annex 21.4 List and brief description of the acquired and implemented reserach projects; Annex 21.5 List of Publications 2018-2022;].]</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Nga takimet në institucion dhe shqyrtimi i DVV, GVJ u informua se Departamenti i Inxhinierise Kompjuterike është i angazhuar në studime e projekte me karakter kërkimor shkencor duke përcaktuar objektiva të qartë kërkimore dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. Lista e projekteve në të cilat është i angazhuar institucioni ku marrin pjesë jo vetëm personeli akademik me statusin e punonjësit kërkimor, por edhe studentët e ciklit Master, dëshmon për një institucion dhe në veçanti për një program studimi me lidhje të ngushta me kërkimin shkencor <i>[Annex 21.4 List and brief description of the acquired and implemented reserach projects; Annex 21.5 List of Publications 2018-2022;].</i> Këto lidhje kontribojnë në zhvillimin e aftësive të kërkuesit dhe të përshtatjes me teknologjitë e reja. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike inkurajon marrjen e eksperiencës së stafit akademik përmes programeve Erasmus + dhe Cost Action. GVJ shqyrtoi me vëmendje evidencat dhe konstaton një mobilitet më të lartë të stafit akademik të huaj në departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike kundrejt outgoing <i>[Annex 10.3 List of students and staff mobility toëard and from study program].</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Objektivat kërkimorë të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike realizohen nëpërmjet një numri të konsiderueshëm konferencash e aktiviteteve të tjera në të cilat angazhohen në një masë të konsiderueshme dhe studentët. Këto aktivitete i shërbejnë edhe kualifikimit të personelit akademik të kategorisë Asistent Lektor (MSc) për të mundur avancimin e tyre në karrierë. Institucioni ka kapacitete për të organizuar konferenca në mjediset e tij. Vlen të përmenden në këtë drejtim: <ul style="list-style-type: none"> • Konferenca ICITAS (201) në bashkëpunim me Universitetin “Aleksander Moisiu” Durrës; • Konferenca CONTESA (2020) në bashkëpunim me IAER; • Konferenca CONTESA (2021) në bashkëpunim me IAER; <i>[Tabelat Përmbledhëse_MSc_CEN_shqip]</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	GVJ thekson se përmbajtja e programit të studimit i përgjigjet kërkesave të tregut të punës. Nga ana e njësisë bazë zhvillohet punë në lidhje me përmirësimin e përmbajtjes së programeve lëndore dhe të programit në tërësi. Të dhënat e punësimit në përfundim të studimeve janë tregues i rezultatit në lidhje me formimin profesional të studentëve <i>[Tabelat Përmbledhëse_MSc_CEN_shqip].</i>

<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Programi i studimit është në përputhje me të gjithë kërkesat ligjore në fuqi. Çdo student i diplomuar mund ti nënshtrohet të gjithë kriterëve për marrjen e licencës profesionale, por siç është theksuar edhe në raportin vjetor institucional nuk ka të dhëna në lidhje me numrin e studentëve që kanë përfituar pasi ministritë përkatëse nuk japin informacion në këtë drejtim [RVB, takime në institucion; Annex 27 Institutional Annual Report_2021_2022].</p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU).</p>	<p>Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian. Njësia bazë bashkëpunon me të gjithë partnerët dhe merr në konsideratë rekomandimet e tyre.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se universiteti "Epoka" i kushton një vëmendje të veçantë kërkimit shkencor. Departamenti i Inxhinierise Kompjuterike është i angazhuar në studime e projekte me karakter kërkimor shkencor. Objektivat kërkimorë të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike realizohen nëpërmjet një numri të konsiderueshëm konferencash. Programi i studimit është në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe garanton punësimin e tyre në përfundim të studimeve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Baza e realizimit të procesit mësimor në auditor është ora mësimore. Një orë mësimore e ka kohëzgjatjen 60 minuta. Ndër format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë leksionet, ushtrimet, seminarët, laboratorët, detyrat e kursit dhe praktika mësimore. GVJ konstatoi se format klasike të mësimdhënies ndërthuren me metoda të ndryshme bashkëkohore. Nga diskutimi me personelin akademik dhe studentët e programit, GVJ u informua për mënyrën e zhvillimit të lëndëve të ndryshme dhe në mënyrë të veçantë për peshën e elementëve formues të parashikuar në secilën lëndë. U konstatua se personeli akademik i kushton një rëndësi të veçantë realizimit të detyrave apo projekteve të kursit. Gjithashtu aplikohen forma të punës në grup për realizimin e një detyre apo projekti, duke zhvilluar në këtë mënyrë edhe elementë të tillë si menaxhimi i ndarjes së punës, integrimi pjesëve individuale në një të tërë, referimi i materialit përfundimtar nga grupi etj. [Ev. Takime në institucion; Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation. Annex 2.1 Syllabuses Part 1; Annex 2.1 Syllabuses Part 2.; Annex 2.1 Syllabuses Part 3.].</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Universiteti “Epoka” dhe Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ka në fokus të aktivitetit të tij ka cilësinë e mësimdhënies. Në këtë drejtim inkurajon dhe mbështet të gjithë format dhe metodat në mësimdhënie të cilat garantojnë aftësimin e studentit. Dokumenti bazë që rregullon dhe mbështet zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative në fushën e mësimdhënies është “Politika për Mësimdhënies, mësimnxënies dhe cilësinë në procesin mësimor [Annex 11 Policies for Learning, teaching and quality teaching]. Në punën e tij personeli akademik bazohet edhe në dokumenta mbështetëse ku vlen të përmenden:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullore institucionale [Annex 1.1 Basic Regulation]; 2. Rregullore për programet e nivelit të dytë të studimit [Annex 3 Regulation on second cycle study programs]; 3. Kurrikula e programit mësimor [Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation]; 4. Syllabuset [Annex 2.1 Syllabuses Part 1, 2 and 3]; 5. Udhëzimet në lidhje me ngarkesën në mësimdhënie [Annex 42 Directive On The Teaching Load]; 6. Rregullore e organizimit të provimeve [Annex 13.1 Guideline On Examinations]; 7. Rregullore për diplomimin [Annex 13 Regulation on graduate studies and examinations];

	<p>Për t'ju përgjigjur diversitetit dhe kërkesave të studentëve, personeli akademik mban kontakt të vazhdueshëm me ta si dhe në çdo lëndë mundësohet komunikimi me studentët jo vetëm gjatë realizimit të procesit mësimor në auditor, por edhe jashtë auditorit nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike (e-mail, etj). Në këtë mënyrë, GVJ konstatoi se personeli akademik ka qenë në vazhdimësi i disponueshëm për zhvillimin e konsultimeve për çështje specifike si dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve e shqetësimeve individuale të studentëve në lidhje me procesin mësimor [takim me stafin akademik, takim me studentët].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstatoi se për të mundësuar përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve, institucioni ka vepruar në disa drejtime:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Së pari, në përmirësimin e infrastrukturës së mësimdhënies, duke ofruar auditorë të paisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies [Annex 28 Information on infrastructure capacities in the function of study program]; - Së dyti, nëpërmjet modernizimit të bazës laboratorike dhe mbajtjes së saj në gatishmëri për zhvillimin e aspekteve praktike të procesit mësimor [vizite në institucion; ; Annex 8.2 Tabelat Përmbledhëse_MSc CEN_shqip]; - Së treti, nëpërmjet krijimit të oportuniteteve për stafin akademik nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit për të përsosur metodat e mësimdhënies [Annex 10.3 List of students and staff mobility toward and from study program]; - Së katërti, duke organizuar trajnime për aspekte të ndryshme që lidhen me inxhinierinë e softuerit [Annex 45 Example of Documents on Training Events; List of training activities organized at institutional level; Annex 8.1 Policy on participation of academic and assisiting academic staff in activities outside the university];
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe</p>	<p>Nga shqyrtimi CV të stafit akademik, GVJ konstatoi se fushat e kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhen me modulet/lëndët që mbulojnë [Annex 7 Academic and administrative staff application form; Annex 8 Staff guide; Annex 7.2 Full time staff Info form.]. Gjithashtu nga takimi i zhvilluar me studentët dhe nga rezultatet e pyetsorit të studentëve, rezultojnë se personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit [Ev. Takime në institucion].</p> <p>Nga takimet me studentët dhe personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi GVJ konstatoi se personeli akademik përdor metoda të ndryshme (që varen edhe nga specifika e lëndëve) për të rritur</p>



<p>ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>interesimin për orën e mësimit dhe për të rritur shkallën e përvehtësimit të informacionit të transmetuar. Shpjegimi i leksionit shoqërohet me prezantime poërpont si dhe me materiale të tjera ilustruese, ndërsa pjesët praktike shoqërohen me teknika inteligjente të pyetjeve, sesione interaktive të kombinuara me supervizim, metoda të ndryshme ndërvepruese, teknika virtuale mësimore, punë në grup e bazuar në raste studimore, detyra të bazuara në kërkim dhe hulumtim etj [Ev. Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi se metodat e mësimdhënies janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve si nga vetë personeli akademik për lëndët që mbulojnë ashtu edhe nga studentët (pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve të programit të studimit) si dhe nga drejtuesi i njësive bazë. Në mënyrë të veçantë përpunimi i të dhënave të pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve dhe për stafin akademik për çdo program studimi i cili plotësohet në fund të çdo semestri shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme [takim me stafin akademik; Annex 20.4 Student Satisfaction Survey; Annex 12.3 Course Instructor Evaluation Survey Form].</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Organi që punon për ofrimin e monitorimit horizontal dhe mbështetjes në promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm në mesimdhënie është Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, me njësite e tij si Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave, Bordi i Provimeve dhe Bordi i Vlerësimit të Performancës Akademike dhe Përmirësimit të Cilësisë. Ky sistem ofron kontrolle cilësore në mjedisin e mësimdhënies në universitete.</p> <p>Përsa i përket zhvillimit të metodave të reja inovative të mësimdhënies, Universiteti EPOKA ofron sesione dhe programe të shumta vjetore të trajnimit të cilat janë të detyrueshme si për stafin e ri mësimdhënës, ashtu edhe për atë ekzistues. Të gjitha njësitë duhet të paraqesin propozimet e tyre për ngjarjet vjetore dhe planet e veprimtarisë në Rektorat për shqyrtim dhe miratim përpara fillimit të çdo viti akademik.</p> <p>Njësitë që kryejnë trajnime të rregullta për zhvillimin profesional të stafit mësimdhënës janë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Burimeve Njerezore, Zyra e Kërkimeve dhe Projekteve, Fakultetet dhe Zyra Koordinuese e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (ICTCO). Këto aktivitete dhe programe janë përshtatur në mënyrë specifike për nevojat e stafit, komentet e studenteve në lidhje me aktivitetet e mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>[Annex 25 Annual Report on Quality Assurance Activities of the PCQA 2020-2021 and regulation On The Organization and Functioning of the PCQA]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ mendon se Universiteti "Epoka" ka hartuar udhëzues në lidhje me mësimdhënien, mësimnxënien dhe cilësinë në procesin mësimor. Stafi</p>

	<i>akademik i angazhuar në programin e studimit është më përvojë dhe eskperiençë. Programi i studimit përfshin studentët në dhënien e mendimit dhe vlerësimin të tyre në lidhje me punën e personelit akademik përmes anketimeve periodike që kryen njësisia e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Programi mësimor në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë është i hartuar bazuar në sistemin amerikan të arsimit të lartë, në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar në fushën e edukimit në arsimin e lartë dhe me Kartën e Bolonjës. Kriteret dhe pikët e vlerësimin jepen në dy forma (neni 45 në Rregulloren themelore të Institucionit).</p> <p>Kriteret dhe mënyra e vlerësimin shprehen qartë në dy dokumenta bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullore themelore [Annex 1.1 Basic Regulation]; 2. Rregullore për programet e ciklit të dytë [Annex 3 Regulation on second cycle study programs]; <p>GVJ konstaton se mungon një rregullore specifike për programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” dhe rekomandon njësinë bazë të hartojë një dokument të cilin e konsideron të rëndësishëm për mbarëvajtjen dhe funksionimin e procesit mësimor dhe vendosjen e kriterëve specifike për testimin, vlerësimin e njohurive dhe dijeve të studentëve që ndjekin këtë program.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstaton se në rregulloret e institucionit përcaktohet detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli/ lënde me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Referuar takimeve me stafin akademik si dhe me studentët, rezulton se procedura e informimit realizohet nga stafi akademik në fillim të lëndës. Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimin nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës apo të syllabusit përkatës [Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation; Annex 2.1 Syllabuses Part 1; Annex 2.1 Syllabuses Part 2; Annex 2.1 Syllabuses Part 3].</p> <p>Institucioni përdor edhe mekanizma të tjerë në drejtim të informimit të studentëve për programin mësimor. Përmendim këtu publikimi i programit mësimor, lëndët, stafin akademik në faqen e webit</p>

	[https://cen.epoka.edu.al/home-prof-l-master-in-computer-eng-1944-184.html].			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme (ne RVB citohen 11 forma te kombinuara midis tyre), të cilat për lëndë të ndryshme kanë elementë të përbashkët, por edhe specifika që lidhen me natyrën e lëndës dhe aktivitetet formuese përkatëse. Përgjithësisht, GVJ konstatoi se vlerësimi final përbëhet nga komponentët si vijon më poshte për vlerësimin e studentit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive: 0% • Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit): 30% • Testimet gjatë vitit: 20% • Provimi përfundimtar: 50% <p>[Tabelat Përmbledhëse_MSc CEN_shqip]</p> <p>GVJ konstaton se në Rregulloren Themelore dhe në Rregulloren për programin e ciklit të dytë të studimit mungojnë të dhënat në lidhje me format e vlerësimit të njohurive dhe format e kontrollit të vazhdueshëm dhe rekomandon përfshirjen e tyre.</p> <p>Format e vlerësimit të studentit janë të përcaktuar edhe në syllabuse dhe konstaton vlerësime të ndryshme në varesi të lëndës dhe mënyrës së saj të organizimit [Annex 2.1 Syllabuses Part 1; Annex 2.1 Syllabuses Part 2; Annex 2.1 Syllabuses Part 3].</p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se universiteti "Epoka" përmes rregullores themelore dhe rregullores së programit të ciklit të dytë nuk ka të përcaktuar kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale dhe rekomandon përfshirjen e tyre.</p> <p>Format e vlerësimit të studentit janë të përcaktuar edhe në syllabuse. Referuar takimeve me stafin akademik si dhe me studentët, rezulton se procedura e informimit realizohet nga stafi akademik konform rregulloreve në fuqi. Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës apo të syllabusit përkatës.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë	Kriteret dhe procedurat për testimin e njohurive të studentit janë përcaktuar në Rregulloren Themelore (kapitulli VII), në Rregulloren për Studimet e Ciklit të Dytë dhe në syllabuset e lëndëve [Annex 1.1 Basic

<p>vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p><i>Regulation; Annex 3 Regulation on second cycle study programs; Annex 2.1 Syllabuses Part 1; Annex 2.1 Syllabuses Part 2; Annex 2.1 Syllabuses Part 3].</i> GVJ përmes shqyrtimit të evidencave të paraqitura nga institucioni konstaton në përmbajtjen e tyre klauzola ligjore që përcaktojnë qartë format e testimit dhe mënyrën e organizimit të kontrollit dhe testimit të dijeve. Elementët bazë të procesit mësimor janë mësimdhënia dhe vlerësimi i dijeve. Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve, seminareve, ushtrimeve, punëve laboratorike, praktikës profesionale, detyra/projekte kursi. Elementët bazë të procesit mësimor janë të shprehur qartë në syllabusin e secilës lëndë të programit mësimor. Në vlerësimin e dijës stafi akademik mbështetet në përfundimet e kontrollit të vazhdueshëm, vlerësimin në detyra/projekte kursi dhe vlerësimin në provimin final. Rezultati i testimit të dijeve është një shumatore e vlerësimit të vazhdueshëm të bërë gjatë gjithë semestrit. <i>[Annex 1.1 Basic Regulation; Annex 3 Regulation on second cycle study programs; Annex 2.1 Syllabuses Part 1; Annex 2.1 Syllabuses Part 2; Annex 2.1 Syllabuses Part 3].</i> Elementët kryesorë të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet e pjesshme, punimet/projektet, provimi final etj. Universiteti “Epoka” ka hartuar edhe një rregullore për zhvillimin e provimeve duke garantuar korrektesinë në këtë proces <i>[Annex 13.1 Guideline On Examinations.]</i>. Vlerësimi bëhet mbi bazën e kriterëve të përcaktuar edhe në syllabus. GVJ evidenton se vlerësimi varion në lëndë në varësi të peshës së lëndës dhe mënyrës së organizimit të saj <i>[Annex 2.1 Syllabuses Part 1; Annex 2.1 Syllabuses Part 2; Annex 2.1 Syllabuses Part 3].</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive të studentëve në programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” bëhet vetëm me shkrim <i>[Annex 1.1 Basic Regulation; Annex 3 Regulation on second cycle study programs]</i>. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike zbaton udhëzimin e miratuar për ruajtjen e anonimatit në provim. Studentët marrin një kod të personalizuar dhe të dhënat në lidhje me rezultatet e provimit dhe pikët e grumbulluara për vlerësimin e vazhdueshëm gjatë semestrit jepen në sistemin EIS. Institucioni garanton të drejtat e studentit dhe shmang çdo formë abuzimi duke hartuar dhe zbatuar rregullore edhe për komisionet në provime <i>[Annex 13.5 Directive on the Functioning of the Exam Board]</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Mënyra dhe forma e përcaktimit të vlerësimit përfundimtar jepen qartë në Rregulloren Themelore dhe në Rregulloren e Programit të studimit të Ciklit të Dytë. GVJ konstaton vlerësimin në secilën lëndë përmes shqyrtimit të syllabuseve. Në shqyrtimin e tyre evidentojmë një kombinim të disa kriterëve në lidhje me vlerësimin e studentit. Format më të shumta të vlerësimit janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Homework; 2. Quiz;

	<p>3. Prezantim; 4. Projekt kursi; 5. Provim i pjesshëm; 6. Provimi final;</p> <table border="1" data-bbox="639 421 1430 645"> <thead> <tr> <th>Homework</th> <th>Quiz</th> <th>Presantim</th> <th>Projekt kursi</th> <th>Provim i pjesshëm</th> <th>Provim final</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>5%</td> <td>5%</td> <td>15%</td> <td>20%</td> <td>20%</td> <td>40%</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>30%</td> <td>25%</td> <td>50%</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>50%</td> <td></td> <td>90%</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>60%</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ ndërmorri një vizitë në sekretarinë mesimore. Përmes një verifikimi të notave të hedhur në regjister me rezultatet ne procesverbalet e dhëna nga stafi akademik konstaton se studentët janë vlerësuar korrekt dhe në përputhje me nenet e përcaktuar në Rregulloren Themelore dhe në Rregulloren për Studime në Ciklin e Dytë.</p>	Homework	Quiz	Presantim	Projekt kursi	Provim i pjesshëm	Provim final	5%	5%	15%	20%	20%	40%				30%	25%	50%				50%		90%				60%		
Homework	Quiz	Presantim	Projekt kursi	Provim i pjesshëm	Provim final																										
5%	5%	15%	20%	20%	40%																										
			30%	25%	50%																										
			50%		90%																										
			60%																												
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ zhvilloi një takim të veçantë me stafin akademik ku këta të fundit shprehën qartë mendimin e tyre në lidhje me ecurinë e studentëve. Stafi akademik ndjek në vazhdimësi progresin e studentëve. Në përfundim të provimit studentët njihen me zgjidhjet korrekte dhe bëjnë vlerësimin në lidhje me produktin e dhënë nga ana e tyre në provim. Në takimin e zhvilluar me studentët u theksua puna e bërë nga stafi akademik në lidhje me ndjekjen e progresit të studentëve. Sidomos në drejtim të aftësimi praktik të tyre [takim me stafin akademik, takim me studentët].</p>																														
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Universiteti “Epoka” i kushton vëmendje të veçantë mënyrës së vlerësimit të punimeve të studentëve, formave të kontrollit për të shmangur çdo abuzim apo plagjaturë. Rregullorja Themelore përcakton qartë masat disiplinore për çdo rast abuzimi, kopjimi apo shkelje nga ana e studentit. Institucioni ka hartuar një udhëzues të veçantë për organizimin e provimit dhe një Komsion/ Bord i Provimeve ngrihet në sezon provimi për të ndjekur ecurinë e këtij procesi [Annex 13.5 Directive on the Functioning of the Exam Board; Annex 13.1 Guideline On Examinations]. Një udhëzues i veçantë është hartuar për masat disiplinore dhe GVJ konstaton një zbatim të saj me korrektësi nga ana e institucionit [Annex 13.2 Regulation on student discipline]. Projektet e kursit, presantimet dhe përgatitja e temës së diplomës janë subjekte kontrolli për plagjaturë përmes softuerit Turnitin.</p>																														
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga diskutimet me lektorë dhe studentë të programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike”, GVJ konstatoi se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën, i korrespondojnë një vlerësimi të shtrirë përgjatë gjithë periudhës së zhvillimit të lëndës duke reflektuar gjithë komponentët e formimit [Ev. Takime në institucion].</p>																														



<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Universiteti "Epoka" përmes rregulloreve bazë përcakton qartë të drejtat e studentit për tu njohur me vlerësimin dhe të drejtën e tij për ankimimin. Neni 29 në Rregulloren e Studimit për Ciklin e Dytë përcakton qartë që brenda 5 ditëve nga data e marrjes së rezultatit të provimit, studenti ka të drejtë të bëjë kërkesë për rishikim në Sekretarinë Mësimore dhe brenda 15 ditëve nga shqyrtimi i saj nga pedagogu i lëndës dhe Dekanati të marrë përgjigje në lidhje me kërkesën e tij [Annex 3 Regulation on second cycle study programs].</p> <p>GVJ në takimin e zhvilluar me studentët konstaton njohje nga ana e tyre e procedurave për marrjen e vlerësimit brenda afatave kohore dhe të drejtën për ankimin, por shembuj nga eksperiencia e tyre në këtë drejtim nuk u elaboruan. [takim me studentët].</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ evidenton se programi i studimit ka të përcaktuar format e testimit dhe vlerësimit të dijeve të studentit. Elementët bazë të procesit mësimor janë mësimdhënia dhe vlerësimi i dijeve. Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve, seminareve, ushtrimeve, punëve laboratorike, praktikës profesionale, detyra/projekte kursi. Elementët bazë të procesit mësimor janë të shprehur qartë në syllabusin e secilës lëndë të programit mësimor. Syllabuset përcaktojnë qartë kriteret e vlerësimit dhe peshën përkatëse. Studentët janë të mireinformuar në lidhje me të drejtat e tyre për ankimim.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>GVJ është i mendimit se mënyra e zhvillimit të programit të studimit (me integrimin e detyrave e laboratorëve) dhe njohuritë e përfuara krijojnë mundësi për zhvillimin e aftësive të veçanta të studentëve në fushën e aplikimeve të teknologjisë kompjuterike. Përmirësimi i vazhdueshëm i programit të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës garanton edhe aftësimin më të thelluar të studentëve në njohuri</p>



	dhe praktikë [Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation; Annex 2.1 Syllabuses Part 1, 2 dhe 3].
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike", për vetë natyrën e tij, garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë kompjuterike. Zhvillimi i programit në gjuhën angleze jep një ndihmesë të konsiderueshme në shfrytëzimin masiv të literaturës në gjuhë të huaj si dhe lehtëson oportunitetet e mobiliteteve për studentët në institucione homologe të arsimit të lartë jashtë vendit. Referuar programit aktual, në të mungojnë lëndë të shkencave sociale, humane apo të komunikimit, megjithatë, në program, është integruar një lëndë në kategorinë "A" përkatësisht "Metodat e Kërkimit" ku studentët mësojnë teknika në lidhje me kërkimin shkencor, përpunimin e të dhënave dhe analizmin e tyre [Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation; Annex 2.1 Syllabuses Part 1, 2 dhe 3].
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve nga vetë pedagogët për lëndët që mbulojnë, nga studentët (nëpërmjet pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies) si dhe nga Përgjegjësi i Departamentit. Referuar RVB, Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike organizon takime me stafin e angazhuar në programin e studimit në të cilat diskutohen çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit, literaturës, aspekte teknike të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së organizimit të orës së mësimin, kërkimin shkencor dhe angazhimin e studentëve në projekte detyra kursi për të përthithur sa më mirë aftësitë dhe kompetencat që duhet të marrin nga secila lëndë. Raportet vjetore që hartohen reflektojnë edhe këto komente dhe hartohen edhe plan veprimi në lidhje me përmirësimin e tyre [Annex 12.5 Fall Semester Attachment Additional points to be added to Dept Reports; Annex 12.6 Fall Semester Corrective and-or preventive actions in response to identified issues for the study program; Annex 20.5 DoS Annual Report 2021-2022].
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative,	Mësimdhënia bazohet në format e përcaktuara në syllabus. Në metodologjinë e të nxënit konsiderohen leksionet, seminarët, konsultimet, puna në grup dhe individuale. Në zhvillimin e kompetencave të studentit organizohen edhe orë të hapura. Në javën e fundit të programit zhvillohen edhe një përsëritje e njohurive dhe koncepteve themelore e cila orienton studentët në drejtim të strukturës së provimit përfundimtar [takime në institucion].

studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.									
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Bazuar edhe në zhvillimet teknologjike janë organizuar edhe orë të hapura. Në kuadër të programeve Erasmus+ janë organizuar edhe leksione me pedagogë të huaj ku GVJ rithekson që numri i tyre në nivel mobiliteti është më i lartë në krahasim me stafin akademik outgoing [Annex 10.4 List of Lectures and seminars with foreign lecturers; Annex 27 Institutional Annual Report 2021_2022; Annex 10.3 List of students and staff mobility toward and from study program].								
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike angazhon studentët të jenë pjesë e grupit të punës së stafit akademik në projekte dhe botime shkencore. Temat e diplomave janë me interes të vecantë dhe një pjesë e tyre janë paraqitur edhe në konferenca studentore [takime në institucion].								
Konkluzione	GVJ evidenton se programi i studimit i përgjigjet pritshmërisë së studentëve në drejtim të aftësimin praktik të studentëve dhe punësimin e tyre në përfundim të studimeve. Njesia bazë ka dëshmuar evidence të përfshirjes së punimeve të studentëve në konferenca studentore dhe të jenë pjesë e grupeve të punës së stafit akademik në botime shkencore.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike" ofron në semetrin e dytë të vitit të dytë edhe tezën e diplomës e përcaktuar të jetë 18 ECTS [Tabelat Përmbledhëse MSc CEN_shqip; Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation]. Universiteti "Epoka" ka të specifikuar detyrimet që studenti duhet të përmbushë përpara zgjedhjes së temës së diplomës. Në rregulloren e Studimeve për Ciklin e Dytë neni 33 "Temat e Diplomës për Programet e Studimit në Master Shkencor" përcaktojnë që studenti duhet të këtë përmbushur suksesshëm të gjithë lëndët e ciklit të dytë të studimeve me përjashtim të praktikës profesionale për të zgjedhur temën e diplomës [Annex 3 Regulation on second cycle study programs]. Studenti do të mbrojë temën e diplomës nëse në mënyrë të

	<p>suksesshme ka kaluar edhe praktikën profesionale. Kriteret e diplomimit i bëhen të ditur studentëve nga departamenti i inxhinierisë Kompjuterike dhe publikohen edhe online. Në mbështetje të procedurës në lidhje me përgatitjen e temës së diplomës është edhe këshilltari i klasës i cili mban një komunikim të vazhdueshëm me studentët, informon dhe ofron asistencë në punën e tyre përgatitore.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ka vënë në dispozicion Këshilltarin e Klasës i cili është përgjegjës për informimin e studentëve, ofrimin e asistencën në lidhje me punën për temën e diplomës. Neni 35 në Rregulloren për Programe e Studimit të Ciklit të Dytë procedurën në lidhje me përgatjen e temës së diplomës. Në takimet e zhvilluar në Institucion GVJ konstaton se zbatimi i saj është në përputhje me procedurat ligjore të dhënë në rregullore. Konkretisht Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike propozon jo më vonë se semestri i tretë në Dekanantin e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë listën e supervisorëve për çdo student që përgatitet të fillojë temën e diplomës. Supervisorin dhe temën përkatëse të diplomës miratohen përmes vendimit të marrë nga Dekanati i Njësisë Kryesore. Supervisorin e temës së diplomës është stafi akademik i cili zotëron gradën shkencore Dr. Studenti regjistrohet për temën e diplomës në fillim të semestrit të katërt. Në lidhje me përgatitjen e temës së diplomës stafi akademik është në dispozicion të vazhdueshëm. Në funksion të përgatitjes së saj Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike vë në dispozicion të studentëve të gjithë bazën laboratorike dhe asistent- laborantët. GVJ konstaton në vizitat e kryera në institucion disponibilitetin e stafit ndihmës në këtë drejtim. Për përgatjen e temës së diplomës janë hartuar edhe udhëzues të vecantë të cilat japin instruksione në lidhje me mënyrën e shkrimit akademik të temës dhe trajtimin dhe analizimin e saj [takim me stafin akademik; takim me studentët].</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Jo e aplikueshme</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit</p>	<p>Stafi akademik i ka të përcaktuar qartë përgjegjësitë në lidhje me ofrimin e asistencës tek studenti gjatë përgatitjes së këtij të fundit në Projektin Final. Rregulloret kanë klauzola ligjore të veçanta në këtë drejtim. Roli i supervisorit të përcaktuar edhe nga departamenti konsiston në:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Inkurajimin e studentëve në shqyrtimin e literaturës së përshtatshme gjatë hulumtimit të kuadrit teorik; b. Përcaktimin e metodologjisë përkatëse;

<p>përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo njëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p><i>c. Përcaktimin e burimeve bibliografike, intervistave etj.</i></p> <p>Ofrimin dhe mbështetjen në drejtimin dhe udhëzimin gjatë gjithë procesit. Supervizori i temës së diplomës udhëzon në mënyrë të veçantë studentin gjatë kohës së përgatitjes së temës së diplomës. Në takimet e zhvilluar me stafin akademik u theksua puna e veçantë në këtë drejtim. Gjatë përgatitjes së temës së diplomës studenti është në kontakt javor me supervizorin e temës së diplomës. Puna e studentit në këtë drejtim është përcaktuar të jetë 450 orë e dhënë në planin mësimor si punën e panvarur [Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation]. Tema e diplomes zgjidhet në përputhje me rezultatet e studentit gjatë vitit, në përputhje me profilin me të cilin ai synon të zhvillohet më tej dhe në akordancë edhe me kërkesat e tregut të punës. Stafit akademik i ofron ndihmë në literature dhe në punën praktike të studentit për përgatitjen e temës së diplomës. Stafit monitoron matjet/punën laboratorike, ofron asistencë në analizimin e të dhënave dhe në konkluzionet në përfundim të temës së diplomës. Për përgatitjen e temës së diplomës janë hartuar edhe udhëzues të vecantë të cilat japin instruksione në lidhje me mënyrën e shkrimit akademik të temës dhe trajtimin dhe analizimin e saj [takim me stafin akademik; takim me studentët].</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se egzistojnë të gjitha mundësitë për të shfrytëzuar bazën laboratorike në institucion për përgatitjen e temës së diplomës nën drejtimin e udhëheqësit. Gjithashtu, në kuadrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, mund të ofrohen mundësi për të kryer matje apo teste edhe në biznese apo institucione që mbulojnë problematikën që lidhet me temën e diplomës ose ku studentët kryejnë edhe praktikatat profesionale [takime në institucion]</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Mbrojtja e temës së diplomës është dhënë qartë në nenin 36 të Rregullores së Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë. Komisioni i posaçëm për mbrojtjen e temës së diplomës zgjidhet me vendim të veçantë nga Dekanati i Fakultetit të Arkitekturës & Inxhinierisë bazuar në propozimin e dhënë nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike. Komisioni përbëhet jo më pak se nga tre anëtare ku një prej të cilëve është edhe supervizori i temës së diplomës. Mbrojtja e temës së diplomës është jo më pak se 45 minuta nga studentit dhe jo më gjatë se 90 minuta dhe mbrohet përpara komisionit i cili bën edhe vlerësimet në lidhje me mënyrën e presantimit, përmbajtjen e temës dhe trajtimin dhe rezultatet e saj. Komisioni jep rezultatet tek studentët dhe në Dekanat të Fakultetit jo më vonë se tre ditë nga data e organizimit të mbrojtjes së temave të diplomës [Annex 47 Thesis Examination Report (during defense) Master Students].</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e</p>	<p>Studentët e këtij programi studimi pajisen me diplomën përkatëse që i korrespondon formës së regjistrimit të diplomës e realizuar [Annex 14 Diploma format and Diploma supplement]. Suplementi i diplomës është</p>

diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	në përputhje me formatin e miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, e shoqëruar me numrin serial përkatës dhe i hartuar në gjuhë shqipe dhe anglisht. Menjëherë pas përfundimit dhe dhënies së rezultateve në akordancë me afatet kohore të dhëna në rregullore studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e saj nga Sekretaria Mësimore [vizite në sekretarinë mësimore].			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Referuar DVV, rezultati i provimit ose mbrojtjes së diplomës ruhet në Sekretarinë Mësimore [vizite në sekretarinë mësimore]. Gjithashtu, në Sekretaritë mësimore mbahet rregjistri bazë i studentëve me të dhënat e tyre personale si dhe vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit [Pjesë nga regjistri themeltar i studentëve]. Krahas versionit të shkruar (letër), për menaxhimin e përditshëm mbahet edhe versioni elektronik i informacionit. [Ev. RVB, Takim në Sekretarinë Mësimore].			
Konkluzione	GVJ evidenton se programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike" përmban në semestrin e dytë të vitit të dytë mbrojtjen e temës së diplomës. Bazuar në evidencat e paraqitura GVJ konstaton se kjo procedurë zhvillohet nga ana e njësisë bazë në përputhje me klauzolat ligjore të shprehur në Rregulloren për Programet e Ciklit të Dytë. Stafit akademik mbështet studentit gjatë përgatitjes së tij. Tema e diplomës vlerësohet nga një komision i ngritur me tre anëtarë nga njësi bazë. Në përfundim të tij studentit pajiset me diplomën dhe suplementin saj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në "Master i Shkencave" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ofron një bazë laboratorie të pasur me mjete didaktike për të garantuar zhvillimin e punëve laboratorike. Praktika laboratorike zhvillohen në mjediset e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike ndërsa praktika profesionale e përcaktuar në planin mësimor të jetë 12 ECTS zhvillohet në kompani me të cilat njësi bazë ka nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi [Annex 28 Information on infrastructure capacities in the function of study program; Annex 29 Capacity Verification Report 2022-2023].
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave	Universiteti "Epoka" ka nënshkruar një sërë marrëveshje bashkëpunimi me kompani të biznesit në lidhje me zhvillimin e praktikave profesionale [Annex 22.1 List of partnership agreements; Annex 40

<p>klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p><i>Memorandums of Understanding with partner Universities</i>]. Praktika profesionale është një komponent i rëndësishëm në programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike". Në drejtim të zhvillimit të saj Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike bashkëpunon me Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe të diplomuarve e cila është përgjegjëse për informimin e studentëve në drejtim të organizimit të praktikës profesionale dhe në drejtim të thirrjeve për punësim të studentëve. Vizita në institucion, takime me stafin akademik dhe studentët konfirmon përfitimin dhe aftësimin më të thelluar të studentëve përmes realizimit të praktikës profesionale.</p>			
<p>Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Praktika profesionale ekuivalentohet në këtë program studimi me 12 ECTS dhe në planin mësimor është llogaritur me 240 orë në auditor dhe 60 orë punë e panvarur. Praktika profesionale zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë dhe plotësimi i saj në mënyrë të suksesshme është kusht që studenti të mbrojë para komisionit të posaçëm temën e diplomës. Praktika zhvillohet nga studenti në ambjentet e një institucioni privat apo shtetëror bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruar me Universitetin "Epoka". Për realizimin e saj studenti monitorohet nga stafi akademik i përcaktuar nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike dhe në përfundim të tij hartohet edhe një raport që i paraqitet departamentit për vlerësim <i>[takime në institucion]</i>. Informacioni në lidhje me zhvillimin e praktikës profesionale u morr gjatë vizita në institucion dhe takimeve që GVJ pati me stafin akademik dhe studentët.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se programi i studimit në përmbajtjen e tij ka edhe praktikën profesionale e cila zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë. Institucioni zotëron kapacitetet e duhura për të mundësuar zhvillimin e praktikës lëndore në laboratorë të pajisur me të gjithë mjetet didaktike të duhura. Praktika profesionale zhvillohet në ambjentet e një kompani biznesi. Njesia bazë monitoron zhvillimin e praktikës së studentit. Në aspektin ligjor.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X



IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1																																																																																								
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.																																																																																								
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																																																							
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dhënë në dokumentacion, si edhe intervistat e zhvilluara me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi mund të konkludojmë se stafi i angazhuar në mësimdhënie është plotësisht i kualifikuar nga ana e gradave shkencore (minimalisht anëtarët përmbajnë gradën Doktor). Fusha e kualifikimit është në përputhje të plotë me angazhimin e secilit anëtar me mbulimin e lëndëve dhe specikat e tyre. Sipas përcaktimeve ligjore, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës, kriter i cili plotësohet nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi. Referuar tabelës përmbledhëse, GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është personel akademik kryesisht me kohë të plotë dhe përmbush kërkesat ligjore në fuqi përse i përket kualifikimit. Sipas të dhënave tabelare të paraqitura nga ana e institucionit stafi akademik me kohe te plote mbulon me shume se 70% te ngarkeses mesimore per kete program studimi, në përputhje me kriteret e percaktuara ne Ligjin 80/2015 "Per Arsimin e Larte dhe Kerkimin Shkencor ne Institucionet e Arsimit te Larte ne Republiken e Shqiperise" [Tabelat Përmbledhëse_MSc_CEN_shqip; Annex 2.2 Cv 2018-2019; Annex 2.2 CV 2020-2021; Annex 2.2 CV 2021-2022.; Annex 2.2 CV 2022-2023]</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; text-align: center;"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">2018-2019</th> <th colspan="2">2019-2020</th> <th colspan="2">2020-2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>3</td> <td>2</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>6</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>6</td> <td>2</td> <td>7</td> <td>1</td> <td>7</td> <td>2</td> </tr> </tbody> </table> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; text-align: center;"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2022-2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>5</td> <td>2</td> <td>3</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>6</td> <td>2</td> <td>5</td> <td>3</td> </tr> </tbody> </table>						Tituj/grada	2018-2019		2019-2020		2020-2021		PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:	Prof.Dr	1	-	1	1	-	2	Prof.As.Dr	2	-	2	-	1	-	Dr/PhD	3	2	4	-	6	-	Msc	-	-	-	-	-	-	Në total	6	2	7	1	7	2	Tituj/grada	2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE:	PAK:	Prof.Dr	1	-	1	-	Prof.As.Dr	-	-	1	-	Dr/PhD	5	2	3	3	Msc	-	-	-	-	Në total	6	2	5	3
Tituj/grada	2018-2019		2019-2020		2020-2021																																																																																			
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:																																																																																		
Prof.Dr	1	-	1	1	-	2																																																																																		
Prof.As.Dr	2	-	2	-	1	-																																																																																		
Dr/PhD	3	2	4	-	6	-																																																																																		
Msc	-	-	-	-	-	-																																																																																		
Në total	6	2	7	1	7	2																																																																																		
Tituj/grada	2021-2022		2022-2023																																																																																					
	PAE	PAK	PAE:	PAK:																																																																																				
Prof.Dr	1	-	1	-																																																																																				
Prof.As.Dr	-	-	1	-																																																																																				
Dr/PhD	5	2	3	3																																																																																				
Msc	-	-	-	-																																																																																				
Në total	6	2	5	3																																																																																				
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë</p>	<p>Referuar raportit të vlerësimit të brendshëm, si edhe informacionit nga tabelat përmbledhëse, ngarkesa mësimore e personelit për disa lektorë</p>																																																																																							

<p>ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>të angazhuar në këtë program studimi është më e lartë se maksimumi i normës mësimore të lejuar vjetore sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë". Pavarësisht mënyrës së brendshme të organizmit të ngarkesës mësimore të përshkruar në Shtojcën nr.42 "Mbi ngarkesën mësimore" të Universitetit EPOKA, rekomandojmë se kjo e fundit duhet të përshatet me kornizën ligjore në fuqi në këtë direktivë, si edhe duhet pasqyruar në mënyrë më të qartë sesi angazhohet personeli akademik në detyra administrative [Tabelat Përmbledhëse_MSc_CEN_shqip; Annex 42 Directive On The Teaching Load.]</p> <p>GVJ rekomandon se ZBNj dhe institucioni duhet të hartojë një rregullore ku të përcaktojë qartë sesi vlerësohet ngarkesa mësimore e stafit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe angazhimi i stafit akademik në punë administrative duke llogaritur këtu edhe angazhimin mësimor në programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Qëndrueshmëria e personelit akademik garantohej përmes kontratës individuale të punës që nënshkruhet me secilin prej tyre, siç është përcaktuar në Shtojcën Nr. 38 "Të Gjitha Llojet e Kontratave". Kontratat hartohen në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe përfshijnë të gjitha elementet e nevojshëm për të siguruar dhe demonstruar vullnetin e universitetit për qëndrueshmërinë e stafit akademik, duke përfshirë kontributet shoqërore dhe shëndetësore si janë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësinë të shihte dosjet fizike të personelit të angazhuar dhe ishin korrekte me dokumentacion të plotë.</p> <p>[Annex 38 Epoka Staff Employment Contracts; vizite në Zyrën e Burimeve Njerëzore]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedurën e rekrutimit dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Rekrutimi i stafit bazohet në Rregulloren "Për rekrutimin e stafit" dhe më pas procesi ndiqet nga Zyra e Burimeve Njerëzore [Annex 7.1 Regulation on Staff recruitment]. Kërkesa për rekrutim të stafit akademik buron nga njësia bazë [takim në institucion]. Bazuar në procedurën zbatuese, ZBNJ bën një njoftim për pozicionin vakant në faqen zyrtare të internetit: http://br.epoka.edu.al/cat-job-opportunities-1465.html, ne agjencitë vendore të punësimit si duapune.com, dhe/ose në agjencitë ndërkombëtare të rekrutimit të punës (https://www.akadeus.com/; https://www.jobs.ac.uk/), duke përfshirë kriteret e parashikuara në Rregulloren "Për Rekrutimin e Stafit". Kandidatët ftohen të dorëzojnë online pranë ZBNJ (recruitment@epoka.edu.al) "Formularin e Aplikimit për Staf Akademik në Universitetin EPOKA" dhe një dosje që përmban CV-në, kopje të diplomave të arritura dhe certifikatave si dhe punën e tyre shkencore sipas indeksit të klasifikimit</p>

	<p>të përcaktuar në Nenin 11, paragrafi 5 i Rregullores [Annex 7.1 Regulation on Staff recruitment; Annex 7 Academic and administrative staff application form; Annex 7.2 Full time staff Info form].</p> <p>Pas verifikimit të dokumentacionit Komisioni Shkencor i Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike vazhdon më tej procesin me intervistat e kandidatëve me dokumentacion të saktë, si edhe me një leksion të hapur që mbahet nga ana e kandidatëve potencialë. Bazuar në vlerësimin e Komisionit Shkencor, që realizohet nëpërmjet "Formularit të Rekrutimit të Stafit Akademik të Universitetit EPOKA" [Annex 7.1] Komisioni paraqet vlerësimin e tij në Rektorat përmes Dekanit. Bazuar në propozimin e Rektoratit, Bordi Administrativ miraton rekrutimin ose emërimin e kandidatit fitues në pozicionin vakant të punës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë/Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike garantojnë angazhimin e një personeli ndihmës akademik në mbështetje të programit mësimor. Kryesisht personeli ndihmës akademik është i përfshirë në laboratorë, në dhënien e asistencës së personelit akademik gjatë procesit mësimor dhe mbikqyrjen e studentëve gjatë orëve laboratorike. GVJ gjatë vizitës në institucion u njoh me laboratorët dhe stafin e përfshirë dhe vëren një gadishmëri nga ana e tyre në ndihmë të studentëve. Në drejtim të mirëmbajtjes së pajisjeve laboratorike Institucioni ka të ngritur edhe zyrën e IT-së ku gjatë vizitës konstatuam një angazhim edhe të studentëve [vizitë në institucion].</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>ZBNj përdor "Formularin e Informacionit për Stafin" i cili plotësohet nga stafi me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme. Ky formular ndjek udhëzimet e Komisionerit Publik "Për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale". Ky është një proces që ndodh çdo fillim viti akademik. Elektronikisht të dhënat ruhen në sistemin interaktiv (EIS), sistemi i brendshëm i Universitetit EPOKA [Annex 7.2 Full time staff Info form].</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe</p>	<p>GVJ konstaton se Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe të Diplomuarve (Alumni) punon me kompanitë që ka lidhur marrëveshje për të ndihmuar studentët. Ata mund t'i ndihmojnë studentët të kuptojnë se çfarë u pëlqen, të mësojnë rreth opsioneve të punës, të marrin përvojë në botën reale dhe të përgatiten për jetën pas shkollës. Zyra Alumni gjithashtu ndihmon në lidhjen e studentëve me kompani ose organizata që mund t'u japin atyre trajnime për punë. Në këto kompani, studentët kanë mentorë që nuk janë mësues për t'i ndihmuar ata.</p>

mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<i>[Annex 22.1 Cooperation Policy and partnership agreements]</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Praktika profesionale është një komponent i rëndësishëm në pogramin e studimit Mastër i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike”. Praktika profesionale është e vlerësuar me 18ECTS dhe ka një ngarkesë 240 orë në auditor dhe 60 orë jashtë saj. Në lidhje me organizimin e praktikës profesionale Institucioni ka organizuar edhe udhëzimin “Për organizimin e praktikës profesionale”. Bazuar në këtë dokument neni 3.1 përcakton mentorimin e studentit nga ana e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike përmes caktimit të një supervizori (personel akademik) dhe Supervizorit në vendin e zhvillimit të praktikës për ti ndjekur dhe asistuar përgjatë periudhe kohore të zhvillimit të saj. Në fund të praktikës profesionale studentët përgatisin një relacion, nëpërmjet të cilit vlerësohen edhe me notën përkatëse <i>[Annex 19.2 professional-practice-approval-form-pm; Annex 19.3 professional-practice-notebook-pm]</i> . Duhet theksuar se një pjesë e studentëve janë të punësuar ndërkohë që ndjekin studimet dhe zgjedhin që detyrimet e praktikës profesionale ti kryejnë pranë kompanive/bizneseve ku janë punësuar.			
Konkluzione	<i>GVJ përveç shqyrtimit të dokumentacionit, gjatë vizitës dhe intervistave konstatoi se institucioni realizon nje proces korrekt te rekrutimit të personelit akademik, mban një dokumentacion fizik sipas dispozitave ligjore në fuqi për cdo anëtar të personelit akademik të angazhuar ne program. Informacioni profesional për stafin përditesohet cdo fillim viti si në format fizik ashtu edhe elektronikisht. Ndërkohë duhet thënë se ngarkesa mësimore e personelit akademik të angazhuar në program, nuk përputhet me kuadrin ligjor në fuqi, ku konstatojmë se ngarkesa mësimore për një pjesë të personelit është më e lartë. ZBNj dhe institucioni duhet të hartojë një rregullore ku të përcaktojnë qartë sesi vlerësohet ngarkesa mësimore e stafit në përputhje me legjisllacionin në fuqi dhe angazhimi i stafit akademik në punë administrative duke llogaritur këtu edhe angazhimin mësimor në programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë ofron hapësira të ndryshme për aktivitete mësimore. Kjo përfshin shtatë klasa të mëdha, një dhomë për leksione, nëntë klasa më të vogla për punë në grup dhe nëntë laboratorë për mësim praktik. <i>[Annex 28 Information on infrastructure capacities in the function of study program; Tabelat Përmbledhëse_MSc_CEN_shqip]</i>.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se cdo klasë është e pajisur me një kompjuter dhe projektor për të lehtësuar mësimin teorik. Të gjitha laboratorët janë të pajisur me të gjitha mjetet dhe infrastrukturën e nevojshme për studentët që të kenë qasje për aktivitetet e tyre akademike. Nëse një pedagog ka nevojë për komponentë shtesë për lëndët që ai/ajo mëson, ai/ajo plotëson një formular kërkesë blerjeje dhe e dorezon formularin tek Administratori i Universitetit EPOKA <i>[Annex 28 Information on infrastructure capacities in the function of study program]</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ konkludon se laboratorët kompjuterikë kanë shumë programe speciale për programin e studimit në fjalë. Disa nga programet janë SAP 2000, ETABS, .Net, Visual Studio C++, Matlab, GNS3, Multisim 11, VMware Workstation, MySQL Workbench, Eclipse, Python, Rhinoceros 4, SR8 + -MAX, SPSS, EVIeës, etj. Zyra e Koordinimit të Teknologjisë së Informacionit përditëson programet në laboratorë bazuar në atë që pedagogët kanë nevojë për klasat e tyre. <i>[Tabelat Përmbledhëse_MSc_CEN_shqip]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ konkludon se Laboratorët e kompjuterave në Institucion kanë 128 kompjuterë dhe katër dhoma të ndryshme me të gjitha mjetet që studentet kanë nevojë për të mësuar. Ekziston edhe një bibliotekë për t'u përdorur nga studentët. Kompjuterët kanë programe specifike në to. Ka edhe laboratorë të tjerë, si ai elektronik, me pajisje speciale për t'i përdorur studentët. Institucioni është partner ne disa projekte që u japin atyre edhe më shumë pajisje për t'u përdorur nga nxënësit. Laboratorët kanë akses në internet dhe tabela speciale për mësim. Klasat kanë gjithashtu një mënyrë të veçantë të të mësuarit ku studentët mund të zgjedhin të vijnë personalisht në klasë ose të mësojnë nga shtëpia. <i>[Annex 37 ICTC Office Services]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti EPOKA ka shumë hapësira të dedikuara për mësim, si klasa, laboratorë dhe biblioteka. Këto vende kanë pajisje teknologjike si kompjuterë, projektorë dhe sisteme ngrohjeje dhe ftohjeje. Ekziston një zyrë e quajtur ZKTIK që kujdeset për</p>

<p>nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>mirëmbajtjen dhe sigurohet që të funksionojë mirë të gjitha pajisjet. Ata gjithashtu vendosin rregulla ligjore për përdorimin teknologjisë nga studentët dhe stafi.</p> <p><i>[Annex 28 Information on infrastructure capacities in the function of study program; Annex 29 Capacity Verification Report 2022-2023; Tabelat Përmbledhëse_MSc CEN_shqip; Annex 39 Summary Tables MSc.; Annex 37 ICTC Office Services]</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ ka vizituar të gjithë ambientet ku përfshihen auditorë ku zhvillohen leksione, laboratorët për zhvillim të semianreve dhe orëve laboratorike të pajisura me infrastrukturën e përshtatshme për procesin mësimor, projekte të studentëve dhe temat e diplomave. Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe vitiza e realizuar konkludojmë se ky standart përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Program i studimit ofrohet në gjuhën angleze, ndaj dhe literatura e ofruar bazë dhe ndihmëse është po në këtë gjuhë. Kjo konfirmohet nga syllabuset, por edhe intervista e zhvilluar me personelin akademik të këtij program studimi. Literatura i vihet në dispozicion studentëve në format elektronik nga pedagogu i lëndës. Në formatin fizik studentëve i vjen në ndihmë edhe biblioteka. Biblioteka e universitetit ofron një koleksion të gjerë të teksteve themelore dhe literature shtesë në gjuhë të ndryshme, duke përfshirë shqipen, anglishten, turqishten dhe gjuhë të tjera, për secilin program studimi të ofruar nga universiteti. Literatura është bashkëkohore dhe reflekton silabusin përkatës të secilës lëndë. Koleksioni i bibliotekës pasurohet me blerje dhe dhurime nga persona të ndryshëm fizike dhe juridike. Biblioteka ka periodika dhe dyqane elektronike të librave ose revista shkencore të nevojshme për përfundimin e suksesshëm të programit të studimit, projekteve kerkimore dhe përgatitjes së disertacionit. Universiteti ka anetaresim të plotë në JSTOR, një bibliotekë digjitale e perbashkët e krijuar në vitin 1995 që përfshin mbi 2,000 revista akademike.</p>

	<i>[Annex 34 CEN Books Accreditation; Annex 34.1 List of Books Newly Added in the Library; Annex 34.2 Procedure on library and literature enrichment; Annex 34.4 Information on Library Services; Annex 34.5 Directive "On the library"; Annex 2.1 Syllabuse]</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ konstaton se si pjesë e rishikimit vjetor të Programit të Masterit Shkencor në "Inxhinieri Kompjuterike", në përputhje me Politikën e Universitetit EPOKA për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, është kryer një vlerësim i plotë i programeve lëndore në mënyrë që të inkorporohen modifikime dhe përmirësime thelbësore. Ky proces përfshin përditësimin e literaturës kryesore dhe plotësuese. Programi në anglisht lehtëson aksesin në burimet akademike në fushën e inxhinierisë kompjuterike. <i>[Annex 11.1 Policy on Continuous Improvement of Study Program; Annex 34.3 Decision of the Rectorate on the requested books in function of study program]</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga vizita në Institucion dhe dokumentacioni konkludojmë se Biblioteka e Universitetit EPOKA është e disponueshme për të gjithë studentët, stafin akademik dhe stafin administrativ. Me një kapacitet prej 100 vende, një hapësirë prej 400 metra katrore, 25,000 libra dhe 2,000 revista shkencore dixhitale. Kjo literaturë është bashkëkohore dhe e përditësuar në përputhje me kërkesat e stafit akademik përmes procesit të prokurimit. https://library.epoka.edu.al/ <i>[Annex 34.5 Directive "On the library"]</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Bazuar në dokumentacion konkludojmë se në bibliotekën EPOKA ka kopje fizike të librave që shërbejnë si literaturë për lëndët e programit të studimit, por nuk ka cikle leksionesh të mbajtura nga profesorët. Librat janë të mirëorganizuar dhe të kataloguar sipas sistemit amerikan të kongresit, kryesisht në gjuhën angleze, e cila është edhe gjuha e programit të studimit. Megjithatë nuk mungojnë librat në shqip dhe turqisht. Për më tepër, Universiteti EPOKA ofron akses në bazën e të dhënave JSTOR, e cila ofron një gamë të gjerë revistash shkencore për studentët e universitetit. Ky burim në internet u jep përdoruesve të bibliotekës, stafit dhe studentëve akses falas në mbi 2 milionë libra, që përfshijnë 75 disiplina të ndryshme dhe më shumë se 2000 revista akademike dixhitale me cilësi të lartë dhe me tekst të plotë. Për më tepër, stafi dhe studentët kanë akses në burime të tjera elektronike si Cambridge Journals Online, IOP Science, New England Journal of Medicine, OECD-J Library dhe Taylor & Francis Library. <i>[Annex 34.1 List of Books Newly Added in the Library]</i> .
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Sipas vizitës së realizuar GVJ konkludon se studentët mund të gjejnë libra dhe artikuj që u nevojiten për detyrat e tyre shkollore duke shkuar në një faqe interneti të veçantë të quajtur http://lib.epoka.edu.al . Ata gjithashtu mund të përdorin një faqe interneti të quajtur JSTOR dhe një tjetër të quajtur DSpace për të gjetur më shumë informacion falas. <i>[Shtojca 37 "Shërbimet e zyrës ICTC"]</i>

<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>GVJ konkludon se Biblioteka ka gjithçka që i nevojitet për të ndihmuar studentët në këtë program, duke përfshirë katër kompjuterë. Studentët mund t'i përdorin këta kompjuterë për të hyrë në një bibliotekë të veçantë në internet të quajtur DSpace. Në DSpace, ata mund të gjejnë shumë burime akademike nga e gjithë bota. [Shtojca 37 "Shërbimet e zyrës ICTC"].</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka ka një orar që tregon se kur është e hapur për t'u përdorur nga studentët. Gjatë ditëve të javës, ajo është e hapur nga 8:30 e mëngjesit deri në 12:30 pasdite, dhe pastaj përsëri nga ora 1:30 pasdite deri në 7:30 të mbrëmjes. Të shtunave është e hapur nga ora 9:00 e mëngjesit deri në 13:00 pasdite. Këto orare janë të përshtatshme për studentët, sepse ata mund të përdorin bibliotekën pas aktivitetit akademik ose pasdite kur ata janë duke studiuar [vizitë në institucion].</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Inxhinierisë kompjuterike është përgjegjës për marrjen e librave dhe burimeve të reja që studentët t'i përdorin. Ata kanë një formular që e plotësojnë për të kërkuar resurse dhe drejtuesi i departamentit dhe administratori duhet ta miratojnë atë. Më pas, biblioteka ndihmon në procesin e blerjes dhe ata punojnë së bashku me zyrën e ICTC. Biblioteka gjithashtu merr donacione dhe pas vlerësimit të tyre, i shtojnë ato në koleksionin e bibliotekës. Biblioteka raporton informacion rreth përdorimit të librave nga studentët dhe stafi përmes një sistemi të quajtur KOHA. [Shtojca 37 "Shërbimet e zyrës ICTC"]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ gjatë vizitave në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit konkludon se biblioteka është një institucion funksional, i pajisur me kushtet e nevojshme logjistike, tituj librash të mjaftueshëm në dispozicion të studentëve, ofron akses në literaturë e artikuj shkencorë online. Institucioni ofron asistencë në nevojat akademike për programin e studimit, duke shtuar titujt e rinj sipas kërkesës së departamentit. Rekomandojmë këtu që pedagogët të dorëzojnë në bibliotekë ciklet e leksioneve për të gjitha lëndët e programit të studimit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi aksesit edhe këtu, dhe punimet e stafit akademik të jenë të aksesueshme nga të gjithë studentët. Nga sa më sipër mund të konkludojmë se ky kriter përmbushet plotësisht nga institucioni.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	EIS (Epoka Internal System) është sistemi i brendshëm i zhvilluar nga vetë institucioni, që shërben për të administruar shërbimet akademike të Universitetit EPOKA, për të gjithë studentët e programeve të studimit. Ky sistem mbështet llogaritë për të gjithë stafin administrativ dhe akademik, duke ofruar funksionalitetet e duhura për secilën njësi. Këto funksionalitete përfshijnë të gjitha proceset nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre [Shtojca 37 "Shërbimet e zyrës ICTC"; Shtojca 36 "Udhezuesi EIS"; Shtojca 1 "Statuti i Universitetit EPOKA"]
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Bazuar në Sistemin EIS, i zhvilluar nga vetë Universiteti EPOKA, konkludojmë se ai mbështet të gjithë studentët për të gjithë programet e studimit, sekretarinë mësimore me aktivitetet e tyre administrative si dhe stafin akademik me profile të dedikuara, ku shumë procese, si vlerësimi i studentëve, ankimimi nga ana e tyre, kurrikula si edhe shume procese të tjera të veprimtarisë akademike janë të digjitalizuara dhe aksesohen lehtë nëpërmjet këtij sistemi. [Shtojca 37 "Shërbimet e zyrës ICTC"; Shtojca 36 "Udhezuesi EIS"]
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Çdo student për të gjitha programet e studimit pajiset me kredencialet e nevojshme për të aksesuar sistemin EIS në fillimi të studimeve. Në panelin personal të çdo student, përfshirë këtu edhe studentët e programit të studimit Masterit Shkencor në Inxhinieri Kompjuterike mund të aksesojnë dokumentacionin e tyre personal. Bazuar edhe nga takimet me studentët, mund të themi se shumë dokumenta të programit të studimit gjenerohen nga ky sistem, por ato bëhen edhe publike në faqen zyrtare të universitetit epoka.edu.al [Shtojca 36 EIS GuideLine]
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Përsa i përket komunikimit interaktiv midis stafit akademik dhe studentëve, përdoren shërbimet e Google Platforms ku Universiteti Epoka ka domainin e tij dhe i ofron të gjithë anëtarëve të stafit dhe studentëve një email personal. Ndër shërbimet më të përdorura janë Google Classroom, Google Calendar, Google Meet etj [Shtojca 37 "Shërbimet e zyrës ICTC"]
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale	Sipas dokumentacionit të dorëzuar marrim informacion se i gjithë stafi akademik dhe administrativ që kanë të drejtë për të aksesuar të dhënat

të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	akademike të caktuara mund të shohin këto të dhëna në kohë reale, përfshirë statusin e studentëve, mungesat, notat etj. Për shkak të disponueshmërisë së të gjitha të dhënave në raportet e sistemit, ka mundësi për analiza të hollësishme të programit të studimit [Shtojca 36 "Udhezuesi EIS"; Shtojca 37 "Shërbimet e zyrës ICTC"]								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja e internetit e Universitetit EPOKA ka informacion për departamentin dhe programin e studimit në www.cen.epoka.edu.al . Aty prezantohet në një mënyrë të përmbledhur në dy gjuhë, anglisht dhe shqip, informacioni i lidhur me programet e studimit, stafin akademik, rregulloren, raportet dhe aktivitetet e ndryshme etj. Gjithashtu, departamenti ka faqen e tij te internetit, ku ofron informacion më të specializuar për studentët dhe stafin e programit të studimit, si dhe për palet e tjera të interesuara nga jashtë.								
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe intervistave të realizuara me studentët dhe stafin akademik dhe administrative konkludon se sistemi i brendshëm i zhvilluar nga vet Universiteti është një platformë e dobishme, me informacion të strukturuar dhe mundëson shërbime të nevojshme akademike për studentet, stafin akademik, si edhe instancat administrative për të kryer edhe këtu aktivitetin e tyre. Përpos sistemit EIS, komunikimin interaktiv staf akademik-studentë e ndihmojnë edhe shërbimet e Google Platform ku universiteti ka domainin e tij. Nga sa më sipër arrijmë në përfundimin se edhe ky kriter përmbushet plotësisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Sipas dokumentacionit të plotësuar nga Universiteti, raporti financiar i të ardhurave dhe shpenzimeve nga viti i mëparshëm shërben edhe si orientim për Bordin e Administrimit për të aprovuar edhe shpenzimet dhe mbështetjen financiare që departamenti kërkon cdo fillim vit për programin e studimit. Më përpara këto kërkesa kalojnë në Rektorat për aprovim, duke marë në konsideratë edhe Planin Strategjik të Universitetit dhe planin strategjik të njësisë kryesore [Tabelat Përmbledhëse_MSc_CEN_shqip]

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion</p>	<p>Nga informacioni i paraqitur në tabelat përmbledhëse financimi i burimeve njerëzore për programin e studimit paraqitet sipas pagave në një vit, shpenzime të tjera janë në lidhje me shpenzimet operative, ose pajisje shtesë të kërkuara nga Departamenti përgjegjës dhe të miratuara nga rektorati plus edhe taksat. Të ardhurat për programin e studimit vijnë sigurisht nga tarifat e studentëve, shtuar këtu edhe të ardhurat nga projekte të ndryshme kërkimore kombëare ose ndërkombëtare <i>[Tabelat Përmbledhëse_MSc_CEN_shqip]</i>.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Universiteti EPOKA kryen auditin vjetor të jashtëm në lidhje me situatën financiare. Raporti ka informacion mby hyrjet dhe daljet (shpenzimet) e kryera, si dhe njerëzit e përfshirë. Ai përfshin detaje rreth burimeve (si grantet dhe tarifat e studentëve) dhe qëllimin e shpenzimit (si shërbimet e ofruara nga kompania ose kompani të tjera që ata punësojnë). <i>[Annex 35 Expenditure and Revenues; Annex 46 Decision of the Rectorate of Epoka University No.6, dated 05.11.2019 on the conduct of the internal audit; Annex 49 Internal Audit 2019_Non-Compliance Reports]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Sipas raportit të brendshëm për programin e studimit, në fund të çdo viti akademik, zyra e financës në bashkëpunim me zyrën e administratorit përgatit buxhetin përfundimtar të vitit akademik për çdo program studimi. <i>[Annex 35 Expenditure and Revenues; Annex 46 Decision of the Rectorate of Epoka University No.6, dated 05.11.2019 on the conduct of the internal audit; Annex 49 Internal Audit 2019_Non-Compliance Reports]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të</p>	<p>Sipas informacionit të paraqitur në tabelat përmbledhëse të ofruara për programin e studimit, për 2 vitet e mëparshme akademike ka një bilanc pozitiv vjetor, tregues ky për qëndrueshmërinë financiare të këtij program studimi. Bazuar në raportin e brendshëm të vlerësimit, raportet financiare si: pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës dhe pasqyrat e tjera financiare si dhe buxheti vjetor institucional, kompania dhe institucioni kanë bilanc vjetor pozitiv dhe stabilitet financiar që garanton progresin dhe qëndrueshmërinë financiare të institucionit. <i>[Tabelat Përmbledhëse_MSc_CEN_shqip]</i></p>



financimit të programeve të studimeve.				
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, informacionin e paraqitur në tabelat përmbledhëse konkludon se bilanci financiar i programit të studimit është pozitiv, tregues i qëndrueshmërisë financiare të institucionit dhe programit të studimit. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ konstaton se Universiteti harton politika dhe procedura në përputhje me Statutin e Universitetit, rregulloret e brendshme duke zbatuar Udhëzimin nr.10, datë 15.05.2019 “Për procedurat e Aplikimit dhe Regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ndryshuar. Departamenti përgjegjës i programit të studimit, zbaton me rigorozitet Udhëzimet dhe direktivat e MAS, si edhe rregulloren e Universitetit për rekrutimin dhe trajtimin deri në përfundim të diplomimit për studentët e programit të studimit. <i>[Annex 1 Statute of Epoka University; Annex 1.1 Basic Regulation]</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton se pasi nënshkruhet kontrata për të studiuar në Institucion, aplikanti bëhet student zyrtar dhe duhet të ndjekë të gjitha rregullat dhe mënyrat e të mësuarit që ka Universiteti, të cilat janë të njëjta dhe barabarta për të gjithë studentët. Çdo vit shkolla i referohet Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Rrjetit Akademik Shqiptar për hapat e regjistrimit për vitin e ardhshëm të studimeve. <i>[vizitë në Sekretarinë Mësimore, vizitë në institucion]</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Në fillim të cdo viti akademik, Departamenti i referohet Vendimin e Përbashkët të QSHA dhe Qendrës Ndërinstitucionalë RRASH nr. 10 datë 10.07.2023 “ Për miratimn e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit ne Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2023-2024” për regjistrimet dhe transferimin e studimeve. Te gjitha informacionet e referuara për pranimin dhe transferimin e studimeve publikohen ne faqen zyrtare të Universitetit, faqen e zyrës së pranimit dhe rrjetet sociale zyrtare të universitetit. Kriteret e pranimit: https://admissions.epoka.edu.al/home-master-of-science-1928-1930.html?lang=EN&dpid=2&t=master-of-science&catid=1928&menuid=1930
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Universiteti "EPOKA" pranon në programet e studimeve të ciklit të dytë studentë vendas dhe nderkombetarë sipas kuotave të propozuara nga Bordi Administrativ i Universitetit dhe miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Për të rritur cilësinë e programit të studimit, Universiteti jep bursa te bazuara në merita për më të mirët për të gjithë kohëzgjatjen normale të studimeve. Kriteret e pranimit afishohen në faqen zyrtare sic është përmendur më sipër dhe janë të qarta dhe të kuptueshme për të gjithë të interesuarit. Për tu njohur me përparimin në lëndë të ndryshme studentët shfrytëzojnë sistemin e brendshëm EIS.

	<i>[Annex 17 Admission Criteria for undergraduate and Graduate programs for 2023-2024]</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ konstaton se Zyra e Pranimeve ofron informacion të detajuar mbi universitetin dhe programet e studimit për të gjithë të interesuarit. Studentët potencial informohen për kriteret e pranimit dhe kërkesat e nevojshme për t'u regjistruar ne Universitetin "EPOKA". Pas marjes së informacionit te përgjithshëm nga Zyra e Pranimeve, aplikantët shoqërohen për të marrë informacion më të detajuar nga pedagogët përkatës për programe të vecanta studimi. Në faqen e Universitetit publikohen kriteret e pranimit si edhe informacione të detajuara për kurrikulën e programit të studimit. Kriteret e pranimit: https://admissions.epoka.edu.al/home-master-of-science-1928-1930.html?lang=EN&dpid=2&t=master-of-science&catid=1928&menuid=1930
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ nuk gjeti evidence specifike në lidhje me kriteret e veçanta për përzgjedhjen e e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara por gjeti evidence në lidhje me ofrimin e sistemit të bursave në lidhje me këto kategori studentësh <i>[Annex 17 Admission Criteria for undergraduate and Graduate programs for 2023-2024]</i> . Përpos përzgjedhjes së përzgjedhjes së kandidatëve, Universiteti EPOKA është partner në projektin IDEA, i financuar nga program Erasmus+. Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i aksesit, krijimi i kushteve të mësimi të arsimit gjithëpërfshires dhe zhvillimi i mundësive të punësimit për studentët me aftësi të veçanta dhe studentët me veshitësi në të nxënë. Në këtë drejtim universiteti EPOKA ka krijuar ekipin e aksesueshmërisë. Ky ekip përbëhet nga një staf për çdo njësi. <i>[Annex 20.6 Accessibility Team]</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ konkludon se kriteret e përzgjedhjes publikohen në faqen zyrtare të Universitetit ku përshihen këtu edhe kriteret për aplikantë të huaj. Bazuar ne evidencat e paraqitur nga institucioni konstatojmë se kriteret për tu pranuar në ciklin e dytë të studimeve janë si më poshtë: <ol style="list-style-type: none"> 1. Studentët me diplome Bachelor ose diplomë ekuivalente në disiplina të përcaktuara nga Komisioni Shkencor i Departamentit përkatës; 2. Niveli i aftësisë angleze B1 sipas CEFR në një nga provimet e mëposhtme: <ol style="list-style-type: none"> a. Cambridge; b. IELTS; c. Testi TOEFL i bazuar në internet(iBT); d. Testi TOEFL i bazuar në letër (ITP); e. TOEIC; f. GESE; g. APTIS (4 aftësi);

	<i>[Annex 17 Admission Criteria for undergraduate and Graduate programs for 2023-2024; Annex 51 Admission Quotas for 2022-2023 Academic year; Annex 18 Student registration procedure, student database register]</i>		
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, dalim në konkluzionin se Universiteti aplikon bursa të bazuara në merita për rritjen e cilësisë së programit, por edhe për shtresa në nevojë.</p> <p>Bursat janë për:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Femijë të policive të vrarë në krye të detyrës. 2. Studentët jetim me të ardhura të ulëta familjare. 3. Studentë që i përkasin komunitetit Rom/Egjiptian. 4. Kandidatë që kanë arritje të larta në sportet olimpike 5. Studentë nga bashkia Vorë. <p><i>[Annex 46 Directive On Scholarships]</i></p>		
Konkluzione	<p><i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit, raportit përmbledhës konkludon se kriteret e përzgjedhjes së studentëve janë në përputhje me Udhëzimet e Ministrisë përkatëse, rregullores dhe statutit të Universitetit. Janë të shpallura në faqen zyrtare të universitetit, të dukshme dhe të aksesueshme nga publiku. Nga sa më sipër arrijmë në përfundimin se ky kriter përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, vërejmë se ka informacion të plotë për kriteret e vlerësimit dhe përparimit akademik të studentëve nga një vit në tjetrin. Një student që merr notën CC në një lëndë konsiderohet si notë kaluese. Nje student që merr FD dhe FF në një lëndë të detyrueshme konsiderohen si nota jo kaluese dhe në këtë rast studenti është i detyruar të përsërisë lëndën. Studenti që merr FD dhe FF nga një lëndë me zgjedhje notat konsiderohen si jokaluese por studenti nuk është i detyruar të përsërisë të njëjtën lëndë por mund të zgjedhë një lëndë tjetër me zgjedhje në mënyrë që të përmbushë të gjitha kreditet e caktuara për lëndët me zgjedhje në programin e studimit.</p> <p>Nje student me notë mesatare kumulative prej 2.00 e lart dhe pa notë FD ose FF konsiderohet kalues. Studentët duhet të kalojnë të gjitha lëndët në program për të përfunduar me sukses programin e studimeve pasuniversitare.</p>

	[Annex 30 Student_Guide_2022_2023/Article 46]
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ bazuar në dokumentacion dhe më konkretisht në Direktivën për transferimin e studimeve dhe rregulloren për programet e ciklit të dytë, konkludon se çdo student, përfshirë studentët e huaj, informohen në lidhje me procedurat dhe afatet e njohjes së diplomës së tyre të studimeve të mëparshme, me qëllim që të kemi dokumentacionin e plotë. Studentët drejtohen tek Zyra e Pranimeve ku orientojnë për plotësimin e aplikimit. Këto aplikime shkojnë më pa në Departamentin përgjegjës për programin e studimit. Është Komiteti Shkencor i ngritur në Departament, që vlerëson aplikimet, vlefshmërinë e tyre, bën konvertimin e lëndëve apo kualifikimeve. Më pas ky vendim shkon për miratim në Dekanat. Studentet gjithashtu informohen për njohjen e diplomes së tyre në lidhje me akreditimin e programit të Sipas udhëzimeve dhe rregullores. [Annex 17.2 Directive on Student Transfer]
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe intervistës së kryer me studentët e programit të studimit, studentët informohen me menyrën e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve gjatë javës së parë të studimeve që përkon edhe me javën e orientimit, përpos prezantimit që secili nga pedagogët i bën syllabusit të lëndës ku përfshihet këtu edhe vlerësimi. [Annex 3 Regulation on second cycle study programs; Annex 30 Student_Guide_2022_2023; Annex 21 Syllabuses]
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se informacionet mbi kurrikulën ku përfshihet edhe diplomimi i studentëve të programit të studimit janë të publikuara në faqen zyrtare të Universitetit: https://eis.epoka.edu.al/curricula/14/program Kriteret dhe procedurat e diplomimit janë të përcaktuara në dokumentacionin e dorëzuar për programin e studimit. Kriteret dhe procedurat e diplomimit janë të përcaktuara në rregulloren bazë, në rregulloren për programet e ciklit të dytë, si edhe në guidën e studentit/Neni 22.2, me të cilën studentët pajisen çdo fillim viti akademik. Në fillim të semestrit të dytë, në vitin e fundit të studimeve secili student përzgjedh një mentor, i cili e orineton për punimin e temës së diplomës si nga ana teknike ashtu edhe për afatet e kontrolleve dhe dorëzimit përfundimtar në respekt të kalendarit akademik [Annex 1.1 Basic Regulation; Annex 3 Regulation on second cycle study programs]
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të	Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe intervistat me stafin administrativë, GVJ konstaton se përpos informacionit në faqen zyrtare të Universitetit, rrjetet e tyre sociale, Zyra e pranimeve i jep informacion të vazhdueshëm studentëve aktualë, por edhe të interesuarve të tjerë që shfaqin interes për programet e studimit të ciklit të dytë të Universitetit EPOKA.

ardhshëm mbi programin e studimit.				
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se informacionet për këtë program e studimit, mënyrën e vlerësimit, kontrollit të dijeve, kriteret dhe procedurat e diplomimit janë të qarta, të shpallura për të gjithë të interesuarit. Informacionet ofrohen nga stafi administrativ, se bashku me stafin akademik gjatë procesit mësimor për lëndët përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Sipas intervistës me studentët, dokumentacionit të dorëzuar, studentët informohen për çdo informacion në lidhje me programin e studimit, javën e parë që përkon me javën e orientimit, nga secili pedagog në orën e parë të mëimit, nga faja zyrtare e Universitetit, si edhe nga sistemi EIS, ku secili prej tyre pajiset me kredencialet përkatëse dhe së fundi edhe nga statute dhe rregulloret e brendshme [Shtojca 1 "Statuti i Universitetit EPOKA"; takim me studentët]
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Siç është përmendur më sipër, përpos sistemit EIS, informacionet që jep pedagogu përkatës në lidhje me syllabuset, programin mësimor për çdo lëndë, të gjitha informacionet publikohen në këtë seksion në faqen zyrtare të Universitetit: https://cen.epoka.edu.al/home-prof-l-master-in-computer-eng-1944-184.html [Annex 2.1 Curricula of study program]
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ konstaton se Zyra e planifikimit të karrierës dhe studentëve të diplomuar (ALUMNI), është përgjegjëse për të informuar studentët në lidhje me mundësi të reja për intership, apo vende pune në kompani dhe biznese me të cilat Universiteti ka marrëveshje dhe jo vetëm. Organizimi i eventeve të tjera si Forum i hapur, sesione informative, apo edhe vizita në kompani shërbejnë për studentët që të integrohen në tregun e punës. Panairi i karrierës është një aktivitet që zhvillohet çdo vit, ku marrin pjesë më shumë sesa 100 kompani, pikërisht për të ndihmuar studentët të integrohen në tregun e punës. Njoftimet për vende të lira pune shpërndahen gjithashtu nga ALUMNI tek studentët nëpërmjet e-mailit, në seksionin e dedikuar të ALUMNI-t në faqen zyrtare apo edhe në rrjetet sociale të Universitetit: (http://cpao.epoka.edu.al/). https://www.epoka.edu.al/news-epoka-university-organizes-the-10th-edition-of-the-career-fair-6277.html

<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistat e realizuara GVJ konkludon se studentët marrin informacionin e nevojshëm për zhvillimin e një lënde, infrastrukturën në dispozicion të realizimit të saj nga pedagogu i lëndës, dhe orientimit gjatë javës së parë të Orientimit që realizohet në Universiteti. Përpos kësaj është edhe “Udhëzuesi i studentit” i përgatitur posaçërisht për studentët ku ofrohet informacion për programin e studimit, organizimin e tij, rregullat që duhet të ndjekin ata si student etj. <i>[Annex 30 Student_Guide_2022_2023]</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët mund të aksesojnë nga kudo ndërfaqen e tyre të sistemit EIS, nëpërmjet kredencialeve që ata pajisen (adresë e-mail dhe passëord. Aty mund të gjejnë përveç informacionit personal, edhe informacionet e nevojshme për programin e studimit. <i>[Annex 36 EIS GuideLine - Lectures and Students; Annex 37 ICTC Office Services]</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ nga sa më sipër arrijmë në përfundimin se studentët kanë kanale të ndryshme informacioni brenda në institucion, si nëpërmjet zyrave administrative ashtu edhe përmes mjeteve online, të cilat ofrojnë informacion të mjaftueshëm për programin e studimit, programin lëndor, procesin mësimor, si edhe mundësi punësimi. Ndaj ky kriter përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Në përfundim të vizitës së kryer në Sekretarinë mësimore dhe shqyrtimit të dokumentacionit ka informacion të qartë për numrin e të diplomuarve në programin e studimit, i cili raportohet në instancat përkatëse (MASR, QKA). Për programin e studimit, numri i të diplomuarve për pesë vitet e fundit është si më poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 7 studentë për vitin akademik 2018-2019 - 3 studentë për vitin akademik 2019-2020 - 8 studentë për vitin akademik 2020-2021 - 0 studentë për vitin akademik 2021-2022 - 4 studentë për vitin akademik 2022-2023 <p><i>[Tabelat Përmbledhëse_MSc CEN_shqip]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në</p>	<p>Të gjithë statistikat vjetore për numrin e të regjistruarve, cregjistrimet nga program, largimet përpara diplomimit apo të skualifikuarit pa arritur në diplomim mbahen nga sekretaria mësimore. Kjo është verifikuar nga</p>



<p>programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në sekretari. Për këtë program studimi këto të dhëna janë të përmbledhura në informacionin në tabelën përmbledhëse të programit të studimit. [Tabelat Përmbledhëse_MSc_CEN_shqip]</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konstaton se sistemi i brendshëm i informacionit (EIS) i Universitetit EPOKA është modular, me panele ku stafi i autorizuar nëpërmjet llogarive përkatëse hedh dhe menaxhon të dhënat statistikore të studentëve. Të gjitha databazat dhe serverët që janë funksionale në Institucion aksesohen vetëm nga stafi ZKTIK, zyrë që është vizituar nga GVJ gjatë vizitës në Institucion, duke zbatuar ruajtjen e konfidencialitetit. [Annex 36 EIS GuideLine - Lectures and Students; Annex 37 ICTC Office Services]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësjive përgjegjëse për menaxhimin (sekretarite mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar, kontrollet periodikë realizohen nga grupi i auditit të brendshëm në zbatim të vendimeve të marra nga ana e Rektoratit në Institucion, duke zbatuar politikat e cilësisë. Subjekt i këtij kontrolli janë të gjitha njësitë administrative dhe ato akademike. Raporti i hartuar diskutohet në rektorat duke identifikuar këtu boshllëqet apo pasaktësitë e gjetura në punë. Përsa i përket Departamentit që ofron këtë program studimi sipas Evidencës 48, janë gjetur disa pasaktësinë dokëmentacion në lidhje me mungesë firmash, si edhe mungesë të kopjeve për aplikime të studentëve. Mbi këtë raport hartohet edhe plan i veprimit për marjen e masave dhe zgjidhjen e situatave problematike nëse ka. Në rastin e Departamentit që ofron programin e studimit, parregullsitë e sipërmëndura janë korigjuar dhe plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm të munguar. [Annex 47 Decision of the Rectorate of Epoka University No.6, dated 05.11.2019; Annex 40 Quality Policy; Annex 48 Internal Audit 2019 Non-Compliance Reports; Annex 49 Action Plan with Corrective and/or Preventive Actions in Response to Identified Issues Sample]</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>GVJ konstaton se raportet analitike për regjistrimin dhe diplomimin e studentëve mbahen nga sekretaria mësimore, e cila mund ti raportojë këto të dhëna tek njësia bazë. Anketat për të diplomuarit realizohen nga ALUMNI. Pas përpunimit të të dhënave, hartohet edhe raporti përmbledhës që publikohet edhe në faqen zyrtare. Njësia bazë duhet të mbledhë këto të dhëna dhe ti analizojë në një raport përfundimtar vjetor dhe të marrë masa proactive, sidomos për numrin e ulët të regjistrimeve gjatë tre viteve të fundit. https://cpao.epoka.edu.al/home-alumni-statistics-1457228.html?lang=EN&dpid=2&t=alumni-statistics&catid=1457&menuid=228</p>




	<i>[Annex 39 Summary Tables_PM CEN;Annex 4.2 Alumni survey questionnaire 2021-2022]</i>			
Konkluzione	GVJ nga sa më sipër konkludon se informacioni në lidhje me regjistrimin, largimin, cregjistrimin, të diplomuarit është i qartë, i raportuar nga sekretaria mësimore drejt instancave të ndryshme, por edhe njësisë të brendshme administrative dhe akademike në Universitet. Rekomandojmë se njësia bazë në raportin vjetor të përfshijë informacionin e përpunuar për punësimin e studentëve dhe analizës për numrin në ulje të të regjistruarve dhe ta adresojë këtë në instancat e tjera përgjegjëse në Universitet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në dokumentacion GVJ konkludon se Këshilli studentor është organi përfaqësues i studentëve, i cili përcjell zërin e studentëve tek administrata e Institucionit dhe ndihmon në zhvillimin e tyre të mëtejshëm akademik. Mënyra e zgjedhjes së studentëve në këtë organ është përcaktuar në kuadrin ligjor të Universitetit. <i>[Annex 1 Statute of Epoka University;Annex 20.1 Statute_of_Student_Council]</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Bazuar në dokumentacion, si edhe në arsytim të pikës së mësipërme konkludojmë se përfshirja e studentëve në Senatin akademik, i cili është organi me i lartë vendimarrës, dëshmon përfshirjen e tyre ne vendimarrje ne Institucion. Përpos kësaj përfshirja e studentëve në Komisionin e Përhershëm të cilësisë, i cili ka në fokus vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së proceseve akademike, është tregues për përfshirjen e tyre në këtë process vlerësues. Së fundmi vlen të përmendim këtu edhe anketimin që realizojnë studentët për vlerësimin e cdo pedagogu për secilën lëndë që zhvillojnë, ne lidhje me cilësinë e zhvillimit të mësimin, marerialet e përdorura, cilësinë tregon se Institucioni mer në konsideratë të drejtpërdrejt mendimin e studentëve në vlerësimin dhe përmirësimin e proceseve akademike. <i>[Annex 20.1 Statute_of_Student_Council]</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të	GVJ konstaton se studentët përfshihen në përmirësimin e programit të studimit indirekt, nëpërmjet plotësimin të pyetësorëve mbi secilën lëndë e pedagog për mësimdhënie, si edhe nëpërmjet pyetësorëve të realizuar nga ALUMNI.

studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Ata kanë strukturat e tyre dhe janë të përfshirë në vendimarrje sipas kuadrit ligjor të Intitucionit. <i>[Annex 1 Statute of Epoka University; Annex 12.4 Open Lecture Assessment Form]</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në bisedat e realizuara me studentët, GVJ konkludon se studentët kanë të drejtën të njihen me mënyrën e vlerësimit të testimeve dhe kanë mundësinë ta ankimojnë rezultatin nëpërmjet një kërkesë, e cila mund të sjellë më pas edhe rishikimin e tezës nga një komision i posaçëm. E gjithë procedura është e detajuar në aktet rregullatore institucionale. <i>[Annex 1.1 Basic Regulation; Annex 3 Regulation on second cycle study programs]</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se Institucioni përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Studentët janë të përfshirë në disa nga organet drejtuese të IAL-së sic janë Këshilli Studentor, Senati Akademik, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, Bordi Etikës etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Universiteti EPOKA ka ngritur Sekretarinë Mësimore, Zyrën e Dekanit të Studentëve dhe Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni, të cilat ofrojnë informacion të plotë mbi përparimin akademik dhe mundësitë e zhvillimit të karrierës. Këto zyra ndihmojnë studentin gjatë studimeve dhe mbajnë kontakte me të edhe pas diplomimit. I gjithë funksionimi i këtyre organeve është i përcaktuar në Statutin e Universitetit, dhe Rregulloren e Institucionit. <i>[Shtojca 1 Statuti i Universitetit; Shtojca 1.1 Rregullorja e Universitetit]</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe	Bazuar në intervistat e realizuara në institucion, si edhe dokumentacionit të shqyrtuar konkludojmë se mekanizmat dhe organet për informim dhe suport akademik të studentëve fillojnë me pajisjen e tyre me adresë e-mail ku realizohen komunikimi zyrtar, së bashku me systemin EIS, për komunikim interaktiv elektronik me studentët dhe support.

<p>asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Në javën e parë të cdo viti akademik Zyra e DOS-it në bashkëpunim me fakultetet organizon Ditë Orientimi për studentët e vitit të parë. Në këtë aktivitet studentët pajisen me të gjitha informacionet që u nevojiten nga zyrat kryesore administrative të universitetit.</p> <p>Sekretaria mësimore i pajis me “Udhëzuesin e Studentit”, ku ka informacion te detajuar per jetën e studentit nga regjistrimi deri ne diplomim. Një këshillues akademik, anëtar i stafit akademik i këshillon studentët dhe i asiston në jetën e tyre akademike.</p> <p><i>[Annex 30 Student_Guide_2022_2023]</i></p>																									
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>GVJ konstaton se Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar (Alumni) i ofron support studentëve në eksplorimin e karrierës së tyre; i ndihmon ata të shohin rendësinë e arsimimit të tyre nëpërmjet zhvillimit të karrierës së tyre; dhe krijojnë një rrjet midis Alumnive të EPOKA për të mbajtur lidhjet e tyre me universitetin dhe me njëri-tjetrin, perditëson të dhënat e të diplomuarve, organizon "Kthimi i të Diplomuarve (Alumni) në shtepi". Këto takime sociale u japin të diplomuarve të Universitetit EPOKA mundësinë që të bashkohen për të krijuar lidhje me njëri tjetrin.</p> <p><i>[Annex 1.1 Basic Regulation; Annex 16 EPOKA University Quality Assurance Handbook;]</i></p>																									
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion GVJ konkludon se zyra e karrierës i ndjek të diplomuarit e vitit të mëparshëm nëpërmjet plotësimit të një formulari/ankete në Google Forms, ku kërkohet informacion mbi statusin e punësimit, pozicionin e punës në rast se janë të punësuar, kompaninë dhe më pas kërkohen sygjerime mb përmirësimin e kurrikulës.</p> <p>Pas përpunimit, rezultatet ndahen me të gjithë stafin e angazhuar në universitet për përmirësim të mëtejshëm të punës në Universitet.</p> <table border="1" data-bbox="624 1373 1428 1682"> <thead> <tr> <th>Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike"</th> <th>Numri total i studenteve të diplomuar</th> <th>Numri total i studentëve të punësuar në përputhje me diplomën</th> <th>Numri total i studentëve të punësuar jo në përputhje me diplomën</th> <th>Nuk të dhëna</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>7</td> <td>6</td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>21</td> <td>14</td> <td>2</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>9</td> <td>8</td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>23</td> <td>8</td> <td>1</td> <td>14 (duke u perditësuar)</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>[Annex 4.2 Alumni survey questionnaire 2021-2022; Tabelat Përmbledhëse MSc CEN shqip]</i></p>	Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike"	Numri total i studenteve të diplomuar	Numri total i studentëve të punësuar në përputhje me diplomën	Numri total i studentëve të punësuar jo në përputhje me diplomën	Nuk të dhëna	2018-2019	7	6	1	-	2019-2020	21	14	2	5	2020-2021	9	8	1	-	2021-2022	23	8	1	14 (duke u perditësuar)
Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike"	Numri total i studenteve të diplomuar	Numri total i studentëve të punësuar në përputhje me diplomën	Numri total i studentëve të punësuar jo në përputhje me diplomën	Nuk të dhëna																						
2018-2019	7	6	1	-																						
2019-2020	21	14	2	5																						
2020-2021	9	8	1	-																						
2021-2022	23	8	1	14 (duke u perditësuar)																						
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, vizitave të realizuara në Insitucion dhe RVB se studentët kanë informacion dhe suport të</p>																									



	<i>mjaftueshëm nga strukturat që Universiteti ka ngritur për këtë rol gjatë jetës së tyre akademike dhe më pas nga zyrat e karrierës dhe ALUMNI pas vitit të parë të diplomimit. Arrijmë në përfundimin se ky kriter përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Universiteti “Epoka” i kushton një vëmendje procesit mësimor dhe cilësisë në procesin mësimor. Në këtë drejtim një Udhëzues në lidhje me mësimdhënien, mësimnxënien dhe cilësinë në procesin mësimor është hartuar dhe zbatohet me korrektësi [<i>Annex 11 Policies for Learning, teaching and quality teaching</i>].</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë Kompiuterike monitoron procesin mësimor. Në drejtim të procesit mësimor stafi akademik zbaton teknika inovative që janë rezultate të fituara nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> Eksperienca nga mobiliteti me universitete të tjera në kuadër të projekteve Erasmus+ dhe Cost Action; Marja e mendimit përmes sondazhe me studentët në lidhje me përmbajtjen e programit mësimor dhe procesin mësimor; Mendimin nga punëdhënësit dhe studentët e diplomuar; <p>[<i>takim me zyren e NJSBC-sw; takim me stafin akademik</i>].</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Universiteti “Epoka” ka ngritur një sërë strukturash që merren me monitorimin e procesit mësimor.</p> <p>Vlen të përmenden këtu:</p> <ol style="list-style-type: none"> Njësia bazë e cila është përgjegjëse kryesore për vlerësimin e punës së stafit akademik dhe ndihmsës të tij. Njësia bazë monitoron përmbushjen e procesit mësimor në përputhje me përmbajtjen e programit mësimor, orarit mësimor dhe ngarkesës së deklaruar për çdo staf akademik; Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë e cila monitoron stafin akademik përmes sondazhit të veçantë në lidhje me matjen e performancës së stafit akademik. Të dhënat diskutohen në njësinë bazë dhe reflektohen edhe në raportin vjetor Institucional [<i>Annex 27 Institutional Annual Report_2021_2022, fq 70</i>];
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm i Cilësisë janë dy struktura përgjegjëse për hartimin e vlerësimeve periodike të studentëve dhe përthithjen e mendimit të tyre në lidhje me përmbajtjen e programit mësimor dhe cilësinë në mësimdhënie nga ana e stafit akademik. Rregullorja Themelore dhe Rregullorja e Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë japin informacion studentëve në lidhje me procedurën e ankimit. GVJ zhvilloi një takim të veçantë me studentët dhe konstaton se ata janë të informuar në lidhje me procedurat e ankimit dhe mënyrën e trajtimit të tyre por shembuj nuk u sollën në këtë drejtim</p> <p>[<i>takim me studentët; Annex 1.1 Basic Regulation; Annex 3 Regulation on second cycle study programs</i>].</p>

<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë organizon anketime semestrale adresuar studentëve për të vlerësuar cilësinë në mësimdhënie [Annex 12 Directive on Academic & Administrative Performance Assessment & Quality Improvement; Annex 20.4 Student Satisfaction Survey; Annex 53 Academic Staff Satisfaction Survey Form.]. GVJ u njoh me përmbajtjen e anketimeve dhe konstaton se në to përfshihen të gjithë indikatorët e mësimdhënies duke ju dhënë mundësinë studentëve të shprehin lirshëm mendimin e tyre për procesin mësimor dhe stafin akademik. Rezultatet e anketimeve u paraqiten në mënyrë individuale stafit akademik dhe rezultatet e përpunuara paraqiten ne raportin vjetor institucional ku një kopje e të cilës paraqitet edhe në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe bëhet publike në faqen kryesore të universitetit “Epoka” [Annex 25 Annual Report on Quality Assurance Activities of the PCQA 2020-2021 and regulation On The Organization and Functioning of the PCQA; Annex 27 Institutional Annual Report 2021_2022].</p> <p>Njësia bazë monitoron punën e stafit akademik. Një vlerësim në lidhje me mësimin e hapur të stafit akademik ndërmerret nga ana e tyre dhe diskutimet e rezultateve janë subjekt të mbledhjeve të zhvilluara në këtë drejtim [Annex 12.4 Open Lecture Assessment Form; takime në institucion].</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton se cilësia në mësimdhënie është e lidhur ngushtë me cilësinë e performancës së stafit akademik. Në këtë drejtim Institucioni në strategjinë e tij thekson synimet për rritje të cilësisë në drejtim të kualifikimit të stafit akademik, cilësisë në përmbajtjen e punimeve shkencore, rritjen e pjesëmarrjes në konferenca dhe simpoziume dhe rritjen e mobilitetit të stafit akademik në programet Erasmus + dhe Cost Action. Praktikant më të mira përmenden ne raportet vjetore ku GVJ u njoh me arritjen e stafit akademik në publikimet shkencore të standarteve të larta.</p> <p>[Annex 5 Epoka university strategy; Annex 5.1 Department strategic plan, mission of the study program; Annex 10.1 Strategic Plan on Internationalization].</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Universiteti “Epoka” ka ngritur një sërë strukturash që merren me monitorimin e procesit mësimor. Njësia bazë dhe Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë struktura përgjegjëse në Universitetin “Epoka” për monitorimin e procesit mësimor. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm i Cilësisë janë dy struktura për hartimin e vlerësimeve periodike të studentëve dhe përthithjen e mendimit të tyre. Institucioni monitoron edhe performancën e stafit akademik dhe mbështet teknikat inovative në mësimdhënie.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Universiteti “Epoka” ka një strategji të mirëkonceptuar ku një komponent i rëndësishëm është cilësia në procesin mësimor [Annex 5 Epoka university strategy; Annex 5.1 Department strategic plan, mission of the sudy program; Annex 10.1 Strategic Plan on Internationalization]. Siç është theksuar në standartet më sipër në këtë raport strategjia institucionale është reflektuar edhe në strategjinë e departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike ku ky komponent gjen një gjithëpërfshirje. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike synon cilësinë në disa fusha prioritare ku vlen të përmenden:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sigurimi i një cilësie të lartë mjedisore për mësimdhënien dhe mësimnxënien; Rekrutim, arsimimin dhe diplomimin në nivelin Master me cilësi të lartë; Sigurimi i një mjedisi me cilësi për kërkime shkencore; <p>Institucioni ka hartuar edhe shumë dokumenta për të garantuar përmbushjen e objektivave të vendosur në fushat prioritare në lidhje me cilësinë.</p> <p>Konkretisht GVJ u njoh me disa prej tyre si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Manual i Sigurimit të Cilësisë për Universitetin “Epoka” [Annex 16 EPOKA University Quality Assurance Handbook]; Rregullore per Organizimin dhe Funkionimin e PCQA-së [Annex 16.1 Regulation on The Organization and Functioning of the PCQA]. Udhëzimin e Universitetit “Epoka” për “Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative dhe Përmirësimet e Cilësisë” [Annex 12 Directive on Academic & Administrative Performance Assessment & Quality Improvement]; Formati i Matjes së Peformancës Akademike; <p>Universiteti “Epoka” është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjithë njësitë përbërëse organizative. Në këtë drejtim GVJ konstaton strukturat aktive si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC); Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave; Bordi i Provimeve;



	<p>e. <i>Bordi i Vlerësimit të Performancës Akademike dhe Përmirësimit të Cilësisë;</i></p> <p>Strukturat janë aktive dhe zbatojnë me korrektësi procedurat dhe përgjegjësitë e përcaktuara qartë në Statut të Universitetit “Epoka”. Në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë është edhe Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike i cili operon në koherencë të plotë me procedurat e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë ku garantohej përfshirja e stafit akademik dhe studentëve <i>[takim me Përgjegjësin e njësisë bazë dhe Dekanin e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë]</i>.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni siguron një gjithpërfshirje në procesin e sigurimit të cilësisë <i>[takim me zyrën e NJSBC-së]</i>. GVJ konstaton në përbërjen e Komisionit të Përhershëm të Cilësisë përfaqësimin e studentëve. Konkretisht Komisioni I Përhershëm I Cilësisë bazuar edhe në nenin 4 të Rregullores së tij përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 3 anëtarë stafi akademik (PAE) me gradën minimale Dr.; • 2 anëtarë stafi administrativ; • 1 anëtar ekspert i jashtëm; • 1 anëtar përfaqësues nga Alumni; • 1 anëtar (Z/Kryetar I Këshillit Studentor për Cështjet e Sigurimit të Cilësisë) <p><i>[Tabelat Përmbledhëse_MSc_CEN_shqip; Annex 16 EPOKA University Quality Assurance Handbook; Annex 16.1 Regulation on The Organization and Functioning of the PCQA]</i>.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ u njoh me dy prej instrumentave kryesore të jashtëm për sigurimin e cilësisë në Universitetin “Epoka” respektivisht Akreditimi Institucional dhe Akreditimi i programeve të studimit të cilat institucioni i konsideron si detyrim ligjor bazuar në nenin 104 Ligji i Arsimit të Lartë nr.80/2015. Ecuria në proceset e akreditimit të jashtëm janë një komponent në raportet vjetore institucionale <i>[Annex 27 Institutional Annual Report 2021_2022]</i>.</p> <p>Institucioni konsideron rekomandimet e dhëna në kuadër të procesit të akreditimit dhe reflekton përmes plan veprimeve në përmirësimin e problematikave dhe rekomandimeve të reflektuar nga ekspertizat e jashtme. Raportet e vlerësimeve (të brendshëm dhe të jashtëm) publikohen në faqen e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për</p>	<p>Universiteti “Epoka” kontribuon në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me kualifikimin e personelit akademik. Në lidhje me të Institucioni ka tregues të qartë dhe të matshëm lehtësisht të identifikueshëm në buxhet. Institucioni alokon një fond të veçantë në lidhje me promovimin e stafit akademik që ka performancë të lartë në botime shkencore dhe siguron mbështetje financiare për pjesëmarrje të tij në konferenca dhe simpoziume shkencore. Universiteti “Epoka” dhe Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike siguron mbështetje stafi akademik në drejtim</p>

arritjet më të mira në programin e studimit.	të rritjes së mobilitetit të tij me qëllim përfitim të eksperiencave dhe metodologjive të reja të mësimdhënies. <i>[Annex 10.3 List of students and staff mobility toward and from study program; Annex 35 Expenditure and Revenues.; Tabelat Përmbledhëse MSc CEN shqip].</i>			
Konkluzione	<i>Universiteti "Epoka" është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjithë njësitë përbërëse organizative. GVJ konstaton strukturat aktive si Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave, Bordi i Provimeve dhe Bordi i Vlerësimit të Performancës Akademike dhe Përmirësimit të Cilësisë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë. Institucioni bazuar në kuadrin ligjor i nënshtrohet procesit të akreditimit të jashtëm institucional dhe akreditimin për program studimi në mënyrë periodike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Universiteti "Epoka" përthith mendimin e të gjithë grupeve të interesit në lidhje me përmbajtjen e programit mësimor dhe GVJ u njoh me dokumentacionin në lidhje me këtë drejtim. Programi mësimor ka qenë subjekt i rishikimit dhe përmirësimit të tij <i>[Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation]</i>. Kërkesa për rishikim ka dalë nga njësia bazë (Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike) bazuar në mendimin e studentëve, të rekomandimeve të dhëna nga procesi i jashtëm i akreditimit institucional dhe të programit të studimit dhe nga kërkesat koherente të tregut të punës.</p> <p>GVJ zhvilloi një takim të veçantë me Komisionin e Zhvillimit të Kurrikulave i cili theksoi analizat që bëhet në lidhje me rishikimin e programit të studimit në kufijtë e masës 20% dhe më tej. Plani mesimor i programit të studimit Master i Shkencave "Inxhinieri Kompjuterike" ka qenë në vitet e fundit subjekt i përmirësimit të vazhdueshëm pa e tejkaluar masën 20% të tij. Përmirësimet kanë konsistuar në riorganizimin e lëndëve, disiplinave në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe rishikim të grupit të lëndëve me zgjedhje duke rritur spektrin e këtij të fundit në përshtatje edhe me tendencat e fundit të tregut të punës dhe zhvillimet në fushën e inxhinierisë kompjuterike <i>[Annex 2.1 Curricula of study program for each academic year since last accreditation]</i>.</p>

<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Programet e studimit i nënshtrohet të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm [RVB_MSc_CEN_shqip]. Në lidhje me përmirësimet në përmbajtjen e programit mësimor, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave verifikon përputhshmërinë e programit të studimit të rishikuar me standartet e cilësisë të specifikuar në Manualin e Cilësisë si edhe dokumentacionin e plotë shoqërues të propozimit për ndryshim [Annex 11.1 Policy on Continuous Improvement of Study Program]. Stafi akademik i nënshtrohet një monitorimi të vazhdueshëm periodik dhe të dhënat e përpunuara janë temë e takimeve në njësinë bazë [Annex 12.2 Rectorate Decision on the department last report related to course instructor evaluation survey; Annex 12.3 Course Instructor Evaluation Survey Form]. Të gjithë metodat që përdoren për matjen e cilësisë së përmbajtjes së programit mësimor, performancës së stafit akademik janë transparente dhe i bëhen me dije individualisht çdo pedagogu. Të dhënat e përpunuara reflektohen edhe në raportet vjetore institucionale dhe publikohen në faqen zyrtare të Universitetit “Epoka” [Annex 27 Institutional Annual Report 2021_2022].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Referuar RVB, metodat e drejtpërdrejta të përdorura në procesin e vlerësimit kanë përfshirë, takimet e autoriteteve drejtuese me studentët, takimet e autoriteteve drejtuese me këshillat studentore, takimet e përgjegjësve të departamenteve me studentët e programeve të studimit, takimet me studentët ALUMNI, vëzhgime në auditor për metodat dhe pedagogjinë e mësimdhënies së stafit akademik apo angazhimin e studentëve, vlerësimet e testimeve dhe ecuria gjatë një viti akademik e studentëve programit, analizë e problematikave lidhur me frekuentimin dhe kalueshmërinë etj. [Ev. RVB]. GVJ pati rastin të konfirmojë një pjesë të këtyre elementëve gjatë takimeve në institucion me stafin akademik, studentët, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm dhe NJSBC. [Annex 12 Directive on Academic & Administrative Performance Assessment & Quality Improvement; Annex 12.1 Academic Performance Measurement and Assessment Form; Annex 12.2 Rectorate Decision on the department last report related to course instructor evaluation survey; Annex 12.3 Course Instructor Evaluation Survey Form; Annex 12.4 Open Lecture Assessment Form; Annex 20.4 Student Satisfaction Survey].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të</p>	<p>Referuar RVB, institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si pyetësorë, anketime, raporte vjetore, raporte vlerësimi programi, raporte vlerësimi prej strukturave drejtuese, vetvlerësim të stafit akademik, RVB për proceset e akreditimit të programit, RVJ për proceset e akreditimit të programit, pyetësorët me studentët ALUMNI, vlerësimet e studentëve ALUMNI, gjurmimin e studentëve dhe mbledhjen e të dhënave për punësimin (për punësimin në</p>

personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	profil ose jashtë profili etj), takimet me ALUMNI në institucion, gjatë trajnimeve ose në sipërmarrjet ku ata punojnë [Ev. RVB]. Evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të vlerësimit në institucion [Ev. DVV, Takime në institucion; Annex 25 Annual Report on Quality Assurance Activities of the PCQA 2020-2021 and Regulation On The Organization and Functioning of the PCQA. Annex 27 Institutional Annual Report 2021_2022. Annex 26 Annual Report 2019-2020 CEN].			
Konkluzione	Universiteti "Epoka" përthith mendimin e të gjithë grupeve të interesit në lidhje me përmbajtjen e programit mësimor dhe GVJ u njoh me dokumentacionin në lidhje me këtë drejtim. Universiteti "Epoka" ka ngritur Komisionin e Zhvillimit të Kurrikulave i cili zhvillon procedurat në lidhje me rishikimin e programit të studimit në kufijtë e masës 20% dhe më tej. Programet e studimit i nënshtrohet raportit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm në mënyrë periodike. Institucioni përdor metodat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta në lidhje me procesin e vlerësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Sigurimi i brendshëm i cilësisë në institucion menaxhohet nga NJSBC, aktiviteti i së cilës synon përfshirjen e numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Në varësi edhe të fushës së ekspertizës, aktorët e brendshëm angazhohen më tepër në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësidhënies në gjithë elementët përbërës të saj, ndërsa aktorët e jashtëm (ekspertët e jashtëm pjesë e Komisioni të Përhershëm të Cilësisë, përfaqësues nga Alumni dhe përfaqësues nga kompanitë e biznesit me të cilat njësia bazë bashkëpunon) kontribuojnë në drejtim të përshtatjes së programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. I gjithë aktiviteti i NJSBC bazohet në Statutin e Universitetin "Epoka", dhe në mënyrë të veçantë në Manualin e Sigurimit të cilësisë të Institucionit. [Ev. RVB; Annex 16 EPOKA University Quality Assurance Handbook]. Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit nga NJSBC me rëndësi konsiderohet edhe informacioni dhe eksperiencat e përfuara në kuadër të

	mobiliteteve në universitete jashtë vendit [Tabelat Përmbledhëse_MSc CEN_shqip].
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Referuar RVB, përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë dhe strukturat e angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara në dokumentet bazë si Manuali i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Rregullore për Organizimin dhe Funkcionimin e PCQA-së [Annex 16 EPOKA University Quality Assurance Handbook; Annex 16.1 Regulation on The Organization and Functioning of the PCQA]. Përfaqësimi i studentëve është instrument i rëndësishëm që realizon në mënyra të ndryshme, si përfaqësimi i tyre në Senat Akademik, në Komisionin e Përhershëm të Cilësisë dhe në organe të tjera vendimarrëse të institucionit [Annex 16.1 Regulation on The Organization and Functioning of the PCQ; Annex 20.1 Statute_of_Student_Council.; Annex 1 Statute of Epoka University].
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Vlerësimi dhe siguri i cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike" është garantuar përmes një procesi gjithëpërfshirës. Nga takimi me GVB, u konstatua se ka patur një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. për të mundur një vlerësim real të programit të studimit me qëllim jo vetëm përmbushjen e detyrimit ligjor, por edhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit [Ev. RVB; Takime me GVB].
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë, në veprimtarinë e saj, NJSBC mbështetet nga institucioni në përgjithësi si dhe nga Fakulteti i Arkitektures dhe Inxhinierisë dhe Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike në veçanti. Në punën e saj NJSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. GVJ nuk gjeti praktika të prekjes së integritetit apo ankimimit në lidhje me procesin në përgjithësi si dhe anketimet e kryera në veçanti [Annex 1 Statute of Epoka University; Annex 1.1 Basic Regulation]
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Referuar takimit me përfaqësues të zyrës së NJSBC-së, në procesin e vlerësimit, Komisioni I Përhershëm I Cilësisë dhe Bordi i Vlerësimit të Performancës Akademike dhe Përmirësimit të Cilësisë angazhon përfaqësues nga fusha e biznesit (ekspert i jashtëm) dhe nga Alumni për të dhënë ekspertizën e tyre në drejtim të vlerësimit të procesit. [takime në institucion; Tabelat Përmbledhëse_MSc CEN_shqip] Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ka kryer edhe vlerësime periodike të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike" për të parë ecurinë e tij si dhe përputhjen me nevojat e tregut. Në këtë rast është konsideruar me prioritet opinionin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për të vlerësuar dhe pasqyruar elementë që

	lidhen me trendet e zhvillimit teknologjik [Ev. Annex 4 Company satisfaction survey; Annex 4.2 Alumni survey questionnaire 2021-2022.].			
Konkluzione	GVJ konstaton se Sigurimi i brendshëm i cilësisë në institucion menaxhohet nga NJSBC. Aktiviteti i NJSBC bazohet në Statutin e Universitetin "Epoka", dhe në Manualin e Sigurimit të cilësisë të Institucionit. Vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë së programit të studimit garantohet përmes nje procesi gjithpërfshirës. NJSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Transparenca e veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit sigurohet nëpërmjet publikimit të rezultateve në trajtën e raporteve, manualeve dhe vlerësimeve që kanë të bëjnë me institucionin dhe studentët. Ky informacion bëhet publik nëpërmjet faqes ëeb të institucionit dhe është i aksesueshëm nga gjithë të interesuarit [https://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-report-of-the-pcqa-1479-3053.html]. Një numër elementësh gjejnë vend edhe në raportet vjetore të Fakulteteve si dhe në Raportin Vjetor që institucioni përgatit për MAS [Annex 25 Annual Report on Quality Assurance Activities of the PCQA 2020-2021 and Regulation On The Organization and Functioning of the PCQA; 54 Academic Senate Decision No.17 dated 6.11.2019 on Action Plans in response to Recommendations].
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Informacioni me rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit i publikuar në faqen web të institucionit respekton lirinë akademike [https://iqau.epoka.edu.al/]. Universiteti organizon në formë të rregullt trajnime për stafin akademik dhe administrative për "Mbrojtjen e Të Dhënave" nga Komisioni për Mbrojtjen e Informacionit dhe të Dhënave [https://iqau.epoka.edu.al/content/MTY3/Training-Activities;].
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë	Nga takimi në institucion GVB u informua për elementë të cilët kanë qenë në fokusin e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit e që kanë rezultuar nga anketimet e kryera. Po ashtu në raportet e përgatitura për instancat e ndryshme ka elementë të rekomandimeve apo përmirësimeve të nevojshme [Annex 54 Academic Senate Decision No. 17

përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<i>dated 6.11.2019 on Action Plans in response to Recommendations]. GVJ konstaton se Institucioni harton plan veprimi në lidhje me punën për plotësimin e rekomandimeve të dhëna. Raportet vjetore reflektojnë edhe punën vjetore që është bërë nga njësitë bazë për përmirësimet e vazhdueshme në programet mësimore, në infrastrukturë dhe në drejtim të shërbimit ndaj studentëve [Annex 50 Action Plan ëith Corrective andor Preventive Actions in Response to Identified Issues Sample].</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Procesi i vlerësimit dhe sigurimit të efektivitetit dhe impaktit të veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit është një proces kompleks i cili kërkon angazhimin e të gjithë strukturave të institucionit. Në nivel institucioni kjo realizohet përmes strategjive, matshmërisë së realizimit të objektivave, studimeve të tregut, raporteve, analizave, vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme, pyetësorëve dhe anketimeve, angazhimit të ekspertëve dhe të gjitha instrumenteve të tjera akademike dhe administrative [Tabelat Përmbledhëse_MSc CEN_shqip]			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Referuar takimeve me grupin për vlerësimin e brendshëm, me stafin akademik të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike, NJSBC ka zhvilluar takime të ndryshme për të diskutuar mbi proceset e vlerësimit të programeve të studimit, vlerësimin e programit të lëndës. Gjithashtu, hartimi i RVB-së dhe grumbullimi i informacionit për DVV ka qenë një proces në të cilin është angazhuar jo vetëm GVB, por edhe gjithë instancat drejtuese të Universitetit “Epoka”, njësia përgjegjëse për programin e studimit si dhe studentët nëpërmjet përfaqësuesit të tyre. Në këtë mënyrë, nga një analizë e thelluar e programit të studimit, është mundësuar evidentimi i pikave të forta, dobësive, kërcënimeve dhe janë paraqitur mundësitë që paraqiten para studentëve të këtij programi [takim me grupin e vlerësimit të brendshëm, RVB].			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se raportet nga proceset e vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme bëhen transparente dhe publike në faqen zyrtare të institucionit. Në raportet e përgatitura për instancat e ndryshme ka elementë të rekomandimeve për të cilat institucioni ndërmerr përmirësimet përmes plan veprimeve. Përmes analizave të thelluara institucioni është në gjendje të përcaktojë pikat e forta, të dobta, mundësitë dhe kërcënimet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” ofruar nga Universiteti “Epoka”;

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Një program studimi i cili, në sajë të kurrikulës së ofruar, zhvillon njohuri të thelluara, aftësi e kompetenca profesionale të vlerësuara nga tregu i punës. Nevojë e lartë në tregun e punës në Shqipëri për inxhinierë të specializuar në fushën e inxhinierisë kompjuterike siguron edhe rritje të numrit të studentëve në këtë program studimi,
2. Institucioni zhvillon politika informuese në lidhje me kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike”.
3. Zhvillimi i mësimin në gjuhën angleze i cili favorizon mobilitetet si për studentët ashtu dhe për personelin akademik, mundëson aksesin në një literaturë të gjerë teknike si dhe lehtëson njohjen e këtij programi edhe jashtë vendit;
4. Ndjekja e një politikë integruese për staf akademik të huaj me përvojë në institucione të njohura jashtë vendit;
5. Në programin e studimit angazhohet një staf akademik me eksperience në fushën e inxhinierisë kompjuterike. Ngarkesa mësimore kryesisht nga personel akademik efektiv i motivuar dhe me kualifikimin e kërkuar për të garantuar një mësimdhënie cilësore;
6. Institucioni mbështet stafin akademik në drejtim të rritjes së cilësisë dhe përmirësimit të kualifikimit profesional përmes aplikimit të mbështetjes financiare në konferenca dhe botime shkencore.
7. Infrastruktura mësimdhënëse është në funksion të organizimit me cilësi të mësimin. Proces mësimor e kërkimor që realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme laboratorike për një zhvillim cilësor të këtij procesi.
8. Riorganizimi dhe menaxhimi i programit të studimit përmes planit mësimor, syllabuseve të lëndëve ndarjes së ngarkesës mësimore, ku është siguruar përfshirja e lëndëve të reja të kërkuara tashmë në treg garanton një përgatitje më e specializuar e studentëve në përfundim të studimeve të tyre.
9. Institucioni ka strukturë të duhura të cilat sigurojnë një dokumentacion të programit të studimit, një sistem të regjistrimit dhe ruajtjes së të dhënave për studentët.

Pika të dobta:

1. Mbingarkesë e stafit akademik. [kriteri 1, standarti IV.1].

Rekomandime:

1. Rekomandojmë përfshirjen e ngarkesës së orëve laboratorike dhe tematikën perkatëse të tyre në planin mësimor.
2. Te vendosen format vlerësimit të njohurive dhe format të kontrollit të vazhdueshëm në Rregulloren e Programeve të Ciklit të Dytë.

3. GVJ rekomandon se ZBNj dhe institucioni duhet të hartojë një rregullore ku të përcaktojë qartë sesi vlerësohet ngarkesa mësimore e stafit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe angazhimi i stafit akademik në punë administrative duke llogaritur këtu edhe angazhimin mësimor në programin e studimit.



Evaluation's conclusions for the Master of Science study program in "Computer Engineering" provided by the University "Epoka"

Strengths and affirmations:

1. A study program which, through its offered curriculum, develops in-depth knowledge, skills, and professional competencies that are valued by the job market. The high demand in the Albanian job market for specialized engineers in the field of computer engineering also ensures an increase in the number of students in this study program.
2. The institution develops informative policies regarding the admission criteria for students in the Master of Science program in "Computer Engineering."
3. Conducting lessons in English, which favors mobility for both students and academic staff, enables access to a broad range of technical literature and facilitates the recognition of this program abroad.
4. Following an inclusive policy for foreign academic staff with experience in renowned institutions abroad.
5. The study program engages academic staff with experience in the field of computer engineering. The teaching load is mainly carried by motivated and adequately qualified effective academic staff to ensure quality teaching.
6. The institution supports academic staff in improving quality and enhancing professional qualifications through financial support for conferences and scientific publications.
7. The teaching infrastructure is designed to organize high-quality learning. The teaching and research process is conducted in sufficient and quality spaces, equipped with the necessary laboratory infrastructure for the qualitative development of this process.
8. The reorganization and management of the study program through the curriculum plan, course syllabi, and distribution of the teaching load, where the inclusion of new subjects demanded by the market is ensured, guarantees a more specialized preparation of students upon completing their studies.
9. The institution has appropriate structures that ensure proper documentation of the study program, a system for registering and maintaining student data.

Weaknesses:

1. Overload of academic staff [**criterion 1, standard IV.1**].

Recommendation:


1. We recommend including the workload of laboratory hours and their respectively topics in the curriculum plan [*criterion 3, standard II.4; criterion 5, standard II.4*].
2. The assessment formats and continuous evaluation methods should be included in the Regulations of Second Cycle Programs [*criterion 1 and 3, standard III.2*].



3. The GVJ recommends that the Human Resource Office and the institution should draft a regulation clearly defining how the teaching load of the staff is evaluated in accordance with current legislation, including the involvement of academic staff in administrative tasks and teaching commitment in the study program [*criterion 2, standard IV.1*].



Page 92



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

